

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2016**

BULETINI ZYRTAR

VENDIME ME OBJEKT - PËRQENDRIMET	1
Nr. 398, datë 09.02.2016	1
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SABMiller Plc. nga shoqëria Anheuser Busch InBev.	1
Nr. 399, datë 09.02.2016	4
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë E.H.W Sh.p.k nga një ortak i vetëm.	4
Nr. 414, datë 04.05.2016	6
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë indirekt nga shoqëria Geo-Jade Petroleum Corporation të shoqërisë Bankers Petroleum Ltd., nëpërmjet shoqërisë 1958082 Alberta Ltd..	6
Nr. 420, datë 08.06. 2016	10
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit shoqërisë Tirana International Airport Sh.p.k nga Keen Dynamics Limited.	10
Nr. 421, datë 22.06.2016	14
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Asahi Group Holdings Ltd. të biznesit të birrës të zotëruar nga SABMiller Plc.	14
Nr. 422, datë 22.06.2016	17
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Veneto Banca S.p.A nga Quaestio Capital Management SGR S.p.A nëpërmjet fondit Atlante	17
Nr. 425, datë 14.07.2016	20
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të tërthortë të shoqërisë A4 Holding S.p.A nga Abertis Infraestructuras S.A	20
Nr. 426, datë 20.07.2016	23
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurosif SH.A të shoqërisë Insig SH.A	23
Nr. 427, datë 20.07.2016	26
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Novamatic Gaming Industries GmbH të 100% të kapitalit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding GmbH.	26
Nr. 431, datë 14.09.2016	29
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurokontakt Sh.p.k të 100% të kapitalit të shoqërisë Lion Real Estate Albania SHPK	29
Nr. 433, datë 21.09.2016	31
Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria GMBF Investment S.a.r.l të shoqërive NV Biscuits Delacre SA dhe United Biscuits Industries SAS nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve.	31
Nr. 445 , datë 13.12.2016	34
Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Fondi BESA SHA të shoqërisë VisionFund Albania SHPK.	34

VENDIME ME OBJEKT - ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE	37
Nr. 415, datë 4.05.2016	37
Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë).	37
Nr. 417, datë 18.05.2016	39
Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport”	39
Nr. 424 , datë 29.06.2016	41
Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.	41
Nr. 432-432/1, datë 14.09.2016	43
Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport”	43
Nr. 438, datë 05.10.2016	46
Mbi disa rekomandime dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.	46
Nr. 440 , datë 10.11.2016	50
Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë).	50
Nr. 443 , datë 30.11.2016	54
Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.	54
VENDIME ME OBJEKT - MARRËVESHJE TË NDALUARA	60
Nr. 400, datë 10/02/2016	60
Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.	60
Nr. 407, datë 8.03.2016	62
Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektesh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.	62
Nr.409, datë 21.03.2016	67
Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore” dhe dhënie rekomandimesh për Autoritetin Rrugor Shqiptar.	67
Nr. 413, datë 21.04.2016	75
Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj shoqërive “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK.	75
Nr. 430, datë 7.09.2016	78
Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme).	78

Nr.435, datë 21.09.2016	80
Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme).	80
Nr. 444, datë 30.11.2016	83
Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj shoqërive “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK dhe dhënien e rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në tregun përkatës.	83

VENDIME ME OBJEKT - PËRQENDRIMET

VENDIM

Nr. 398, datë 09.02.2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SABMiller Plc. nga shoqëria Anheuser Busch InBev.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.02.2016, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë SABMiller Plc. nga shoqëria Anheuser Busch InBev.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve”, nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e përqendrimit Anheuser Busch InBev / SABMiller Plc,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjes së bashkëpunimit” të nënshkruar midis palëve Anheuser-Busch InBev dhe SABMiller Plc., më datë 11 Nëntor 2015, me objekt përfutimin në mënyrë indirektë të 100% të kapitalit aksionar të SABMiller nga ABInBev.

Qëllimi i këtij transaksioni është zgjerimi i aktivitetit të grupit të kombinuar ABInBev- SABMiller në tregjet ne rritje në Afrikë dhe Azi.

Transaksioni i cili realizohet në formën e përfutimit të kontrollit indirekt mbi një ndërmarrje (SABMiller Plc.) sjell një ndryshim afatgjatë në cilësinë e kontrollit në këtë të fundit, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit është përqendrim.

Përqendrimi i njoftuar permbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit persa i perket xhirove (neni 12/1) në tregun e brendshëm dhe për këtë arsye i është nënshtruar procedurës së kontrollit nga Autoriteti i Konkurrencës.

Palët në transaksion

Anheuser-Busch InBev (ABI): në cilësinë e blerësit është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit belg, me seli në adresën: Grand Palace, 1, 1000 Bruksel, Belgjike. Shoqëria është e listuar në bursën e Brukselit (Euronext Brussels Stock Exchange) dhe në bursën e New York (New York Stock Exchange). Ajo është aktive në prodhimin, reklamimin dhe shpërndarjen e birrës (“birrës së lehtë”) dhe pijeve jo-alkoolike. Në disa shtete ajo gjithashtu shpërndan produkte të birrës të prodhuesve të tjerë.

SABMiller Plc : në cilësinë e ndërmarrjes target është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit anglez me seli në adresën: Church Street West , Woking, Surrey GU216HS, Londër, Mbretëri e Bashkuar. SABMiller është e listuar në bursat e Londrës dhe Johannesburg. Ajo është aktive në prodhimin, tregtimin dhe shpërndarjen e birrës dhe pijeve jo-alkoolike përmes filialeve të saj si dhe bashkë me shoqëritë e saj të lidhura.

Xhiro për vitin 2014

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXXXXXXX Lekë:

— Anheuser – Busch InBev (ABI) = XXX \$ = XXXX Lekë

— SABMiller plc = XXX \$ = XXXXX Lekë

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXXLekë:

— Anheuser – Busch InBev (ABI) = XXXX \$ = XXXXX Lekë;

— SABMiller plc = XXXX \$ = XXXXX Lekë;

Përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove (neni 12/1).

Tregu përkatës

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e këtij përqendrimit është tregu i prodhimit, shitjes dhe shpërndarjes së birrës.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

VLERËSIMI I KONKURENCËS PAS PËRQENDRIMIT

Duhet pasur parasysh se asnjë prej ndërmarrjeve, pjese e këtij transaksioni nuk është prezente në mënyrë të drejtpërdrejtë në tregun e brendshëm dhe pas përqendrimit nuk ndryshon struktura e tregut.

Pjesët e tregut respektive të ABI dhe SABMiller, për vitin 2014 janë përkatësisht XX% (shitje të realizuara nëpërmjet markës Corona) dhe XX% duke realizuar një pjesë të kombinuar tregu prej XX % e cila mbetet poshte kufirit 40 %, kufi i cili është pranuar si një ndër përcaktuesit e pozitës dominuese në tregun përkatës nga Autoriteti i Konkurrencës, ashtu dhe Komisioni Europian.

Krahasuar me konkurrentet e tjera në treg, pjesa e tregut e kombinuar e paleve në transaksion, vazhdon të jetë me e vogël se sa ajo e konkurrenteve kryesore të importit dhe prodhuesve vendas

Vetë tregu paraqitet si një treg i hapur dhe pa barriera në hyrje duke qënë se ai nuk paraqet kufizim për produktin e importit, por edhe për prodhimin lokal, fakt të cilin e dëshmon edhe futja e një aktori vendas të ri në treg gjatë 2015.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë SABMiller Plc. nga shoqëria Anheuser Busch InBev.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve dhe ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 399, datë 09.02.2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë E.H.W Sh.p.k nga një ortak i vetëm.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.02.2016, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë E.H.W Sh.p.k nga një ortak i vetëm”.

Baza ligjore: Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit ‘E.H.W Sh.p.k / Olinvest S.r.l’,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi realizohet me anë të “Kontratë për Shitblerjen e Kuotës së Kapitalit të Shoqërisë E.H.W Sh.p.k” e nënshkruar nga palët Olinvest S.r.l, E.H.W Sh.p.k dhe ortaku i përbashkët më datë 17 Janar 2016. Objekti i transaksionit është përfutimi i kontrollit të vetëm dhe të plotë mbi kuotat e shoqërisë E.H.W nga ortaku i saj.

Me anë të këtij transaksioni ortaku Olinvest i tjetëron kuotën e saj, e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë E.H.W, tek ortaku tjetër i cili pas përmbyllës së kontratës do të jetë ortak i vetëm i shoqërisë E.H.W duke zotëruar 100% të kapitalit dhe të së drejtës së votës .

Ky transaksion i cili shkakton përfutimin e kontrollit të shoqërisë E.H.W nga një ortak dhe që shfaqet në formën e zvogëlimit të numrit të ortakëve kontrollues në bazë të nenit 10, pika 1) shkronja b) i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” , i ndryshuar, përbën një përqendrim.

Palët në transaksion

E.H.W Sh.p.k (“E.H.W”) : në cilësinë e ndërmarrjes Target është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Tiranë Superstradë , Km 4.8. shoqëria është themeluar që në vitin 1992 dhe ka si objekt (i) ndërtimin e linjave industriale për përpunimin e mishit dhe prodhimin sallamit; (ii) tregtimin e produkteve të mishit ; (iii) prodhimin industrial; (iv) import eksport dhe shërbime në fushën e reklamave.

Olinvest S.r.l (“Olinvest”): në cilësinë e Shitësit është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit italian , me seli në adresën: Trezzano Rosa, Via Giuseppe Verdi, 12, Milano , Itali. Shoqëria është themeluar në vitin 2000 dhe ka si objekt aktivitetet: (i) ndërtimit, blerjes , shitjes , shkëmbimit të pasurive të paluajtshëm; (ii) kryerjen e aktivitetit financiar dhe paraqitja e shërbimeve financiare në Itali dhe

jashtë saj për llogari të saj dhe të të tretëve; (iii) studimin krijimin realizimin dhe mbajtjen e software, të site-ve në internet dhe zhvillimin e teknologjive të reja për internetin.

Xhiro për vitin 2014

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXX Lekë:

— E.H.W SHPK : = XXXXX Lekë;

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma b) të Ligjit.

Tregu Përkatës

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e këtij përqendrimit është tregu i prodhimit dhe përpunimit të mishit (sallameri dhe proshuta) për konsum për njerëzit, si dhe tregtimin e tyre.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Efektet në treg pas përqendrimit

Aktualisht, shoqëria E.H.W SHPK është një nga përpunuesit dhe tregtuesit e mëdhenj të mishit dhe produkteve të tij (sallam, proshuta etj). Kjo shoqëri realizon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Shqipërise. Me anën e këtij përqendrimi realizohet përfëtimi i kontrollit të shoqërisë E.H.W nga një ortak. Ky transaksion nuk sjellë asnjë ndryshim në tregun përkatës dhe atë gjeografik.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

- I. Të autorizojë e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfëtit të kontrollit të shoqërisë E.H.W Sh.p.k nga një ortak i vetëm.
- II. Ngarkohet Sekretari i përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 414, datë 04.05.2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë indirekt nga shoqëria Geo-Jade Petroleum Corporation të shoqërisë Bankers Petroleum Ltd., nëpërmjet shoqërisë 1958082 Alberta Ltd..

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 4.05.2016, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati), Znj. Servete Gruda, Z. Koço Broka, Z. Eduard Ypi, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë indirekt nga shoqëria Geo-Jade Petroleum Corporation të shoqërisë Bankers Petroleum Ltd., nëpërmjet shoqërisë 1958082 Alberta Ltd.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”,Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e përqendrimit Geo-Jade Petroleum Corporation / 1958082 Alberta Ltd / Bankers Petroleum Ltd.,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi i synuar konsiston në blerjen në masën 100% të aksioneve të Bankers Petroleum Ltd. nga Geo-Jade Petroleum Corporation nëpërmjet filialit të saj të kontrolluar në mënyrë të tërthortë, shoqërisë 1958082 Alberta Ltd .

Më datë 19 Mars 2016, Bankers Petroleum Ltd. ka nënshkruar një marrëveshje përfundimtare (“Marrëveshja e Organizimit”) me 1958082 Alberta Ltd dhe Charter Poëer Investment Limited (shoqëria mëmë e cila zotëron 100% shoqërinë Alberta), për blerjen e të gjithë aksioneve të zakonshme të emetuara dhe të papaguara të Bankers Petroleum Ltd me një çmim prej C\$2.20 për aksion. Transaksioni do të realizohet përmes një plani angazhimesh në përputhje me Aktin e Themelimit të shoqërisë 1958082 Alberta Ltd.

Me anë të këtij transaksioni Geo-Jade nëpërmjet Alberta do të përftojë 100% të aksioneve të Bankers Petroleum Ltd së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga to si dhe në mënyrë të tërthortë të degëve të saj në Shqipëri shoqërive Bankers Albania Ltd dega Shqipëri dhe Sherwood International Petroleum Ltd.

Ky transaksion i cili ndodh jashtë territorit të Shqipërisë dhe shkakton ndryshimin në cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen target Bankers dhe për pasojë në shoqëritë shqiptare Bankers Albania Ltd dega Shqipëri dhe Sherwood International Petroleum Ltd dega Shqipëri, në formën e përfutimit të kontrollit indirekt të vetëm eskuziv përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1) , shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Palët në transaksion

Referuar Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, palë pjesëmarrëse në këtë transaksion sipas formularit të përqendrimit janë si vijon :

Geo-Jade Petroleum Corporation (“Geo-Jade”)¹, në cilësinë e përfituesit të kontrollit, është një shoqëri aksionare me ofertë publike e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Republikës së Kinës, me seli në adresën: nr. 28, Rruga Xisha, Qyteti Haioku, Kinë. Shoqëria është themeluar më 20 Gusht 1984 dhe ka si objekt: (i) investimi i projekteve të hidrokarbureve E & P dhe petrokimike, zhvillim teknik, konsulencë dhe shërbime me inxhinierinë përkatëse; (ii) shitje për produktet petrokimike dhe materialet, pajisjet dhe furnizimet e kërkuara nga ndërtimi inxhinierik i gazsjellësit; (iii) prodhim, shitje dhe rivendosjen e biznesit për rafineri dhe produktet petrokimike (pa përfshirë miratimet e veçantë), etj.

Pra shoqëria përfituese e kontrollit pas përqendrimit ka eksperiencë edhe në fushën e hidrokarbureve ku ushtron aktivitet shoqëria objekt i këtij përqendrimi.

Alberta Ltd (“Alberta”)²: në cilësinë e blerësit është një shoqëri e themeluar më 19 Mars 2016 në Alberta, me seli në adresën: 1500, 850, Street, Caglar, Alberta, Kanada. Shoqëria është krijuar enkas për realizimin e transaksionit të njoftuar nga shoqëria kineze Charter Power Investment Company Ltd (Hong Kong).

Bankers Petroleum Ltd (“Bankers”)³, në cilësinë e ndërmarrjes Target, është një shoqëri e cila funksionon në bazë të legjislacionit të Republikës së Kanadasë me seli në adresën: 4000,421-7 Avenue Street, Cagliary Alberta, Kanada. Bankers është një shoqëri kërkimi dhe prodhimi gazi dhe nafte me aktivitet zhvillimin e rezervave të naftës dhe gazit në Shqipëri dhe Europën Lindore (Hungari dhe Ruman). Në Shqipëri Bankers operon dhe ka të drejta të plota për zhvillimin e fushës së pasur naftëmbajtëse Patos – Marinës, ka 100% interesa në fushën naftëmbajtëse në Kuçovë dhe 100% interes në bllokun e kërkimit “F”.

Aktiviteti tregtar i Bankersit në Shqipëri kryhet nëpërmjet dy degëve operative të Bankers përkatësisht: të Bankers Petroleum Albania Ltd. dhe Sherwood International Petroleum Ltd, të cilat janë të dyja të zotëruara nga Bankers International Limited (Jersey) e cila vetë zotërohet 100% prej Bankers Petroleum Ltd (Alberta).

Bankers Petroleum Albania Ltd me objekt: (i) kryerja e operacioneve hidrokarbure në zonat e miratuara në marrëveshjet e hidrokarbureve (ii) ndërtimi dhe montimi i të gjitha mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara në operacionet hidrokarbure; (iii) përdorimi, shitja, shkëmbimi, eksporti, nxjerrja dhe posedimi i naftës së prodhuar në zonat e miratuara në marrëveshjet e hidrokarbureve, etj.

Sherwood International Petroleum Ltd me objekt kërkim dhe prodhim nafte dhe nënprodukteve të saj.

Xhiro për vitin 2014

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXXX Lekë:

- Geo-Jade Petroleum Corporation : XXXX CNY⁴ = XXXX Lekë
- Bankers Petroleum Ltd : XXXX \$
- 19580820 Alberta LTD : XXX \$⁵ = XXXX Lekë

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXX Lekë:

- Bankers Petroleum Albania Ltd : XXXXX Lekë

¹ Burimi:Seksioni 1 i Formularit të Thjeshtuar të Njoftimit të Përqendrimit

² Burimi:Seksioni 1 i Formularit të Thjeshtuar të Njoftimit të Përqendrimit

³ Burimi:Seksioni 1 i Formularit të Thjeshtuar të Njoftimit të Përqendrimit

⁴ Burimi: Pasqyrat Financiare për 2014 të Geo-Jade, Pasqyrat Financiare për 2015 nuk mund të jenë të disponueshme deri më 30.6. 2016. Kursi 1CNY=18.9 Lekë

⁵ Burimi: Raporti Vjetor 2015 i Bankers Petroleum Ltd, fq 4. Kursi këmbimit për vitin 2015 1USD = 126 Lekë, sipas BSH.

Sa më lart, palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit.

ANALIZA E KONKURRENCËS

Tregu përkatës

Tregu përkatës i produktit: Në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet për përqendrimet dhe sipas veprimtarisë që kryejnë palët pjesëmarrëse në këtë transaksion, tregu përkatës i produktit do të konsiderojmë: kërkim, zhvillim, prodhim i naftës dhe i gazit natyror, tregtimi dhe eksporti të produkteve të naftës dhe gazit.

Tregu përkatës gjeografik: Për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm / territori i Republikës së Shqipërisë.

VLERËSIMI I KONKURRENCËS PAS PËRQENDRIMIT

Përqëndrimi i synuar parashikon që menaxhmenti i ri i Bankers sipas grupit të ri të investitorëve do të zbatojë një teknologji të rekuperimit termal për të zbërthyer zhvillimin e ulët të rezervave të naftës në mënyrë që të rritet prodhimi. Gjithashtu sipas njoftimit të përqendrimit, do të sigurohen mundësi më të mëdha për punësim dhe do të fillojnë programet e trajnimit për punëmarrësit lokalë për të zhvilluar më tej aftësitë e tyre dhe konkurrueshmërinë në tregun global.

Pjesët e tregut të konkurrentëve më të mëdhenj për periudhën janar-qershor 2015 janë: Bankers Petroleum me 88.9% të tregut, TransAtlantic me 4.9% të tregut, Albpetrol me 3.6% të tregut dhe Transoil Group me 2% të tregut.

Pjesa e kombinuar e tregut të Targetit (Bankers dhe Sherwood) shkon në 89.1% duke qenë në nivele të përafërta të viteve të fundit.

Transaksioni nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut në periudhën afatshkurter, por sjellja e firmes mund të ndryshojë në periudhën afatgjatë për shkak të pozitës dominuese që zotëron në tregun përkatës.

Konkluzione

Përqëndrimi i mësipërm do të realizohet nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të Bankers Petroleum Ltd nga Geo-Jade Petroleum Corporation përmes një filiali të saj të kontrolluar në mënyrë të tërthortë 1958082 Alberta Ltd.

Transaksioni ka ndodhur jashtë territorit gjeografik të Republikës së Shqipërisë, por pasojat shtrihen në tregun e brendshëm për shkak të ndryshimit të qëndrueshëm të kontrollit dhe për këtë arsye është objekt i miratimit nga ana e Komisionit të Konkurrencës.

Meqënëse pala përfituese e kontrollit, Geo-Jade Petroleum Corporation, nuk është prezente në tregun shqiptar, atëherë për pasojë përqëndrimi i njoftuar nuk do të sjellë ndryshime në strukturën e tregut, pasi nuk ka bashkime apo përthithje të ndërmarrjeve ekzistuese nga ana e shoqërisë që përfiton kontrollin e Bankers Petroleum Ltd, e cila do të vazhdojë të zotërojë vetëm pjesët e tregut të shoqërisë Bankers Petroleum.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye autorizohet në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të plotë indirekt nga shoqëria Geo-Jade Petroleum Corporation të shoqërisë Bankers Petroleum Ltd., nëpërmjet shoqërisë 1958082 Alberta Ltd.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 420, datë 08.06. 2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit shoqërisë Tirana International Airport Sh.p.k nga Keen Dynamics Limited.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.06.2016, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport Sh.p.k nga Keen Dynamics Limited.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e përqendrimit Tirana International Airport Sh.p.k, Keen Dynamic Limited,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Në datën 6 Maj 2016, me shkresën nr. 178 prot, nga përfaqësuesi i shoqërisë Keen Dynamics Limited, Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar për përqendrimin me objekt përfutimin e kontrollit në shoqëritë Tirana International Airport Sh.p.k nga Keen Dynamics Limited, nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Tirana International Airport SHPK

Transaksioni i transferimit të 100% të kuotave të shoqërisë shqiptare Tirana International Airport Sh.p.k, nga AviAlliance GmbH, Deutsche Investitions und Entëicklungsgesellschaft GmbH dhe Albanian American Enterprise Fund (Shitësit) tek shoqëria Keen Dynamics Limited, realizohet me anë të marrëveshjes për shitblerjen e kuotave të nënshkruar ndërmjet palëve më datë 11 prill 2016.

Me anë të këtij transaksioni shoqëria China Everbright Venture Capital Limited , nëpërmjet Keen Dynamics Limited, do të përftojë kontrollin maxhoritar mbi Tirana International Airport Sh.p.k, duke shkaktuar ndryshim afatgjatë të cilësisë së kontrollit në këtë të fundit.

Në kuptim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, neni 10, pika 1 shkronja b), ky transaksion i cili sjell përfutimin e kontrollit indirekt nga shoqëria kineze China Everbright Venture Capital Limited në shoqërinë shqiptare Tirana International Airport Sh.p.k klasifikohet si përqendrim.

Palët në transaksion

China Everbright Limited dhe Friedmann Pacific Asset Management (FPAM) përfitojnë kontrollin në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës nëpërmjet shoqërisë Keen Dynamics Limited.

Palët blerëse

Keen Dynamics Limited: në cilësinë e Blerësit është një shoqëri e themeluar në 31 Mars 2016 dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Ishujve Cayman me seli në adresën: Offshore Incorporations (Cayman) Limited, Willow House, Cricket Square, Grand Cayman, e regjistruar me numër 309439. Objekti i shoqërisë është të ushtrojë biznesin e një shoqërie investimi dhe të veprojë si nxitës dhe sipërmarrës; të zhvillojë biznesin si financiar, kapitalist, konçesionar, tregtar, broker, agjent, importues dhe eksportues dhe të ndërmarrë, të kryejë e ekzekutojë të gjitha llojet e operacioneve investuese, financiare tregtare, etj.

China Everbright Limited në cilësinë e shoqërisë mëmë të blerësit, është një shoqëri kineze e cila është e fokusuar në investime dhe menaxhime fondesh. Gjithashtu shoqëria, nëpërmjet pjesëmarrjes në shoqëri të tjera, është gjithmonë në zhvillim të biznesit të qiradhënies së avionëve në Kinë dhe në tregje në zhvillim. Ajo është e listuar në bursën e Hong- Kong që prej vitit 2014. Shoqëria zotëron indirekt 75% të kapitalit themeltar të blerësit.

Friedmann Pacific Asset Management (FPAM): në cilësinë e shoqërisë mëmë të blerësit, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit Kinez, me seli në Hong-Kong. Veprimtaria e saj fokusohet kryesisht në investime në industri të lidhura me aviacionin. Biznese kryesore të shoqërisë përfshijnë qiradhënien e avionëve dhe investime në aeroporte. Gjithashtu shoqëria është aksionar kryesor në Aeroportin e Tuluzës në Francë. FPAM zotëron në mënyre indirekte 25% të kapitalit themeltar të blerësit.

Palët shitëse

AviAllaiance GmbH në cilësinë e shoqërisë Shitëse, është një investitor dhe administrator privat industrial aeroportesh. Ajo ka ndërtuar një portofol të balancuar me pjesëmarrje në aeroportet e Athinës, Budapestit, Dyseldorfit, Hamburgut, Sidney dhe Tiranës. Shoqëria ushtron veprimtari në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet dy shoqërive *Tirana International Airport Sh.p.k* dhe *HTAR SHPK*

Deutsche Investitions und Entëicklungsgesellschaft GmbH (DEG): në cilësinë e shitësit, është një shoqëri misioni i së cilës është të promovojë iniciativa biznesi në tregjet e vendeve në zhvillim duke kryer financime afatgjata dhe këshilluar shoqëritë private që investojnë në këto vende.

Albanian – American Enterprise Fund (AAEF): në cilësinë e shitësit, është një entitet misioni i të cilit është të nxisë zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri.

Ndërmarrja objekt përqendrimi

Tirana International Airport Sh.p.k (TIA) në cilësinë e ndërmarrjes Target, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë përfshin projektimin, financimin, ndërtimin, vënien në punë, mirëmbajtjen, administrimin dhe zhvillimin e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, i cili përfshin ndër të tjera: marrjen në pronësi nga shoqëria e terminalit të ri, zyrave të reja të administrimit, qendrës së re të ngarkesave ajrore, pajisjeve të reja të karburantit, rrugës së re të hyrjes, urës së re si edhe ushtrimin e uzufruktit nga shoqëria në lidhje me zonën e koncesionit, etj.

Xhiro për vitin 2015

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXXX Lekë:

— China Everbright Limited : XXX HKD¹ = XXXX Lekë

— Friedman Pacific Asset Management : XXX HKD² = XXX Lekë

¹Burimi: Pasqyrat Financiare për 2015 të China Everbright Limited,. Kursi 1HKD (Hong Kong Dollar) =XXXX Lekë

²Burimi: Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Përqendrimit, xhiro e përkohshme botërore për 2015 të Friedman Pacific Asset Management (pasqyrat financiare të 2015 nuk janë finalizuar ende). Xhiro për vitin 2014 është XXXX lekë. .

— Keen Dynamics Limited (Blerësi): XXX Lekë

— Blerësi i Fundit : XXX Lekë

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXX Lekë:

— Tirana International Airport SHPK ³ : XXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Tregu përkatës

Tregu përkatës i produktit: Në sektorin e shërbimeve aeroportuale identifikohen tre kategori të ndryshme shërbimesh:

- shërbimet e infrastrukturës aeroportuale që i ofrohen linjave ajrore ;
- shërbimet e asistencës në tokë (ground handling services) që përbëhen nga një grup shërbimesh të nevojshme dhe ndihmëse në lidhje me nisjet, uljet, qëndrimet në tokë të avionëve dhe ngarkesës së tyre;
- shërbimet tregtare që përfshijnë ndër të tjera, administrimin e dyqaneve të shitjes së produkteve për publikun që ushtrohen nga subjekte të treta përfituese me anë të nën-konçesionit, administrimin e parkimeve dhe shitjen e hapësirave publicitare.

Treg përkatës të produktit në Shqipëri do të konsiderojmë shërbimet e infrastrukturës aeroportuale që i ofrohen linjave ajrore dhe shërbimet e asistencës në tokë, shërbime këto të ofruara nga TIA.

Tregu përkatës gjeografik: Për vlerësimin e këtij transaksioni, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Efektet në treg pas përqendrimit

Transaksioni konsiston vetëm në një ndryshim kontrolli të Target-it. Blerësi/Blerësi I Fundit dhe Shoqëritë Mëmë nuk janë të pranishme në asnjë treg në Shqipëri.

Transaksioni nuk do të ketë as mbivendosje horizontale as vertikale midis ndërmarrjeve përkatëse dhe për rrjedhojë nuk do të ketë rritje të pjesës së tregut ose ndryshim të tregut përkatës pas realizimit të transaksionit.

Transaksioni nuk do të rezultojë në ndonjë rritje të pjesës së tregut, pasi TIA do të vazhdojë të drejtohet në përputhje me kushtet e Kontratës së Konçesionit, e cila përcakton qëllimin, metodën dhe bazën e shërbimeve që do të ofrohen.

Ndërmarrja objekt përqendrimi, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës pasi ka ekskluzivitetin “de fakto” të fluturimeve ndërkombëtare drejt/nga Shqipëria dhe ekziston rreziku i abuzimit me pozitën dominuese sipas nenit 9 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Për këtë arsye Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës duhet të zbatojë kushte të barabarta për veprime të njëjta tregtare me palët që do të operojnë në këtë aeroport(shoqëritë ajrore përfshirë dhe ato me kosto të ulët (low cost)).

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

³Pasqyrat financiare të konsoliduara të TIA sh.p.k. për vitin 2015.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tirana International Airport Sh.p.k nga Keen Dynamics Limited.
- II. Autoriteti i Konkurrencës do të monitorojë sjelljen e ndërmarrjes në treg sa i përket tarifave të shërbimeve të ofruara nga TIA si dhe zbatimin e angazhimeve të palës në formularin e përqendrimit.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 421, datë 22.06.2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Asahi Group Holdings Ltd. të biznesit të birrës të zotëruar nga SABMiller Plc.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.06.2016 shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Asahi Group Holdings Ltd. të biznesit të birrës të zotëruar nga SABMiller Plc..

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit ‘Asahi Group Holdings Ltd. - Peroni - Grolsch - Meantime – SABMiller Plc.- Anheuser Busch InBev’

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi realizohet me anë të “Akt shitje dhe blerje” të nënshkruar midis palëve Anheuser-Busch InBev dhe Asahi Group Holdings Ltd., më datë 19 prill 2016.

Me anë të këtij transaksioni shoqëria Asahi Group do të përftojë kontrollin e të gjitha aksioneve të ABInBev aktualisht të zotëruara nga SABMiller Plc., në biznesin target, të cilat përfaqësojnë 99.9% të aksioneve tek Birra Peroni S.r.l, 100% të aksioneve në SABMiller Holandë B.V, 100% të aksioneve tek Meantime Breëing Company Limited dhe 100% të aksioneve tek Miller Brands UK Limited, si dhe disa asete përkatëse të markave Peroni, Grolsch dhe Meantime.

Ky transaksion, i cili ndodh jashtë tregut kombëtar, është pjesë e transaksionit të mëparshëm të njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës në Janar 2016 dhe autorizuar me Vendimin nr. 398, datë 09.02.2016, nga Komisioni i Konkurrencës.

Transaksioni është pjesë e kushtit të vendosur nga Komisioni European për të adresuar disa shqetësime që transaksioni i mëparshëm krijonte për konkurrencën në tregun European¹ dhe pas realizimit të kushteve që i referoheshin vetëm tregut të përbashkët europian, është autorizuar me kushte e detyrime nga Komisioni European.

¹ Në Shtetet e Bashkuara shoqëria ABInBev do të shesë XX% të aksioneve në Joint Venture në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (MillerCoors) tek Molson Coors për £XXX miliardë për të shmangur shqetësimet e konkurrencës.

Transaksioni, i cili realizohet në formën e përfutimit të kontrollit mbi një pjesë të një ndërmarrje (SABMiller Plc.) me anë të përfutimit të aseteve (markat Peroni, Grlosch dhe Meantime) sjell një ndryshim afatgjatë në cilësinë e kontrollit në biznesin target dhe në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 27.08.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), përbën një përqendrim.

Palët në transaksion

Asahi Group Holdings Ltd. (“Asahi”), në cilësinë e blerësit, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit japonez me seli në adresën: Tokyo 130-8602, Japoni. Shoqëria është aktive në prodhimin e pijeve dhe ushqimit, e listuar në bursën e Tokyo-s. Asahi ka pasur fillimet e veprimtarisë në vitin 1998, duke u bërë një nga shoqëritë më të mëdha të prodhimit të birrës në Japoni dhe në botë, përsa i përket vëllimit. Shoqëria zotëron një sërë produktesh dhe operon kryesisht në rajonin e Azisë - Oqeanit Paqësor.

Birra Peroni S.r.l (Roma- Via Renato Birolli 8), Meantime Brewing Company Limited (SABMiller House, Church Street west, Woking, Surrey, England GU21 6HS), Miller Brands (UK) Limited (SABMiller House, Church Street West, Woking, Surrey, England GU21 6HS) në cilësinë e targetit në këtë transaksion.

Xhiro për vitin 2015

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXXXXX Lekë:

- Asahi Group Holdings Ltd²=XXXX milionë ¥³ = XXXX Lekë
- Peroni S.r.l ⁴ = XXXX €⁵ = XXXX Lekë
- SABMiller Netherlands B.V⁶ = XXXX € = XXXXX Lekë
- Meantime Breëing Company Limited⁷ = XXXXX £⁸ = XXXXX Lekë
- Miller Brands (UK) Limited⁹ = XXXXX £ = XXXXX Lekë

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXXXX Lekë:

- Peroni Srl = 4 milionë € = XXXXX Lekë;

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma a) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Tregu Përkatës

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e këtij përqendrimit është tregu i prodhimit, shitjes dhe shpërndarjes së birrës.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Transaksioni nuk krijon tregje të prekura. Për më tepër, duke patur parasysh peshën e prodhimit vendas, numrin e pjesëtarëve në treg, si dhe pjesët e tyre të tregut, ky transaksion nuk ul presionin konkurrues ndaj konkurrentëve të mbetur, duke mos sjellë shqetësime për konkurrencën. Pjesa e tregut e Peroni S.r.l me markat e saj Peroni dhe Peroni Nastro Azzuro nuk ndryshon pas realizimit të përqendrimit.

² Xhiro sipas bilancit të kompanisë për vitin 2014. Në formularin e njoftimit të përqendrimit xhiro për vitin 2015 është XXXX milionë ¥,

³ Kursi i këmbimit për vitin 2014. 100 ¥ = 99.78 Lekë. Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor.

⁴ Xhiro i përket vitit të fundit financiar të mbyllur më 31.03.2015.

⁵ Kursi i këmbimit për vitin 2014. 1 € = 139.97 Lekë. Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor.

⁶ Burimi: Bilancet e audituara për vitin 2014.

⁷ Burimi: Bilancet e audituara për vitin 2014.

⁸ Kursi i këmbimit për vitin 2014. 1 £ = 173.62 Lekë. Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor.

⁹ Burimi: Bilancet e audituara për vitin e fundit financiar të mbyllur më 31.03.2015.

Për sa i përket efekteve të koordinuara të shkaktuara nga një përqendrim, rasti në fjalë nuk sjell asnjë ndryshim për tregun shqiptar duke patur parasysh se asnjë prej palëve në transaksion nuk është prezente në tregun vendas. Marka e birrës Peroni importohet dhe shpërndahet në vendin tonë nga Eurolab Internacional Group.

Për më tepër, faktorë të tillë si pjesa e tregut e ndërmarrjes pas përqendrimit (XXX%), fuqia kundërvepruese e konsumatorit apo klientëve, numri i konkurrentëve në treg, prania si e prodhuesve vendas dhe atyre të huaj me markat më të njohura në nivel global, tregon që në këtë treg ka konkurrencë midis markave të ndryshme të birrës.

Parë nga ana e kërkesës, mund të vihet re se klientët apo konsumatorët vendas do të vazhdojnë të kenë mundësinë e zgjedhjes mes produkteve të prodhimit vendas ashtu edhe atyre të importit (produkteve të prodhuesve ndërkombëtarë të birrës).

Në nivel global, pas përfutimit të kontrollit të Target-it nga ana e Asahi Group, konsumatorët pritët të përfitojnë nga rritja e gamës së produkteve si dhe rritja e efikasitetit si rezultat i ndërthurjes së teknologjisë, njohurive, eksperiencës, risive dhe kombinimit të portofoleve dhe shtrirjes gjeografike të sistemit të shpërndarjes.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Asahi Group Holdings Ltd. të biznesit të birrës të zotëruar nga SABMiller Plc.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 422, datë 22.06.2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Veneto Banca S.p.A nga Quaestio Capital Management SGR S.p.A nëpërmjet fondit Atlante

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.06.2016, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Veneto Banca S.p.A nga Quaestio Capital Management SGR S.p.A nëpërmjet fondit Atlante.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, dhe neni 16 dhe 17, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Quaestio Capital Management SGR S.p.A / Atlante/ Veneto Banca S.p.A dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Transaksioni i përqendrimit pritet të realizohet me anë të Ofertës Publike për zmadhimin e kapitalit të Banca Veneto S.p.A, nëpërmjet nënshkrimit të të gjitha ose pjesë të aksioneve që mbeten të panënshkruara në fund të Ofertës nga Quaestio Capital Management nëpërmjet fondit të saj të mbyllur ‘Atlante’. Kjo Ofertë Publike duhet të realizohet brenda datës 28 Qershor 2016 sipas udhëzimeve nga Banka Qendrore Europiane.

Në vitin 2015 i është kërkuar Veneto Banca nga Banka Qendrore Europiane (“BQE”) të fuqizojë raportin e kapitalit mbi kërkesat minimale të përcaktuara nga vetë BQE në kontekstin e procesit të Mbikëqyrjes së Rishikimit dhe Vlerësimit të Autoritetit European Bankar.

Oferta Publike është shpallur nga Bursa Italiane më datë 6 Qershor 2016. Në përputhje me informacionin e vlefshëm për publikun, Veneto Banca ka filluar procedurën e ofertës për Zmadhimin e Kapitalit Aksionar me qëllim për ta mbyllur atë më 28 Qershor.

Transaksioni është në përputhje me misionin Atlante për të mbështetur Veneto Banca dhe Veneto Banca Group, fuqizimin e përqindjes së tyre të kapitalit dhe rritjen e vlerës së tij në treg.

Transaksioni si pasojë e të cilit ndërmarrja Quaestio, nëpërmjet Atlante, do të përftojë kontrollin në Veneto Banca S.p.A dhe rrjedhimisht në mënyrë të tërthortë edhe kontrollim mbi Banka Veneto Sh.a, i cili sjell një ndryshim afatgjatë në cilësinë e kontrollit në këto të fundit, në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 27.8.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe përbën një përqendrim.

Palët në transaksion

Quaestio Capital Management SGR S.p.A (“Queastio”): në cilësinë e përfutjesit të kontrollit, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit Italian, me seli në adresën: Corso Como 15 , Milano, Itali. Ajo është një shoqëri menaxhimi e autorizuar nga Banka e Italisë. Shoqëria Quaestio është pjesë e një grupi të pavarur menaxhues asetesh me një shtrirje ndërkombëtare, duke përfshirë një shoqëri menaxhimi fondesh në Luksemburg.

Quaestio ka themeluar një fond të mbyllur investimi të quajtur Atlante, i themeluar më 12 prill 2016, i cili është i rezervuar për nënshkrimin vetëm nga Investitorë të Kualifikuar, në përputhje me legjislacionin Italian dhe atë European mbi menaxhuesit e fondeve alternative të investimit.

Veneto Banca S.p.A.: në cilësinë e ndërmarrjes target, është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në baze të legjislacionit italian, me seli në Piazza G.B. Dall’Armi 1, 31044 Montebelluna, Treviso Italy. Shoqëria është banka që drejton Veneto Banca Group, një nga 14 institucionet italiane të kredisë të konsideruara si strategjiksht të rëndësishme nga Banka Qëndrore Europiane. Veneto Banca Group është i pranishëm në të gjithë Italinë, me një rrjet degësh të ndara në tetë zyra rajonale, si dhe filialin Banca Apulia dhe shoqëritë e prodhimit Claris Leasing dhe Claris Factor.

Veneto Banka SH.A: është një shoqëri e cila është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me seli në adresën: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat binjake. Objekt i aktivitetit të shoqërisë është grumbullimi i kursimeve, dhënie kredie në forma të ndryshme si dhe çdo aktivitet tjetër financiar.

Xhiro për vitin 2015

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar¹ është XXXX Lekë:

- Quaestio Capital Management SGR S.P.A: XXXXX €² = XXXXXX Lekë
- Veneto Banca S.P.A. : XXXXXx €³ = XXXXX Lekë
- Xhiro totale në tregun e brendshëm⁴: është XXXXX Lekë:
- Veneto Banka SHA : XXXXX € = XXXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nënin12, pika 1 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “ Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

ANALIZA E KONKURENCËS

Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “ Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë: tregu përkatës i produktit, dhe tregu përkatës gjeografik.

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, tregu përkatës do të konsiderohen shërbimet bankare për individë (retail banking) dhe shërbimet bankare për korporata (corporate banking).

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm pra territori i Republikës së Shqipërisë.

¹ Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2015, 1euro=140 lekë.

² Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduara 2015 të Quaestio Capital Management SGR s.p.a., fq 10.

³ Burimi: Pasqyrat financiare për vitin 2015 të Veneto Banca s.p.a., fq 142

⁴ Burimi: Raporti Vjetor i Veneto Banca s.p.a., fq 127.

Struktura e tregut

Sektori bankar vazhdon të luajë rolin kryesor në ndërmjetësimin financiar në Shqipëri, me një strukturë që ka mbetur e pandryshuar në vitet e fundit, e përbërë nga 16 banka me kapital të gjithin privat. Pjesa më e madhe e sektorit bankar kontrollohet nga filialet e grupeve të huaja bankare me origjinë të kapitalit nga Bashkimi Europian që ushtrojnë veprimtarinë e tyre bazuar në legjislacionin shqiptar dhe në kuadrin rregullator në fuqi të Bankës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2015, numri I bankave me pronësi të kapitalit vendas u rrit në tre.

Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Transaksioni i njoftuar konsiston në një përfitim (të mundshëm) të kontrollit nga Quaestio (nëpërmjet Atlante) mbi Veneto Banca S.p.A, me anë të nënshkrimit të të gjitha ose pjesë të aksioneve që mbeten të panëshkruara në fund të ofertës për aksione të Veneto Banca S.p.A

Përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri pasi shoqëria Quaestio Capital Management SGR S.p.A. nuk ka asnjë aktivitet në Shqipëri.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese sipas parashikimeve të nenit 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Veneto Banca S.p.A nga Quaestio Capital Management SGR S.p.A nëpërmjet fondit Atlante.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 425, datë 14.07.2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të tërthortë të shoqërisë A4 Holding S.p.A nga Abertis Infraestructuras S.A

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.07.2016, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati), Znj. Servete Gruda, Z. Koço Broka dhe Znj. Iva Zajmi shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të tërthortë të shoqërisë A4 Holding S.p.A nga Abertis Infraestructuras S.A..

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12 dhe 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Abertis Infraestructuras S.A / A4 Holding S.p.A dhe relacionit shoqërues të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshjeve për shitjen dhe blerjen e aksioneve” të nënshkruara përkatësisht ndërmjet shoqërisë Abertis Infraestructuras S.A (“Abertis”) dhe aksionarëve kontrollues të shoqërisë Re Consult Infrastrutture S.p.A me objekt përfutimin e kontrollit indirekt të xx% të kapitalit aksionar në shoqërinë Target A4 Holding S.p.A (“A4 Holing”); si dhe ndërmjet shoqërisë Abertis Infraestructuras S.A dhe Intesa Sanpaolo S.p.A me objekt përfutimin e kontrollit indirekt të xx% të kapitalit themeltar në shoqërisë A4 Holding S.p.A. marrëveshjet të cilat përbëjnë së bashku transaksionin e përqendrimit, janë nënshkruar më datë 9 Maj 2016.

Përqendrimi konsiston në përfutimin në mënyrë të tërthortë nga shoqëria Abertis të afërsisht xx% të kapitalit aksionar të A4 Holding, të cilat do të rezultojnë në ndryshimin faktik të kontrollit të shoqërisë Target.

Transaksioni i përqendrimit me anë të së cilit shoqëria Abertis hyn si aksionar i ri kontrollues në shoqërinë A4 Holding dhe për pasojë edhe në shoqërinë shqiptare Srenissima Construzioni Tirana Sh.p.k përbën një ndryshim kontrolli mbi baza të qëndrueshme dhe përbën një përqendrim në bazë të nenit 10.1.b) të Ligjit nr. 9121, datë 27.8.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

Palët në transaksion

Abertis Infraestructuras S.A (“Abertis”): në cilësinë e përfutuesit të kontrollit është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit spanjoll, me seli në adresën: Avinguda Pedralbes 17, Barcelona 08034,

Spanjë. Ajo është shoqëria fundore mëmë e Grupit Abertis. Grupi Abertis është aktiv në menaxhimin e autostradave me pagesë dhe në fushën e infrastrukturave të telekomunikacionit satelitor dhe tokësor, etj.

A4 Holding S.p.A (“A4 Holding”), në cilësinë e shoqërisë target, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit italian, me seli në adresën: Via Flavio Gioia 71, Verona, Itali. Ajo është një sipërmarrje e cila operon në fushën e infrastrukturës, pasurive të paluajtshme, telekomunikacionit dhe transportit, etj.

Në Shqipëri, A4 Holding është e pranishme me anë të degës Serenissima Costruzioni Tirana Sh.p.k, degë e Serenissima Costruzioni S.p.A e cila kontrollohet nga A4 Holding.

Serenissima Costruzioni Tirana Sh.p.k është e përfshirë në ndërtimet infrastrukturore në: (rruga Kthesa e Patosit – Rroskovec (rizeksionim); (ii) By Pasi Fier – Levan; dhe (iii) By Pasi Vlorë. Shoqëria ka si objekt ndërtimin e përgjithshëm të rrugëve, hekurudhave, linjave të tramvajit, metrove, teleferikëve pistave të aeroporteve, të impianteve për sinjalizimin me dritë dhe sigurinë e trafikut të shenjave rrugore jo me dritë, të barrierave dhe mbrojtëseve rrugore dhe të çdo veprë tjetër që ka lidhje me to, etj.

Xhiro për vitin 2015

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar¹ është xxxx Lekë:

— Abertis Infraestructuras S.A.: xxxx €² = xxxxx Lekë

— A4 Holding S.P.A. xxxxx €³ = xxxxxx Lekë

Xhiro totale në tregun e brendshëm⁴: është xxxxxx Lekë:

— Serenissima Costruzioni Tirana SHPK : xxxxxx Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma b) të Ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Tregu Përkatës

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ndërtimeve në infrastrukturë.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm pra territori i Republikës së Shqipërisë.

Efektet në treg pas përqendrimit

Transaksioni i propozuar konsiston në një përfitim të kontrollit të vetëm nga Abertis Infraestructuras S.A mbi A4 Holding S.P.A. si e tërë.

Përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim të strukturës së tregut në Shqipëri pasi Grupi Abertis nuk është prezent në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonjë formë tjetër aktiviteti), ndërkohë që A4 Holding është e pranishme vetëm në fushën e ndërtimeve në infrastrukturë, me anë të Serenissima Costruzioni.

Komisioni i Konkurrencës kërkon që shoqëria objekt transaksioni të zbatojë detyrimet kontraktuale të ndërtimeve në infrastrukturë në Shqipëri pavarësisht ndryshimit të kontrollit në tregun ndërkombëtar.

¹Burimi: Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2015, 1euro=140 lekë.

²Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduar për vitin 2015 të Abertis Infraestructuras S.A s.p.a., fq 55.

³Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduar për vitin 2015 të A4 Holding S.P.A., fq 45

⁴Burimi: Pasqyrat financiare të konsoliduar për vitin 2015 të Serenissima Costruzioni Tirana sh.p.k, fq 5.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar:

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të tërthortë të shoqërisë A4 Holding S.p.A nga Abertis Infraestructuras S.A.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 426, datë 20.07.2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurosig SH.A të shoqërisë Insig SH.A

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.07.2016, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurosig SH.A të shoqërisë Insig SH.A”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12,16 në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Plotë “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit “Eurosig SH.A – Insig SH.A”,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi realizohet me anë të “Kontratë për shitblerjen e aksioneve të aksioneve të shoqërisë aksionare Insig SH.A” e nënshkruar midis palëve Eurosig SH.A (“Blerësi”) dhe Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike (“Shitësi”), me objekt përfutimin të kontrollit e plotë të 100% të kapitalit të shoqërisë Insig SH.A (“Target”) nga Eurosig SH.A, datë 1 Qershor 2016.

Objekti i transaksionit është transferimi nga Shitësi tek Blerësi i 1700 aksioneve të shoqërisë Insig SH.A dhe çdo e drejtë që u përket aksioneve, të lira nga çdo barrë . Në datën e mbylljes , Blerësi do të jetë pronari i 100% të aksioneve të Insig SH.A me vlerë minimale 600 000 lekë për aksion, të lira dhe të pastra nga të gjitha pretendimet dhe barrë e çdo lloji.

Ky transaksion i cili shkakton ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit të shoqërisë Insig SH.A në formën e privatizimit të ndërmarrjes shtetërore nga shoqëria Eurosig SH.A, në bazë të nenit 10, pika 1) shkronja b) i Ligjit nr. 9121 , datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”), përbën një përqendrim.

Palët në transaksion

Eurosig SH.A (“Eurosig”): në cilësinë e ndërmarrjes Blerëse është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të Ligj nr. 52/2014 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit”, me seli në adresën: Rr. Papa Gjon Pali II-të, vila 5- katëshe, Tiranë. Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj “sigurimet për dëme” në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar, si dhe autorizimin e lëshuar nga AMF të RSh-së.

Insig SH.A (“Insig”) : në cilësinë e ndërmarrjes Target, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të Ligj nr. 52/2014 “Për veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit” me seli në adresën: Rr. e Kavajës nr. 116, Njësia Bashkiake nr. 7, Tiranë. Veprimtaria e shoqërisë ushtrohet në fushën e sigurimeve për dëmet, sigurimeve të jetës si dhe veprimtarive të risigurimit.

Xhiro për vitin 2015

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXXX Lekë:

— Eurosig SHA¹ : XXXXX Lekë

— Insig SHA² : XXXXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, gërma b) të Ligjit.

Tregu Përkatës

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet tregu i sigurimit të jetës dhe jo jetës.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm pra territori i Republikës së Shqipërisë.

Efektet në treg pas përqendrimit

Transaksioni i njoftuar përbën një përfitim të drejtpërdrejtë kontrolli në masën 100% të shoqërisë Insig SH.A nga shoqëria Eurosig SHA. Të dy shoqëritë do të vazhdojnë aktivitetin e tyre si njësi ekonomike të pavarura me emër tregtar respektivisht Insig SH.A dhe Eurosig SH.A dhe nuk parashikohet një bashkim mes tyre në periudha afatshkurtra.

Transaksioni i ndryshimit të kontrollit mbi shoqërinë Insig, nuk sjell mbivendosje horizontale të veprimtarisë ekonomike të palëve në transaksion sa i përket sigurimit të jetës, pasi shoqëria Eurosig SH.A nuk është prezente në këtë segment produkti. Si pasojë, struktura dhe niveli i përqendrimit HHI në këtë segment nuk ndryshon. Ky transaksion nuk sjell asnjë efekt për këtë lloj produkti.

Në segmentin e sigurimit të jo – jetës janë aktive të dy shoqëritë, pjesë e këtij transaksioni. Ky transaksion shkakton mbivendosje horizontale të veprimtarisë së palëve apo tregjeve të prekura. Pjesa e tregut e kombinuar për të dy shoqëritë do të rezultonte 21.05%, gjithsesi para dhe pas transaksionit asnjëra nga ndërmarrjet objekt i përqendrimit të analizuar, Eurosig SH.A dhe Insig SH.A nuk zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës.

Pavarësisht rritjes së nivelit të përqendrimit të tregut, ky transaksion nuk e vendos ndërmarrjen e përqendruar në një pozicion të tillë, i cili i jep mundësi asaj të vështirësojë zgjerimin apo të kufizojë aftësinë e aktorëve të tjerë në treg për të konkurruar.

Kjo nisur dhe nga fakti i prezencës në treg i konkurrentëve si Sigal Uniqa Group Austria dhe Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group, respektivisht pjesë e grupeve Uniqa Group dhe Vienna Insurance Group, grupe lider sa i përket sigurimeve në Austri dhe Europën Qendrore dhe Lindore, me një prezencë afatgjatë dhe fuqi ekonomike të konsoliduar.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

¹Burimi: Pasqyrat financiare për vitin 2015 i shoqërisë Eurosig sh.a.

²Burimi: Pasqyrat financiare për vitin 2015 i shoqërisë Insig sh.a.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurosig SH.A të shoqërisë Insig SHA
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 427, datë 20.07.2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Novamatic Gaming Industries GmbH të 100% të kapitalit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding GmbH.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.07.2016, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Novamatic Gaming Industries GmbH të 100% të kapitalit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft m.b.H”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12,16 në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit ‘Novamatic Gaming Industries GmbH / Österreichische Holding Gesellschaft m.b.H / Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft m.b.H / Lotaria Kombëtare SHPK’,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi realizohet me anë të “Kontratë Blerjeje dhe Transferimi të Kuotave” e nënshkruar midis palëve Novamatic Gaming Industries GmbH (“Blerësi”) dhe Österreichische Holding Gesellschaft m.b.H (“Shitësi”), me objekt transferimin e 100% të kapitalit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft m.b.H (“Target”), më datë 3 Maj 2016.

Objekti i transaksionit është përfutimi i kontrollit indirekt nga shoqëria Novamatic A.G me anë të transferimit të të gjithë kapitalit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft m.b.H dhe për rrjedhojë edhe të shoqërisë Lotaria Kombëtare SHPK Me anë të kësaj kontrate shitësi i shet blerësit sipas dispozitave të saj, kuotat objekt i kontratës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

Ky transaksion, i cili shkakton përfutimin e ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft m.b.H dhe në mënyrë indirekte të shoqërisë Lotaria Kombëtare Sh.p.k në formën e ndryshimit të ortakut kontrollues nga Shitësi tek shoqëria Novamatic Gaming Industries GmbH, në bazë të nenit 10, pika 1) shkronja b) i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, përbën një përqendrim.

Palët në transaksion

Novamatic Gaming Industries GmbH (“NGI”): në cilësinë e ndërmarrjes Blerëse është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit austriak me seli në adresën: Wiener Str. 158, A-2352 Gumpoldskirchen, Austria. Ajo është aktive në prodhimin e komponentëve, të cilët përdoren më pas për

fabrikimin dhe assemblimin e pajisjeve të lojërave elektronike. Portofoli i NGI-së për терминаlet e lojërave elektronike dhe zgjidhjet teknologjike i përmban të gjithë segmentet e produkteve të industrisë së lojërave të fatit. Shoqëria është prezente në Shqipëri me anë të filialit të saj Eagle Investment SHA

Albanisch Österreichische Lotterien Holding Gesellschaft m.b.h (AÖLGH): në cilësinë e shoqërisë Target, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit austriak me seli në adresën: Rennweg 44, A- 1038, Vienë, Austri. Shoqëria zotëron filialin e saj në Shqipëri, shoqërinë Lotaria Kombëtare Sh.p.k (“LK”) , e njohur gjithashtu si lotaria kombëtare në Shqipëri, e cila përbën dhe objektin ekonomik të transaksionit. LK është e pajisur me licencën ekskluzive të Lotarisë Kombëtare për 10 vjet nga Ministria e Financave në bazë të Marrëveshjes së Licencës të ratifikuar me Ligj nr. 95/2013.

Xhiro për vitin 2015

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXXXX Lekë:

— Novomatic AG = XXXX millionë €= XXXXX Lekë

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXXX Lekë:

— Lotaria Kombëtare= XXXXX Lekë;

— Eagle Investment SH.A = XXXXX Lekë;

— Adriatik Game SH.A = XXXXX Lekë;

— Astra Albania SH.A= XXXXX Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, g. b) të Ligjit.

Tregu Përkatës

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe sa më sipër, treg përkatës në analizën e këtij përqendrimi është tregu i lojërave të lotarisë.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti *treg përkatës gjeografik* do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Efektet në treg pas përqendrimit

Novomatic Gaming Industries nuk është prezent në tregun përkatës të produktit në Shqipëri, prandaj ky përqendrim nuk sjell shqetësime për konkurrencën në vendin tonë.

Shoqëria Novomatic Gaming Industries është prezente në Shqipëri me anë të filialit të saj Eagle Investment SH.A, një shoqëri holding, e cila ka në pronësi të saj: (i) Astra Albania SH.A; (ii) Adriatik Game SH.A; (iii) Albatën SHPK

Astra Albania SH.A dhe Adriatik Game SH.A janë aktive në një treg tjetër produkti, atë të lojërave të fatit me anë të kazinove elektronike, prandaj nuk ka mbivendosje të veprimtarive të palëve në tregjet përkatëse. Pas realizimit të përqendrimit nuk do të ketë ndryshime të pjesëve të tregut të shoqërive që operojnë në tregjet përkatëse.

Gjithashtu, sipas ligjit të ri për lojërat e fatit në Shqipëri, nr. 155/2015, çdo aktivitet i licencuar i kazinosë elektronike nuk do të jetë më i lejuar pas 31 dhjetorit 2016. Për këtë arsye, të gjitha veprimtaritë e Novomatic Group që kanë lidhje me kazinotë elektronike në Shqipëri do të përfundojnë në 31.12.2016.

Pas përfutimit indirekt të kontrollit të Lotarisë Kombëtare nga ana e Novomatic Gaming Industries, NGI pritët të sjellë teknologjitë më të fundit të lojërave të lotarive për të rritur cilësinë e shërbimeve të LK, si dhe do të rrisë atraktivitetin e produkteve të ofruara për pjesëmarrësit në lojërat e lotarive në Shqipëri.

Në ndryshimin e përfituesit të kontrollit në kontratën konçesionare për lotarinë kombëtare duhet të mbahen parasysh performanca e operatorit dhe kushtet dhe detyrimet që përmban kjo kontratë sipas parashikimeve të Ligjit 95/2013 “Për miratimin e Marrëveshjes së Licencës për Lotarinë Kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “ÖESTERREICHISCHE LOTTERIEN”, GmbH nëpërmjet shoqërisë “ÖLG Project” Sh.p.k”

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Novamatic Gaming Industries GmbH të 100% të kapitalit të shoqërisë Albanisch Österreichische Holding Gesellschaft m.b.H.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 431, datë 14.09.2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurokontakt Sh.p.k të 100% të kapitalit të shoqërisë Lion Real Estate Albania SHPK

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.09.2016, shqyrtoi çështjen me :

- Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Eurokontakt Sh.p.k të 100% të kapitalit të shoqërisë Lion Real Estate Albania Sh.p.k”.
- Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12,16 në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.
- Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit ‘Eurokontakt Sh.p.k / Lion Real Estate Albania Sh.p.k / Lion Retail Holding S.A.R.L’,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi realizohet me anë të “Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e Lion Real Estate Tirana Sh.p.k” e nënshkruar midis palëve Eurokontakt Sh.p.k (“Blerësi”) dhe Lion Retail Holding (“Shitësi”), më datë 1 Korrik 2016, në lidhje me transferimin e 100% të kuotave të shoqërisë Lion Real Estate Tirana Sh.p.k nga Shitësi tek Blerësi.

Me anë të kësaj marrëveshje Shitësi shet të gjitha kuotat e lira nga çdo barrë së bashku me të gjitha të drejtat bashkëlidhur, duke përfshirë dhe të drejtën e dividendëve nga data e mbylljes së marrëveshjes. Duke përfutur kontrollin 100% të kuotave të shoqërisë Target nga Blerësi, ky i fundit përfton edhe pronësinë e saj me të gjitha të drejtat që lindin nga to.

Ky transaksion i cili shkakton ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit të shoqërisë Lion Real Estate Tirana Sh.p.k në formën e shitjes dhe transferimit të 100% të kuotave nga Shitësi tek Blerësi, në bazë të nenit 10, pika 1) shkronja b) i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, përbën një përqendrim.

Palët në transaksion

Eurokontakt Sh.p.k: në cilësinë e ndërmarrjes Blerëse është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Rruga Dhaskal Todri, Godina nr. 33, Kashar, Tiranë. Ajo është aktive në (i) shpërndarjen me shumicë të pijeve jo-alkoolike freskuese; (ii) import – eksport, tregtim të pajisjeve dixhitale, radiotelevizive, informatike, komunikacion, industriale, elektrike; (iii) prodhimin fabrikimin dhe tregtimin e materialeve të ndërtimit , inerte , prodhime të betonit , etj.;

Lion Real Estate Albania Sh.p.k : në cilësinë e shoqërisë Target, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Autostrada Tiranë –Durrës, km 7, Tiranë.

Objekti i shoqërisë është (i) veprime me pasurinë e paluajtshme, shitje dhe blerje të pasurive të paluajtshme, qiradhënie e pasurive të paluajtshme dhe shërbime logjistike, etj..

Xhiro për vitin 2015

Xhiro totale në tregun e brendshëm : është XXX Lekë:

— Eurokontakt SHPK : XXX Lekë

— Lion Real Estate Albania SHPK : XXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa b) të Ligjit.

Tregu Përkatës

Tregu përkatës i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do të konsiderohet tregu i pasurive të paluajtshme, pra zotërimi, mirëmbajtja dhe qiradhënia e pasurive të paluajtshme.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik është konsideruar tregu i brendshëm pra territori i Republikës së Shqipërisë.

Efektet në treg pas përqendrimit

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Lion Real Estate Albania sh.p.k (Target-i) nga shoqëria Eurokontakt SHPK nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave nga shoqëria mëmë Lion Retail Holding S.A.R.L..

Tregu i pasurive të paluajtshme: zotërimi, mirëmbajtja dhe qiradhënia e pasurive të paluajtshme në Shqipëri është një treg shumë i gjerë. Blerësi dhe targeti operojnë në tregje të ndryshme, pra nuk ka mbivendosje.

Për sa më sipër, ky përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim të strukturës së tregut në Shqipëri dhe nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar të përfimit të kontrollit nga shoqëria Eurokontakt Sh.p.k të 100% të kapitalit të shoqërisë Lion Real Estate Albania SHPK
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 433, datë 21.09.2016

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria GMBF Investment S.a.r.l të shoqërive NV Biscuits Delacre SA dhe United Biscuits Industries SAS nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.09.2016, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria GMBF Investment S.a.r.l të shoqërive NV Biscuits Delacre SA dhe United Biscuits Industries SAS nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12,16 në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit ‘GMBF Investment S.a.r.l / NV Biscuits Delacre SA / United Biscuits Industries SAS’,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi realizohet me anë të “Ofertës detyruese për të blerë aksionet në NV Biscuits Delacre S.A dhe United Biscuits Industries SAS të zotëruara përkatësisht nga United Biscuits Holdco 2 Limited dhe United Biscuits France SAS” e datës 1 Qershor 2016.

Palët pjesëmarrëse, brenda gjashtë muajve nga nënshkrimi i letrës së ofertës, do të lidhin marrëveshjen e shitblerjes së aksioneve sipas përmbajtjes bashkëlidhur letrës së ofertës

Ky transaksion, i cili shkakton ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit të shoqërive Target NV Biscuits Delacre S.A dhe United Biscuits Industries SAS në formën e shitjes dhe transferimit të 100% të kapitalit themeltar nga shitësi tek blerësi, në bazë të nenit 10, pika 1) shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, përbën një përqendrim.

Palët në transaksion

GMBF Investment S.a.r.l (GMBF Investment): në cilësinë e ndërmarrjes blerëse është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Dukatës së Madhe të Luksenburgut, me seli në adresë: 67, Boulevard de la Petrusse, L-2320 Luxembourg. Shoqëria ka si objekt dhe mund të kryejë (i) të gjitha transaksionet që kanë të bëjnë direkt ose indirekt me marrjen e interesave pjesëmarrëse në ndonjë sipërmarrje të çfarëdo forme, si dhe administrimin, menaxhimin, kontrollin dhe zhvillimin e interesave të tilla pjesëmarrëse, në Dukatën e Madhe të Luksenburgut dhe jashtë vendit, etj.;

United Biscuits Industries SAS (“United Biscuits”): në cilësinë e ndërmarrjes target është një shoqëri e themeluar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin francez me seli në adresën: 116 rue Bellevue 59850 Nieppe, Francë. Shoqëria ka si aktivitet kryesor (i) fabrikimin, tregtimin, përfaqësimin e të gjitha produkteve ushqimore bujqësore duke përfshirë biskota të të gjitha llojeve dhe të gjitha transaksioneve të lidhura me to; (ii) tregtinë më shumicë dhe me pakicë të ëmbëlsirave dhe produkteve të ëmbëltoreve në përgjithësi.

NV Biscuits Delacre SA (“Biscuits Delacre”): në cilësinë e ndërmarrjes target është një shoqëri e themeluar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin belg me seli në adresën: 1702 Garnd- Bigard, A, Gossetlaan, Belgjikë. Shoqëria ka si objekt (i) prodhimin, blerjen, shitjen, importin dhe eksportin dhe tregtinë me shumicë dhe pakicë të biskotave, çokollatave, ëmbëlsirave, karamелеve, produkteve të pastičerisë dhe ushqimeve të tjera; (ii) mund të ofrojë shërbimet e marketingut , financiare ,administrative, teknike dhe shërbime të tjera për çdo shoqëri tjetër apo individëve; (iii) mund të aplikojë, marrë, të mbajë, shesë, shfrytëzojë patentat, licencat e prodhimit, në lidhje me ose të njëjta me qëllimin e shoqërisë, etj.

Xhiro për vitin 2015

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXXXX Lekë:

- Ferrero International S.A = XXX milionë € = XXXXX Lekë;
- United Biscuits Industries SAS = XXXXX € = XXXXX Lekë;
- NV Biscuits Delacre S.A = XXXX € = XXXXX Lekë.

Xhiro totale në tregun e brendshëm është XXXXX Lekë:

- Inter Trade & Distribution sh.p.k = XXX milionë Euro = XXXX Lekë;
- Kosmonte Foods Tirana sh.p.k = XXX milionë Euro = XXXX Lekë.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, germa b) të Ligjit.

Tregu Përkatës

Tregu përkatës i produktit: Duke marrë parasysh aktivitetet e palëve pjesëmarrëse në transaksion si dhe referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregjet përkatëse në analizën e këtij përqendrimi janë si më poshtë:

- Tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave prej çokollate;
- Tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave në formë kremi;
- Tregu i prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave me përmbajtje qumështi dhe;
- Tregu i prodhimit dhe shitjes së biskotave.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Efektet në treg pas përqendrimit

Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e plotë të kontrollit nga GMBF Investment S.A.R.L të 100% të kapitalit themeltar dhe të drejtat e votës të shoqërive target United Biscuits Industries SAS dhe NV Biscuits Delacre S.A.

Ferrero është aktiv në tregun shqiptar në shitjen e ëmbëlsirave të çokollatës, produkteve të ëmbla në formë kremi si dhe ëmbëlsirave të freskëta prej qumështi me anë të dy distributorëve vendas. Ndërsa NV Biscuits Delacre dhe United Biscuits Industries (ndërmarrjet Target) nuk janë të pranishëm në Shqipëri dhe nuk kanë shitje.

Transaksioni i propozuar nuk do të ketë efekte në konkurrencën në tregun shqiptar, sepse ndërmarrjet target nuk janë të pranishme në Shqipëri. Si pasojë, nuk kemi një mbivendosje horizontale të veprimtarive ekonomike të shoqërive target dhe blerësit apo ndërmarrjeve të zotëruara nga grupi Ferrero. Gjithashtu, ndërmarrjet target nuk veprojnë në tregjet e rrjedhës së sipërme në Shqipëri apo në tregun global, e cila mund të sillte efekte negative për konkurrentët e Ferrero-s.

Ky transaksion nuk pritet të sjellë një fuqizim të pozitës ekonomike të grupit Ferrero në vendin tonë, duke qënë se ndërmarrjet target nuk kanë shitje dhe as prezencë të drejtpërdrejtë. Presioni konkurrencial për produktet e grupit Ferrero do të ngelet sërish i njëjtë, duke qënë se tregu vendas nuk paraqet barriera në hyrje për konkurrentët ekzistues apo ato të rinj.

Pas përfutimit të plotë të kontrollit të NV Biscuits Delacre dhe United Biscuits Industries nga ana e GMBF Investment, grupit Ferrero do i jepet mundësia që të hyjë në tregun e biskotave duke zgjeruar portofolin e produkteve të ofruara aktualisht në tregun global.

Për sa më sipër, ky përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim të strukturës së tregut në Shqipëri dhe nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria GMBF Investment S.a.r.l të shoqërive NV Biscuits Delacre SA dhe United Biscuits Industries SAS nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 445 , datë 13.12.2016

Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Fondi BESA SHA të shoqërisë VisionFund Albania SHPK.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.12.2016, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Fondi BESA SHA të shoqërisë VisionFund Albania sh.p.k”.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12,16 në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Plotë “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit për vlerësimin e njoftimit të përqendrimit ‘Fondi Besa SH.A – VisionFund Albania SHPK,

VËREN SE:

TRANSAKSIONI DHE PËRQENDRIMI

Përqendrimi realizohet me anë të “Kontratë për shitjen dhe blerjen e të gjithë kapitalit të emetuar të VisionFund Albania SHPK” datë 1 nëntor 2016, e nënshkruar midis palëve Fondi Besa SHA (“Blerësi”) dhe VisionFund International (“Shitësi”), me objekt përfutimin e kontrollit të plotë të 100% të aksioneve të shoqërisë VisionFund Albania SHPK (“Target”) nga Fondi Besa SHA Objekti i transaksionit është transferimi nga Shitësi tek Blerësi i 100% të aksioneve të shoqërisë VisionFund Albania SHPK

Në datën e mbylljes, Blerësi do të jetë pronari i 100% të aksioneve të VisionFund Albania SHPK

Ky transaksion, i cili shkakton ndryshimin e qëndrueshëm të kontrollit të shoqërisë VisionFund Albania sh.p.k nga shoqëria Fondi Besa SH.A, në bazë të nenit 10, pika 1) shkronja b) i Ligjit Nr. 9121 , datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, përbën një përqendrim.

Palët në transaksion

Fondi BESA SHA : në cilësinë e ndërmarrjes Blerëse është një shoqëri e themeluar në datë 10.07.2008, në Shqipëri me NUIS K81911023C dhe seli në adresën Rr. Brigada VIII, Pall 5, Tiranë. Fondi BESA SHA është një institucion financiar jo bankë, i cili në përputhje me statusin e tij si Institucion Financiar Jo-Bankë dhe me licencë nga Banka e Shqipërisë ka si objekt:

- të gjitha format e kredithënies, duke përfshirë kredinë konsumatore dhe hipotekare,
- të ofrojë shërbimin e ofrimit të garancive dhe marrjen e angazhimeve; si dhe

- të ofrojë shërbime këshilluese, ndërmjetësuese dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara më sipër.

Fondit Besa SH.A operon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me 35 degë.

VisionFund Albania SHPK: në cilësinë e ndërmarrjes Target, është një organizatë e themeluar më 06.02.2007, me adresë në Rr. Ibrahim Rugova, Pall nr 26, kati 3, Tiranë, në pronësi dhe në kontroll të VisionFund International. VisionFund Albania sh.p.k është licencuara nga Banka e Shqipërisë me licencë nr 17, dt 30.12.2009 “Për subjektet financiare jo banka” për të ushtruar veprimtarinë financiare si institucion financiar i mikrokredisë.

Aktiviteti i VisionFund Albania përqendrohet në fushën e mikrofinancës. VisionFund Albania ofron gjithashtu kredi për biznese dhe agrikulturë, kredi për përmirësimin e kushteve shtëpiake, kredi sociale për shëndet apo edukim.

VisionFund Albania aktualisht ka pesë zyra në të gjithë vendin, duke mbuluar zonat veriore, juglindore dhe zonat e Shqipërisë së mesme.

Xhiro për vitin 2015

Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXXX Lekë:

- VisionFund International: XXXX USD = XXXXX Lekë

Xhiro totale në tregun e brendshëm: është XXXXX Lekë:

- Fondacioni Albanian Besa Capital : XXXXX Lekë
- Fondi BESA SHA : XXXXX Lekë
- VisionFund Albania : XXXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1, të Ligjit.

Tregu Përkatës

Tregu përkatës i produktit: referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do konsiderohet tregu i kredisë dhe mikrokredisë të ofruara nga SFJB-të.

Tregu përkatës gjeografik: Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

Efektet në treg pas përqendrimit

Fondi Besa paraqitet me një pjesë tregu nën 50%. Edhe pas përqendrimit, pjesa e kombinuar e tregut të dy palëve mbetet poshtë këtij niveli. Prezenca e dy ndërmarrjeve të tjera në treg Tranzit dhe NOA, si aktorët me pjesët më të larta të tregut pas Fondit Besa si dhe prania e 6 subjekteve të tjera më të vogla në treg është një tregues i mundësisë së klientëve për të zgjedhur. Tregu gjatë vitit 2015 paraqitet i hapur (licencimi për kredi dhe mikrokredi), dhe kjo evidentohet nga hyrja e tre konkurrentëve të rinj në treg si Micro Credit Albania SHPK, Iutecredit Albania SHA dhe Agro Partner SHPK

VizionFund Albania, mbi të cilin Fondi Besa perfton kontrollin e drejtpërdrejtë, zë një pjesë të vogël të tregut dhe fuqia e saj në treg është e limituar.

Niveli i indeksit HHI në rastin e përfatimit të kontrollit të VisionFund Albania nga Fondi Besa, paraqet nivele të larta përqendrimi në treg, si para dhe pas përqendrimit (>1800). Ky transaksion nuk paraqet problem në lidhje me konkurrencën në nivel horizontal.

Referuar Udhëzimit Për Vlerësimin e Përqendrimeve Horizontale, sipas rregullores së Këshillit mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve (2004/C 31/03), mund të mos identifikohen probleme që lidhen me konkurrencën në nivel horizontal, në ato përqendrime ku indeksi HHI pas përqendrimit është mbi 2000 dhe një delta nën 150. Nga ky transaksion, ndryshimi i vlerës së indeksit HHI është 93.4.

Pas realizimit të përqendrimit fuqia ekonomike e Fondit Besa ngelet në të njëjtat nivele si para transaksionit, duke pasur parasysh pjesën e vogël të tregut që zë VisionFund Albania. Gjithashtu edhe kushtet e tregut për koordinim nuk ndryshojnë, pasi rëndësia e konkurrentëve kryesorë në treg ngelet e njëjtë, pavarësisht uljes së numrit të tyre.

Sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

- I. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Fondi Besa SH.A të shoqërisë VisionFund Albania SHPK
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit, pasi të bëhen pagesat që parashikon Rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME ME OBJEKT - ABUZIM ME POZITËN DOMINUESE

VENDIM

Nr. 415, datë 4.05.2016

Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë).

Komisioni i Konkurrencës, me përbërje si vijon:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij, të datës 4.05.2016, trajtoi çështjen me:

- Objekt:** Shqyrtimi i raportit të monitorimit në tregun farmaceutik për produktin “Lantus” (insulin).
- Baza ligjore:** Neni 24 (shkronja d), neni 26 dhe 42, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Grupit të Punës mbi monitorimin e tregut farmaceutik për produktin “Lantus” (insulin).

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, më datë 27.04.2016, shkresa nr. 158 prot, është depozituar një ankesë me objekt vendosjen e kushteve dhe detyrimeve në tregun farmaceutik. Nëpërmjet kësaj ankese pretendohet se ndërmarrja “Fufarma Sh.a” me objekt të aktivitetit të saj: tregtim, import, shitje me shumicë dhe pakicë të mediakamenteve dhe pajisjeve mjekësore, abuzon me pozitën e saj dominuese në tregun e produktit “Lantus” (insulinë).

Sipas ankuesit ndërmarrja “Fufarma Sh.a” zotëron të drejtat e vetme të tregtimit të medikamentit “Lantus” (insulina), i cili është një produkt i domosdoshëm për të sëmurët diabetik dhe njëkohësisht është një medikament i rimbursueshëm nga fondi i sigurimeve shëndetësore.

Sipas ankeses: “Duke patur të drejtën e tregtimit e vetme të medikamentit “Lantus”, ndërmarrja “Fufarma Sh.a” vendos kushte shtesë duke detyruar çdo farmaci të blejë në të njëjtën transaksion edhe 10 paketa Enterogermin (një tjetër produkt)”.

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në ndjekje të procedurave ligjore për vlerësimin e ankësës, më datën 28/04/2016 realizoi një monitorim pranë farmacive, lidhur me problematikën e ngritur nga ana e ankimuesit si më sipër.

Nga monitorimi në terren rezulton se: problematika e ngritur lidhur me sjelljen e ndërmarrjes “Fufarma Sh.a” në vendosjen e kushteve për të blerë medikamente shtesë gjatë blerjes së produktit “Lantus”, është prezente në farmacitë me kontratë me ISKSH-në. Farmacistët pranojnë se ky problem ka ardhur duke u shtuar gjatë tre javëve të fundit, ku edhe sasia e mallrave shtesë që u kërkohet të blihen bashkë me “Lantus” nga ana e ndërmarrjes “Fufarma Sh.a” është shtuar.

Gjatë monitorimit u pranua nga ana e farmacistëve se kushtet e vendosura nga ana e Fufarma Sha gjatë blerjes së “Lantus” kanë qenë prezente edhe gjatë vitit të kaluar, por sasia shtesë e mallrave që kërkohej të blihej ishte më e vogël.

Nga faturat e blerjes së “Lantus”, të mara në disa farmaci, rezulton se përveçse “Lantus” ato përmbajnë edhe produkte të tjerë shtesë, gjë e cila lë dyshime për një sjellje që vendos kushte dhe detyrime nga ana e ndërmarrjes “Fufarma Sh.a”.

Për sa mësipër, bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), nga të dhënat e mbledhura gjatë monitorimit, rezulton se ndërmarrja “Fufarma Sha”, me aktivitet import, shitje me shumicë dhe pakicë të medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore, zotëron pozitë dominuese në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë).

Në këto rrethana, vendosja e kushteve dhe detyrimeve shtesë për të blerë edhe medikamente të tjera mjekësore bashkë me produktin “Lantus” (insulinë) nga ana e ndërmarrjes “Fufarma Sha”, mund të përbëjë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 9, nenit 24, shkronja d, dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe nenit 4 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë), për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
 - II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore Shtator 2015- Prill 2016.
 - III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligjin nr. 9121 dhe në aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se 2 muaj nga marrja e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 417, datë 18.05.2016

Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport”

Komisioni i Konkurrencës, me përbërje si vijon:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.05.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqytimin e raportit mbi “Monitorimin e tregut të furnizimit me karburant të avionëve në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit dhe propozimin e marrjes së masave të përkohshme”.

Baza ligjore: Nenet 2, gërma c, 24 gërma d dhe neni 42, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të Grupit të Punës mbi monitorimin e tregut të furnizimit me karburante të avionëve në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit dhe propozimin për marrjen e masave të përkohshme”;

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet Vendimit nr. 116, datë 29.05.2009 “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes midis TIA SHPK dhe AIR BP Albania “Për përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes midis "Tirana International Airport" SHPK dhe "AIR BP Albania" Sh.a , "Për sigurimin e depozitimit dhe tregtimit të karburantit për avionë, si dhe të shërbimit të furnizimit të avionëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza"", ka përjashtuar nga ndalimi marrëveshjen e sipërcituar ku sipas pikës 3.7 të marrëveshjes, marrëveshja i jepte të drejtën ekskluzive AIR BP deri në 31 dhjetor 2014 ose deri kur numri i udhëtareve të kalojë 2 milion pasagjerë në një vit kalendarik.

Pavarësisht se duke filluar nga data 01 janar 2015 ka përfunduar ekskluziviteti i tregtimit të karburanteve për avionë në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar të Tiranës, ky treg mbetet monopol i shoqërisë Air BP, si i vetmi operator që ofron këtë shërbim në tregun e transportit ajror të pasagjerëve.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, më datë 27.04.2016 është depozituar shkresa nr.157 prot e Shoqatës së Hidrokarbureve mbi "Problemet që lidhen me monopolin e furnizimit me kerozinë të avionëve në aeroportin ndërkombëtar "Nënë Tereza", në të cilën parashtrohen disa shqetësime mbi pamundësinë e ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importit dhe të shitjes së karburanteve për të tregtuar karburante për avionë. Shoqata kërkon ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me (a) mundësinë që duhet t'u jepet edhe kompanive të tjera të marrin tokë në përdorim për të ofruar infrastrukturën e duhur për furnizimin e avionëve me karburant; (b) edhe kompanitë që mund të bien dakord me kompanitë ajrore të kenë mundësi të fusin autobotet në territorin e aeroportit, mbështetur në kontrata që mund të lidhin me kompanitë ajrore si dhe (c) nëse kjo arrihet, kriteret dhe kushtet që do t'u ofrojnë kompanive të tjera të mos jenë diskriminuese, si dhe

koncesionari të mos ketë të drejtë të kërkojë fitim mbi karburantin për efekt të monopolit që ka mbi territorin e aeroportit.

Sipas shoqatës, te gjitha këto masa do të çojnë në mirëfunksionimin e tregut dhe në uljen e çmimit të blerjes së karburanteve nga avionët dhe rrjedhimisht edhe në uljen e çmimit të biletave.

Tregu përkatës i produktit është karburant avionësh JET A-1, klasifikuar me kodin 2710192,1 i cili përdoret për avionë dhe helikopterë. Sipas të dhënave mbi importin e karburantit për vitin 2015 (nga DPD) rezulton se tregu i importit të karburantit për avion, i klasifikuar me kodin 27101921 karburant avionash JET A-1 zë 2% të tregut të karburanteve, ku gjatë këtij viti kanë realizuar importe ndërmarrja AIR BP Albania me 91% të tregut dhe ndërmarrja AFT SHA me 9% të tregut total për karburantin e mjeteve fluturuese, avionë dhe helikopterë.

Nisur nga kriteret e parashikuara në nenin 8 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” ndërmarrja BP zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës për shkak të pjesës së tregut që zotëron (91 % për tregun e furnizimit me karburant të avionëve dhe helikopterëve dhe 100 % të tregut të furnizimit me karburant të avionëve) dhe barrierave të hyrjes në tregun përkatës në kushtet kur aktualisht në Shqipëri funksionon vetëm një aeroport që zotëron ekskluzivitetin për fluturime ndërkombëtare.

Karburanti përbën një zë të rëndësishëm në kostot operationale të shoqërive ajrore duke ndikur në rritjen e kostove të shërbimeve aeroportale të ofruara nga TIA, të cilat janë më të larta krahasuar me tarifat e ofruara në aeroportet e disa vendeve të rajonit për shoqëritë ajrore dhe për pasojë, ndikojnë në rritjen e çmimit të biletave të pasagjerëve dhe mallrave nga/drejt aeroportit ndërkombëtar të Tiranës.

Sa më sipër, në kushtet e ekskluzivitetit të furnizimit me karburant të avionëve në aeroportin ndërkombëtar të Tiranës për shkak të monopolit të furnizimit nga ana e Air BP Albania në aeroportin e vetëm që ofron fluturime ndërkombëtare, kjo shoqëri zotëron pozicion dominues sipas nenit 8 të Ligjit dhe ka të ngjarë të jemi para rastit për kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës sipas nenit 9, pika 2 të Ligjit : “abuzim me pozitën dominuese”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të neneve 2, gërma c, 8, 9, 24, gërma d, nenit 41 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e produktit karburant avionësh JET A-1 mbi ekzistencën ose jo të kufizimeve, shtrembërimeve apo pengimeve të konkurrencës.
 - II. Periudha hetimore është nga data 01.01.2015 deri më 18.05.2016.
 - III. Procedurat hetimore duhet të përfundojnë jo më vonë se 3 muaj nga dalja e këtij vendimi.
 - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 424 , datë 29.06.2016

Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.

Komisioni i Konkurrencës, me përbërje si vijon:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.06.2016, trajtoi çështjen me:

- Objekt:** Shqyrtimi i raportit të monitorimit në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.
- Baza ligjore:** Neni 24 (shkronja d), 26 dhe 42, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës.
- Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të raportit të grupit të punës mbi monitorimin e tregut të prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit,

VËREN SE:

Nisur nga disa artikuj të publikuar në median e shkruar në lidhje me monopolin e grumbullimit të duhanit në zonën e Belshit, Elbasan, në zbatim nenit 28, germa a të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), inspektorët e Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Hetimit të Tregut, më datë 08.06.2016 me anë të urdhrin nr.45, 03/06/2016 monitoruan situatën në këtë zonë gjeografike e cila është edhe më e madhja në prodhimin e duhanit në vend.

Nga pyetësorët u konstatua se “ndërmarrja “MIKA KORÇA” operon me anë të kontratave paraprake me fermerët në kultivimin e duhanit. Me anë të këtyre kontratave firma i siguron ofrimin e farës së kërkuar sipas llojit përkatës të duhanit si edhe një pjesë të asistencës teknike të nevojshme gjatë procesit të mbjelljes, vjeljes dhe stazhionimit të këtij produkti. Çmimet e produktit duhan vendosen sipas kategorive përkatëse të cilësisë dhe ato janë të njëjta në të gjitha pikat e grumbullimit të kësaj firme”

Nga pyetësorët e realizuar me fermerët e zonës së Belshit – Elbasan u konstatua se firma MIKA KORÇA është i vetmi subjekt i cili ofrohet për blerjen e produktit duhan dhe se prej vitesh nuk ekzistojnë blerës të tjerë në këtë treg. Problematika kryesore e konstatuar gjatë procesit të monitorimit lidhet me kostot e larta të prodhimit dhe çmimin që sipas fermerëve nuk arrin të mbulojë kostot dhe të realizojë fitimet e pritura, aktivitet ky që kushtëzohet edhe nga kushtet e pafavorshme të vaditjes së bimës së duhanit dhe kostove të larta të plehrave dhe pesticideve të përdorura gjatë procesit të kultivimit. Nga pyetësorët e realizuar me fermerët në zonën e Belshit rezulton se çmimi mesatar i shitjes së duhanit , pra çmimi mestar që i paguhet fermerëve të zonës nga ana e firmës MIKA KORÇA është 220 lek/kg. Në këtë mesatare çmimi të paguar futen pagesat që bëhen për të gjitha cilësitë sipas kategorive të duhanit që sipas fermerëve në pyetësorë variojnë në çmime 200-500 lek/kg duhan.

Nga të dhënat e marra në terren nëpërmjet procesverbaleve të marra nga ana e fermerëve si edhe pranë ndërmarrjes “MIKA KORÇA” rezulton se gjatë vitit 2016 kjo ndërmarrje nuk ka realizuar pagesat kundrejt fermerëve për produktin duhan të dorëzuar.

Nga të dhënat e marra nga faqja zyrtare e Komisioni Europian, Drejtoria për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për të njëjtën kategori duhani rezulton se çmimi mesatar i paguar nga ndërmarrja MIKA KORÇA SH.A është më i ulët se çmimi mesatar që paguhet në vendet e BE-së ku kultivohet kjo kategori duhani. Kështu nëse i referohemi kursit mesatar të këmbimit 1 Euro = 140 lek, çmimi mesatar i shitjes së kategorisë së duhanit oriental në Greqi dhe Bullgari është rreth 430 lek/kg për vitin 2014, ndërsa në Shqipëri sipas deklaratave të bëra nga përfaqësuesi i firmës MIKA KORÇA rezulton 262 lek/kg. Nga këto të dhëna rezulton se çmimi i grumbullimit nga ana e ndërmarrjes MIKA KORÇA rezulton që të jetë vetëm 60.1% e çmimit mesatar që kjo kategori duhani paguhet në dy vendet e BE-së, Greqi dhe Bullgari.

Ndërmarrja “MIKA KORÇA” SH.A ka pozicion monopolisti në tregun e blerjes së duhanit në vend, pasi është e vetmja ndërmarrje e cila grumbullon me destinacion eksportin e këtij produkti. Vlen të theksojmë se në territorin e RSH-së nuk ekziston asnjë fabrikë e cila mund të përpunojë dhe të realizojë procesin e plotë të ambalazhimit të cigareve me destinacion klientin fundor. Në këto kushte e vetmja mundësi për produktin duhan është eksporti, proces që realizohet vetëm nga ndërmarrja “MIKA KORÇA” SHA

Nga vlerësimi i të dhënave të marra gjatë monitorimit rezulton se kultivimi i duhanit realizohet në sipërfaqe të vogla nga fermerë individualë, duke çuar edhe në kosto të larta për njësi, si edhe pamundësi për ta arritur ekonomi të shkallës në prodhim, cikël i cili do të sillte edhe një raport pozitiv midis çmimit të shitjes së produktit dhe kostove të prodhimit.

Në legjislacionin shqiptar nuk ekzistojnë barrierat ligjore për hyrjen e ndërmarrjeve të reja në tregun e tregtimit apo përpunimit të duhanit. Ekzistenca për një kohë të gjatë e vetëm një ndërmarrje që merret me grumbullimin dhe eksportimin e duhanit të prodhuar në vend tregon për kostot relativisht të larta të prodhimit të këtij produkti dhe mungesën e tregut dhe çmimeve rentabël të blerjes, të cilat do të rrisnin prodhimin dhe sipërfaqet e mbjella me këtë produkt.

Pozicioni i monopsonistit që zotëron në treg ndërmarrja MIKA KORÇA SH.A nuk ka ardhur për shkak të kufizimeve të akteve ligjore apo nënligjore, si edhe ky pozicion nuk është i ndaluar nga Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar). Fuqia që kjo ndërmarrje ka për vendosjen e çmimeve të blerjes dhe mungesa e konkurrencës në blerje, përbëjnë indicio se mund të jemi para abuzimit me pozitën dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 9, nenit 24, shkronja d, dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrotjtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) si dhe nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe nenit 4 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit
- II. Hetimi paraprak të përfshijë periudhën kohore 01/06/2015 – 31/05/2016.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se 2 muaj nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 432-432/1, datë 14.09.2016

Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Ne mbledhjen e tij te datës 14.09.2016, trajtoi çështjen me

Objekt: Shqyrtimi i raportit të hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 2, shkronja c), neni 24, shkronja d) dhe f); neni 26 dhe neni 43(i ndryshuar). Ligji nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport” dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

PROCEDURA

Bazuar në konkluzionet e “Monitorimit të tregut të furnizimit me karburant të avionëve në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit dhe¹ propozimin e marrjes së masave të përkohshme”, Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 2, gërma c, nenit 24 gërma d dhe neni 42, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me anë të Vendimit nr. 417, datë 18.05.2016 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport””, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në këtë treg.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrja AIR BP Albania dhe ndërmarrja AFT SHA që operojnë në tregun e karburantit të mjeteve fluturuese, avionë dhe helikopterë.

ANALIZA E KONKURRENCËS

Tregu përkatës objekt hetimi

Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

— Tregun e produkteve

¹ Korrigjuar sipas Vendimit 432/1, date 14.09.2016.

Bazuar në Vendimin nr. 417, datë 18.05.2016 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e furnizimit të avionëve me karburant në zonën gjeografike të aeroportit ndërkombëtar “Tirana International Aeroport””, tregu përkatës i produktit i referohet tregut të importimit dhe shitjes së produktit JET A-1 karosene, (i klasifikuar me kodin 27101921 “KARBURANT AVIONASH JET A-1”).

Për shkak të kushteve specifike që kërkohen për të operuar në aeroportin “Tirana International Aeroport”, dhe pjesës së tregut të ndërmarrjes AIR BP Albania në këtë zonë gjeografike, si treg përkatës gjeografik vlerësohet tregu brenda territorit të “Tirana International Aeroport”.

STRUKTURA E TREGUT

Nga analiza e tregut të furnizimit me karburant të avionëve JET A -1 karosene në “Tirana International Aeroport”, konstatohet se është vetëm një ndërmarrje AIR BP ALBANIA, e cila është importues dhe shitës me shumicë për këtë produkt. Në tregun gjeografik objekt i këtij hetimi ndërmarrja AIR BP ALBANIA operon në zonë të lirë doganore, pra produkti që ajo tregton JET A-1 karosene është i përjashtuar nga akciza dhe taksa e karbonit, që aplikohet në rastet kur ky produkt tregtohet jashtë zonës së lirë doganore, brenda territorit shqiptar.

Nga analiza e tregut rezulton se në tregun e furnizimit me karburant të mjeteve ajrore në pronësi të qeverisë shqiptare (helikopterë) operon edhe ndërmarrja AFT SHA, një ndërmarrje e cila ka aktivitet në tregun e karburanteve.

KARAKTERISTIKAT E TREGUT

Tregu i karburantit për avionë JET A-1 karosene në aeroportin “Tirana International Aeroport”, ndodhet në kushte monopoli ku një ndërmarrje e vetme, AIR BP ALBANIA ofron karburant për mjetet e transportit ajror. Që prej 31 Dhjetorit 2014, kjo ndërmarrje nuk ka ekskluzivitet në këtë zonë gjeografike.

Nga vlerësimi i bilanceve financiare të ndërmarrjes AIR BP ALBANIA rezulton se gjatë vitit 2015 fitimi pas tatimit janë të konsiderueshme nëse krahasohen me tregun e karburanteve në vend.

“Tirana International Aeroport”, në kontratën konçesionare të lidhur me qeverinë shqiptare është zotëruesi i vetëm i hapësirës ku mund të realizohet aktiviteti i depozitim/aksesit me karburant të avionëve. Kjo ndërmarrje është në kushtet e monopolit për sa i përket tregut të aeroporteve në vend dhe në të tilla kushte transferimi i shërbimeve siç është ai i furnizimit me karburant për avionët sërish vetëm tek një ndërmarrje rrit koston e operimit të kompanive ajrore.

Në kushtet kur, referuar kontratave stacioni i depozitim/aksesit në këtë aeroport është realizuar nga ana e ndërmarrjes AIR BP ALBANIA dhe kjo e fundit zotëron të drejtat mbi këtë impiant, kjo infrastrukturë vlerësohet si një facilitet esencial. Pra, bazuar në terminologjinë e facilitetit esencial, është vetëm kjo infrastrukturë prej të cilës mund të realizohet depozitimi dhe furnizimi me karburant i avionëve.

Dhënia e aksesit për depozitim dhe furnizim nga ana e ndërmarrjes AIR BP ALBANIA, sipas kontratës së vënë në dispozicion të këtij hetimi, kundrejt një pale të interesuar realizohet në kushtet e çmimeve të parregulluara. Pra, ndërmarrja AIR BP ALBANIA zotëron një facilitet esencial për kryerjen e këtij aktiviteti në zonën e “Tirana International Aeroport” dhe në kushtet aktuale konkurrentët potencialë janë të detyruar që të përdorin facilitetin esencial që ajo zotëron kundrejt kushteve të caktuara.

Dhënia e aksesit nga ana e “Tirana International Aeroport”, për mundësinë e furnizimit me karburant të operatorëve të tjerë të cilët plotësojnë kriteret e nevojshme për të operuar në këtë treg dhe kanë kontrata furnizimi me kompanitë ajrore, është mundësia e vetme për rritjen e konkurrencës dhe uljen e çmimeve të karburantit JET A-1 karosene.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe f), nenit 9 dhe 43, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e produktit karburant avionësh JET A-1 mbi ekzistencën ose jo të kufizimeve, shtrembërimeve apo pengimeve të konkurrencës.
 - II. Periudha hetimore është janar 2014 – qershor 2016.
 - III. Procedurat hetimore duhet të përfundojnë jo më vonë se 2 muaj nga dalja e këtij vendimi.
 - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi të gjithë palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 438, datë 05.10.2016

Mbi disa rekomandime dhe mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.10.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e shkeljes së konkurrencës në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe Ligji nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit” dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.

VËREN SE:

PROCEDURA

Nisur nga disa shqetësime të shprehura në median e shkruar në lidhje me grumbullimin e duhanit në zonën e Belshit, Elbasan, në zbatim nenit 28, germa a të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), inspektorët e Drejtorisë Mbikëqyrjes dhe Hetimit të Tregut, më datë 08.06.2016 me anë të urdhrit nr.45, 03/06/2016 monitoruan situatën në këtë zonë gjeografike e cila është zona më e madhe e prodhimit të duhanit në vend.

Një ndër problematikat e evidentuara nga ana e prodhuesve të duhanit në zonën e Belshit, referuar pyetësorit të realizuar nga ana e inspektorëve është mënyra e përcaktimit të kategorisë/cilësisë së duhanit të prodhuar në pikat e grumbullimit. Fermerët deklarojnë se punonjësit e firmës grumbulluese e kategorizojnë duhanin e në kategori më të ulëta se sa është realisht, kategorizim i cili sjell edhe një çmim më të ulët dhe të ardhura më të ulëta. Fermerët kërkojnë që të ketë hapje të tregut të grumbullimit nëpërmjet licensimit të firmave të tjera në grumbullim si edhe të kontrollit të cilësive nga ana e instituteve të duhan cigares në vend duke zbatuar standardet shtetërore shqiptare.

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me vendimin nr. 424, datë 29.06.2016 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit”, vendosi të miratojë hapjen e hetimit paraprak në këtë treg, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën e Hetimit.

Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, me anë të Urdhrit Nr.50, datë 01.07.2016 “Për ngritjen e grupit të punës” për ndjekjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e

prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 240, datë 11.05.2015 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme më datë 06.07.2016, në ambientet e ndërmarrjes “MIKA KORCA SHA”, me adresë: “Ndërmarrja e Grumbullimit, Korce”. Gjatë inspektimit u mbajt procesverbal i datës 06.07.2016 “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”, si dhe Procesverbal i datës 06.07.2016 “Mbi inspektimin në ndërmarrje”, pranë ndërmarrjes “MIKA KORCA” SHA

TREGU PËRKATËS

Për të analizuar sjelljen e ndërmarrjes dhe të efekteve që ajo ka shkaktuar, si treg përkatës të produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit në vend.

Duhani i prodhuar është duhan oriental me emër tregtar “Izmir” i cili është klasifikuar në 4 kategorie të cilat kanë cilësi dhe çmime të ndryshme sipas parashikimeve në kontratën mes fermerëve dhe shoqërisë “Mika Korça” të cilat bashkëpunojnë që nga mbjellja deri në dorëzimin e produktit. Kontratat parashikojnë llojin e duhanit që do të mbillet dhe kushtet e tjera të procesit të mbledhjes, ambalazhimit, tharjes, etj. Në këto kontrata gjatë periudhës hetimore parashikohet që nga ana e fermerëve në Shqipëri të mbillet duhan oriental, për të cilin kjo ndërmarrje ka siguruar edhe teknologjinë e nevojshme për procesin e grumbullim-përpunimit.

Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

KARAKTERISTIKAT E TREGUT PËRKATËS

Ndërmarrja nën hetim MIKA KORCA Sh.a, është në pozicionin e blerëses së vetme (monopsonist) që operon nëpërmjet kontratave paraprake me fermerët për porositjen e mallit. Ndërmarrja e cila lidh kontratën me fermerët për kategorinë përkatëse të duhanit, i siguron këtyre të fundit edhe farën dhe materiale të tjera për procesin e mbjelljes dhe përpunimit të duhanit. Njëkohësisht në kontratën e lidhur midis ndërmarrjes MIKA KORCA Sh.a dhe fermerëve, përcaktohen edhe detyrimet për të blerë duhanin e prodhuar nga ana e fermerit dhe detyrimin për pagesën e këtij prodhimi brenda një afati 60 ditor nga ana e firmës.

Firma porositëse e mallit, MIKA KORCA Sh.a është e detyruar gjithashtu bazuar në kontratën e lidhur me fermerët të demonstrojë paraprakisht monstat sipas cilësive të duhanit në çdo stacion grumbullimi dhe të bëjë vlerësimin e prodhimit të fermerëve mbi bazën e këtyre mostrave. Referuar kontratës së lidhur midis palëve përcaktohen katër cilësi të ndryshme të duhanit, bazuar në karakteristikat përkatëse për duhanin oriental.

Bazuar në të dhënat e mbledhura në të gjitha zonat ku prodhohet duhan në Shqipëri rezulton se ndërmarrja kryesore që kryen aktivitetin e grumbullim-përpunimit në vend është “Mika Korça” Sha. Në tregun e grumbullimit dhe përpunimit të duhanit gjatë vitit 2016 janë konstatuar edhe disa ndërmarrje të tjera me aktivitet të kufizuar krahasuar me MIKA KORÇA SHA Hyrja e operatorëve të rinjë në tregun e grumbullimit dhe përpunimit të duhanit në vend është njoftuar edhe nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Si konkluzion themi se shoqëria “Mika Korça” Sh.a, që operon në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit”, bazuar në nenin 8 të Ligjit 9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), ka pozitë dominuese (monopsoniste) në tregun e grumbullimit dhe eksportit të duhanit.

ANALIZA E ÇMIMEVE DHE KUSHTEVE TË TREGTIMIT

Grumbullimi i duhanit në vend realizohet në periudha të caktuara të vitit nga ana e ndërmarrjes “MIKA KORCA” SH.A, të cilat për periudhën objekt hetimi korrespondojnë me tremujorin e parë të vitit 2016.

Nga analizimi i të dhënave të administruara ku janë përcaktuar të gjitha blerjet e duhanit nga kompania MIKA – KORCA SHA, për periudhën janar – mars 2016, sipas sasisë dhe kategorisë përkatëse, në seicilën zonë, vërehet se cmimet e duhanit variojnë nga (85 – 415) lekë për kg. Edhe në formularët e paravlerësimit të cilësisë së duhanit, të cilat gjenden në cdo pikë grumbullimi, janë përcaktuar cmimet e blerjes së produktit referuar cilësisë, të cilat variojnë nga (100 – 525) lekë. Nga shqyrtimi i çmimeve të blerjes dhe çmimeve të përcaktuara paraprakisht në formularë nuk vërehet ndonjë diferencë e madhe e cila mund të përbëjë ndonjë abuzim të mundshëm të firmës me prodhuesit.

Ndërmarrja MIKA KORCA SHA, përdor Standartin Shtetëror S:SH:STAZH-1421-88, i cili përcakton kërkesat cilësore të duhanit që dorëzohet nga fermerët, ku janë të përcaktuara cilësitë, që nda vjelja e duhanit, ndarja sipas cilësisë e deri te përpunimi, duke e bërë vlerësimin e cmimit nga ndërmarrja MIKA të thjeshtë dhe me pak abuzues.

Nga të dhënat sa më sipër, konkludojmë se çmimet e duhanit të grumbulluar e të shitur në vend ndryshojnë sipas rretheve. Nga sa vërehet edhe cmimet për të njëjtën zonë janë të ndryshueshme. Kështu, çmimi i shitjes së duhanit në Berat rezulton më i lartë se ai në Elbasan. Cmimet e të njëjtës kategori janë të ndryshueshme, brenda të njëjtës zonë, pasi përcaktimi i cmimit bëhet sipas cilësisë së produktit, lagështisë etj, të cilat janë përcaktuar paraprakisht edhe në kontratat e lidhura me fermerët.

VLERËSIMI I KONTRATAVE TË BLERJES DHE EKSPORTIT

Kontratat për prodhimin dhe blerjen e duhanit biologjik të papërpunuar, të lidhura mes fermerëve dhe ndërmarrjes MIKA KORCA SHA, përcaktojnë qartë sasinë të cilën fermeri duhet të prodhojë sipas cilësisë së përcaktuar. Përsa i përket pagesave të duhanit të grumbulluar, në nenin 3, përcaktohet se : “Duhani i grumbulluar duhet të paguhet brenda 60 ditëve nga data e marrë”. Gjithashtu në këtë kontratë janë përcaktuar qartë edhe cmimet sipas gradave (cilësisë) dhe kategorisë së duhanit, të cilat variojnë nga (120 – 700) lekë për kg.

Me anë të shkresës Nr 245/1 Prot datë 21/07.2016 subjekti MIKA KORÇA Sh.a ka vënë në dispozicion kontratën e shitjes (eksportit) të duhanit për vitin 2016. Në këtë kontratë në pikën 1, specifikohen edhe mallrat dhe çmimet përkatëse. Për sa i përket produktit duhan Katerin siç jepet edhe në tabelë çmimi varion nga 1 euro/kg-3.40 euro/Kg.

Nga krahasimi i çmimeve, konstatohet se çmimet mesatare të cilat operojnë dy ndërmarrjet në transaksione me njëra-tjetrën dhe çmimi mesatar që del nga të dhënat e shitjes në treg nga fermerët në europë janë në nivele të përafërta.

Çmimet me të cilat ndërmarrja “MIKA KORCA”, Sh.a blen në tregun shqiptar duhanin nga fermerët janë të ulëta krahasuar me mestaren e çmimit të tregut që shesin fermerët në vendet e BE-së. Kjo situatë sipas përfaqësuesve të ndërmarrjes “MIKA KORCA”, Sh.a vjen për shkak të cilësë së ulët të duhanit.

Përsa i përket çmimeve të eksportit, vërehet se janë të njëjta me ato të përcaktuara edhe në kontratën e eksportimit. Në këtë kontratë, përcaktohet se vlera e mallit do të paguhet me pjesë nga kompania, duke e realizuar 100% të vlerës së mallit jo më vonë se data 30/11/2016. Kjo pikë e kontratës, mund të ketë sjellë edhe vonesat në likuidimin e fermerëve, si dhe vështirësitë financiare të ndërmarrjes “MIKA KORCA” SHA. Nga të dhënat e marra gjatë inspektimeve rezulton se ka nisur procesi i pagesës së fermerëve për duhanin e grumbulluar nga ndërmarrja “MIKA KORCA”, SHA.

Kompania Mika Korca ka informuar Ministrinë e Bujqësisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Duhan Cigareve se, sot e premte 22 Korrik 2016, do të bëjë lajmërimet dhe ditën e hënë 25 Korrik 2016, do të fillojë shlyerjen e detyrimeve ndaj fermerëve.

Ministria e Bujqësisë siguron se kjo situatë nuk do të ndodhë më në të ardhmen, pasi tashmë janë shtuar operatorët grumbullues duke zbehur pozicionin dominant të ndërmarrjes “Mika Korça”, dhe në ndryshimet

ligjore që pritet të miratohen në Parlament, janë të sanksionuara mirë marrëdhëniet e fermerit me grumbullues-përpunuesit.

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të inspektimit të realizuara dhe nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese, që ushtrojnë veprimtari në tregun prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit, rezulton se nuk janë gjetur shenja të abuzimit me pozitën dominuese sipas parashikimeve të nenit 9 të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar).

Struktura monopol e tregut të grumbullimit të duhanit në vend dhe shqetësimet e evidentuara gjatë procedurës hetimore kërkojnë rritjen e konkurrencës në tregun përkatës nëpërmjet hapjes së tregut, si dhe rritjen e fuqisë kundërvepruese të fermerëve nëpërmjet vetë organizimit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe neni 70, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

VENDOSI:

I. T'i rekomandojë Ministrisë së Bujqësisë:

- Marrjen e masave për hapjen e tregut të grumbullimit të duhanit të prodhuar në vend për të nxitur zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë treg.
- Asistencën e specialistëve të Ministrisë së Bujqësisë gjatë procesit të kategorizimit të duhanit sipas cilësisë dhe vendosjes së çmimit përkatës të përcaktuara në kontratat midis palëve gjatë grumbullimit në stacionet e caktuara nga ndërmarrja.
- Monitorimin e realizimit të pagesave nga ana e ndërmarrjes MIKA KORCA Sh.a brenda afateve të parashikuara në kontratën e lidhur nga kjo ndërmarrje me fermerët.

II. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit”, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës në bazë të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi ndërmarrjes nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 440 , datë 10.11.2016

Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë).

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.11.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë)”.

Baza ligjore: Neni 24 (shkronja d); neni 26; neni 43, pika 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe Kodi i Procedurave Administrative i RSH

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë)”, dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

PROCEDURA

Bazuar në konkluzionet e monitorimit të tregut farmaceutik për produktin “Lantus” (insulinë), Komisioni i Konkurrencës në mbështetje të nenit 9, nenit 24, shkronja d, dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe nenit 4 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, me anë të Vendimit nr.415, datë 4.05.2016 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë)” vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë), për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore Shtator 2015 - Prill 2016.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, grupi i punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; Ministria e Shëndetësisë; Zyra përfaqësuese e Sanofi-Aventis Deutschland GMBH-Gjermani, si dhe ka zhvilluar një takim me përfaqësuesin e kësaj zyre.

Në bazë të nenit 36 të Ligjit nr. 9121, dt. 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 172 prot, datë 04.05.2016 “Autorizim Inspektorësh”, grupi i inspektimit gjatë periudhës së hetimit procedoi me kryerjen e inspektimeve pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë). Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i fakteve dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë)”.

NDËRMARRJA NËN HETIM DHE PRODUKTI

Referuar Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr.415, datë 4.05.2016 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë)”, hetimi paraprak përfshin periudhën kohore Shtator 2015 - Prill 2016.

Ndërmarrja e vetme nën hetim e cila operon në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë) (Lantus solostar) është Ndërmarrja “FUFARMA” SH.A, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë nr. 12730, datë 06.11.1995, në formën e një shoqërie aksionare, me kapital 100% privat, me NIPT: J61825037N, me seli në: Rruga “Nikolla Zoraqi”, Ndërtesa 19, hyrja 1, Njësia Bashkiake nr.3, Tiranë; me objekt të aktivitetit: “Tregtim, import, eksport me shumicë dhe pakicë, grumbullim, shpërndarje, përpunim medikamente, material, bimë, lëndë të para, artikuj gjysmë të përpunuar, aparatura, paisje laboratorike farmaceutike, mjekësore, prodhim, ambalazhim, paketim, medikamente dhe material mjekësore”.

Nga të dhënat e grumbulluara gjatë monitorimit, bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), rezultoi se ndërmarrja “FUFARMA SH.A”, me aktivitet import, shitje me shumicë dhe pakicë të medikamenteve dhe pajisjeve mjekësore, zotëron pozitë dominuese në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të produktit mjekësor “Lantus solostar” (Insulinë glarkinë). Për shkak të dyshimeve në vendosjen e kushteve dhe detyrimeve shtesë për të blerë edhe medikamente të tjera mjekësore bashkë me produktin “Lantus solostar” nga ana e ndërmarrjes “FUFARMA SH.A”, sjellje e cila mund të përbëjë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, u procedua me hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë)”.

Produkti mjekësor “Lantus” (Insulinë) është një produkt/bar e regjistruar në RSH (e rimbursueshme) me emërtin tregtar “Lantus Solostar” me princip aktiv “Insuline Glargine solution 100 A10AE04 Nj.N/ml - 3 ml”, në formën “pre-filled pen”, me prodhues/fabrikues “SANOFI – AVENTIS DEUTSCHLAND GMBH – GJERMANI”. Ky bar importohet në vend nga Ndërmarrja “FUFARMA” SH.A, e cila e tregon me shumicë barin të shpërndarësit farmaceutik dhe farmacitë/agjencitë farmaceutike të cilat kane kontratë me fondin e sigurimeve shëndetësore. Tregtuesit farmaceutikë me shumicë e kanë të ndaluar të ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me pakicë të barnave. Shitja me pakicë e barnave kryhet vetëm nga farmacitë dhe agjencitë farmaceutike.

ANALIZA E KONKURRENCËS

Tregu përkatës

Tregu përkatës përfshin produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët dhe operatorët, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

- Tregu përkatës i produktit
- Tregu përkatës gjeografik

Tregu përkatës i produktit

Tregu përkatës i produktit/barit është tregu i shitjes së barit me emër tregtar "Lantus Solostar" dhe emërtim kimik "Insulinë Glarkinë solution 100 Nj.N/ml - 3ml. Ky bar përfshihet në barnat e rimbursueshme dhe jepet/shitet vetëm me recetë me përshkrim mjeku. Ky produkt futet në treg nëpërmjet importuesve, që në këtë rast është vetëm një ndërmarrje FUFARMA. Bari "Lantus Solostar" përdoret nga pacientët diabetikë, të cilët e përdorin në mënyrë periodike, pra është një bar me një treg pothuajse të garantuar, për shkak të domosdoshmërisë së përdorimit.

Tregu gjeografik

Tregu gjeografik përfshin territorin e tregtimit me shumicë dhe pakicë të produktit apo barit me emërtim tregtar "Lantus Solostar" dhe emërtim kimik Insulinë Glarkinë solution 100 Nj.N/ml - 3ml, që është territori i Republikës së Shqipërisë.

Struktura e tregut

Tregu i shitjes së produktit "Lantus Solostar" përbëhet nga tregu i rrjedhës së sipërme që është tregu i importit dhe shitjes me shumicë të këtij produkti nga ndërmarrja FUFARMA, e cila ka kontratë importi të produktit me kompaninë mbajtëse të patentës dhe të prodhimit, që është SANOFI - AVENTIS Groups. Pra, ndërmarrja FUFARMA është i vetmi importues dhe furnizues me shumicë, apo ndërmarrja e vetme në rrjedhën e sipërme të tregut.

Tregu i rrjedhës së poshtme përfshin shitjen e produktit nga farmacitë apo depot sekondare. Bazuar në legjislacionin në fuqi FUFARMA e shpërndan produktin Lantus solostar në rrjetin e farmacive që kanë kontratë rimbursimi me FSDKSH dhe që ua shesin pacientëve vetëm nëpërmjet recetës së rimbursueshme me përshkrim mjeku.

Vlerësimi i Pozitës Dominuese

Ndërmarrja FUFARMA, në bazë të kontratës së shitblerjes me mbajtësin e patentës dhe prodhuesin e vetëm SANOFI – AVENTIS, të produktit “Lantur Solostar” është ndërmarrja e vetme që ka të drejtën e importit dhe të furnizimit me shumicë të produktit. Për pasojë ndërmarrja FUFARMA ka pozicion dominues në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të produktit apo barit me emërtim tregtar "Lantus Solostar" dhe emërtim kimik Insulinë Glarkinë solution 100 Nj.N/ml - 3ml, bazuar në parashikimet e nenit 8 të Ligjit nr. 9121, datë 27.08.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Sjellja e Ndërmarrjes me Pozitë Dominuese

Sjellja e ndërmarrjes me pozitë dominuese FUFARMA u analizua mbështetur në nenin 9 pika ç të Ligjit nr. 9121, datë 27.08.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Gjatë hetimit paraprak për të vërtetuar në se është abuzuar me “vendosjen e kushteve dhe detyrimeve” nga ana e ndërmarrjes me pozitë dominuese në tregun përkatës, u analizuan të gjitha shitjet e kryera nga Ndërmarrja FUFARMA SH.A, në rrjedhën e poshtme të tregut për periudhën 1 Shtator 2015 – 30 Prill 2016.

Të dhënat e siguruar gjatë inspektimeve pranë ndërmarrjes FUFARMA, u morën në cilësinë e të dhënave të vlefshme për procesin e hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (insulinë), kryesisht faturat e shitjeve dhe blerjeve për produktet “Lantus (Ins. Glargine) 100 UI /ml - 3ml” dhe “Enterogermine”.

Analiza e faturave të shitjes dhe blerjes së këtyre dy produkteve është kryer për periudhën 1 Shtator 2015 – 30 Prill 2016, kjo në përputhje me periudhën e hetimit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit. Analiza konsiston në krahasimin e të dhënave të tregtimit të dy produkteve dhe verifikimin nëse ka ndonjë lidhje në faturën e shitjeve midis produktit “Lantus (Ins. Glargine) 100 UI /ml - 3ml” dhe produktit “Enterogermine”.

Analizimi i shitjeve të dy produkteve në sasi dhe vlere “Lantus (Ins. Glargine) 100 UI /ml - 3ml” dhe “Enterogermine”

Analiza është fokusuar në ekzistencën e mundësisë së shitjes në mënyrë të shoqëruar të dy produkteve Lantus Solostar dhe Enterogermine, pasi normat e marzhit të tregtimit të barnave mjekësore janë të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Nga krahasimi i të dhënave të sasive dhe vlerës së mallit të shitur të dy produkteve të sipërcituara vërehet se për periudhën nën hetim sasia totale e produktit “Lantus (Ins. Glargine) 100 UI /ml - 3ml” është 163,658 copë

me një vlerë prej rreth 209,765 mijë lekë, dhe sasia e “Enterogerminës” është 38,803 copë me një vlerë prej 21,750 mijë lekë. Pra, siç vërehet sasia dhe vlera e produktit “Enterogerminë”, për të cilin pretendohet se shitet i lidhur apo me kusht së bashku me Lantus Solostar është përafërsisht 10 % e sasisë dhe vlerës produktit mjekësor “Lantus (Ins. Glargine) 100 UI /ml - 3ml”.

Pra, në se do të vërtetohet pretendimi se ndërmarrja “FUFARMA SH.A” ka aplikuar kushte dhe detyrime gjatë shitjes së barit “Lantus solostar” atëherë sasia e shitur e enterogerminës do të ishte e barabartë ose disa herë më e madhe se sasia e “Lantus solostar”.

Nga analiza e sasive dhe vlerës së produkteve të shitur përkatësisht Lantus Solostar dhe Enterogerminë, nuk vërtetohet shitja me kushte dhe detyrime e produktit “Lantus solostar”.

Analiza sipas datave të shitjes të Lantus solostar dhe Enterogermine, korelacioni ndërmjet tyre

Gjithashtu u shqyrtuan të dhënat lidhur me datat e shitjes nga ndërmarrja FUFARMA SH.A, të dy produkteve “Lantus (Ins. Glargine) 100 UI /ml - 3ml” dhe “Enterogermine” për periudhën në hetim, 1 Shtator 2015 – 30 prill 2016, duke u fokusuar në shitjen e dy produkteve njëkohësisht ose në të njëjtën datë.

Nga analiza e shitjeve sipas datave, nuk arrihet të provohet se ka një lidhje midis shitjes së produktit Lantus Solostar dhe Enterogerminë, që të plotësojë kushtet për një shkelje të mundshme të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2013 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar).

Gjithashtu, nga materialet e administruara gjatë inspektimit, konkretisht nga krahasimi i “urdhër porosisë” dhënë magazinës së FUFARMES nga klientët me ane të telefonit, konkretisht u krahasuan urdhër porositë të cilët kishin produktin Lantus Solostar me shitjet e kryera (së njëjtës datë dhe subjekt). U kontrollua shitja në se ishte shitur së bashku me Lantusin e porositur edhe Enterogermine. Nga kontrolli dyfishtë i shitjeve sipas urdhër porosisë, nuk rezultoi (për rastet e shqyrtuara) që klienti i cili kishte porositur produktin Lantus, të ishte faturuar automatikisht me Enterogerminë.

Për sa më sipër, pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave hetimore në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë), rezulton se nuk ekzistojnë evidenca, të cilat mund të përbëjnë indicie për një abuzim të mundshëm të ndërmarrjes FUFARMA SH.A në lidhje me ekskluzivitetin e produktit “Lantus Solostar” në tregun përkatës, duke mos u ndodhur para një shkeljeje të mundshme të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 43, pika 5, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produktit mjekësor “Lantus” (Insulinë), pasi në përfundim të kësaj procedure hetimore nuk u konstatuan shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg, për periudhën nën hetim.
 - II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi të gjithë palëve të interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 443 , datë 30.11.2016

Për masat dhe detyrime për ndërmarrjet e sigurimit dhe disa rekomandime për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare mbi rivendosjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.11.2016, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Raportin e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme).

Baza ligjore: Nenet 4 (pika1); 24 (shkronja d); 26; 43 (pika 5); 45 pika 2 dhe neni 70 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji);

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të: Raportit të Hetimit të Thelluar në Tregun e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik për përgjegjësinë ndaj Palëve të Treta (MTPL e brendshme), të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës; Relacionit të Sekretares së Përgjithshme; Pretendimeve të ndërmarrjeve nën hetim të paraqitura me shkrim dhe verbalisht në seancat dëgjimore të datave 21, 22 dhe 24 nëntor 2016.

VËREN SE:

PROCEDURA E NDJEKUR

Komisioni i Konkurrencës nisur nga njoftimet në media me nismën e tij filloi procedurën e hetimit paraprak me anë të vendimit Nr. 430, datë 07.09.2016 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme)”, mbi kufizimet, shtrembërimet apo pengimin e konkurrencës në tregun përkatës.

Gjatë periudhës së hetimit paraprak Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka kryer inspektime të befasishme pranë ndërmarrjeve nën hetim sipas parashikimeve të nenit sipas nenit 36 të Ligjit dhe janë administruar informacionet e nevojshme nga ndërmarrjet nën hetim dhe sipas nenit 34 është administruar informacioni i kërkuar nga AMF.

Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, rezultoi se ndërmarrjet nën hetim kanë rritur në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën masë primin e shitjes së produktit MTPL e brendshme, dhe për këtë arsye me anë të Vendimit Nr. 435, datë 21.09.2016 filloi procedura e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme).

PERIUDHA E HETIMIT DHE NDËRMARRJET NËN HETIM

Periudha e hetimit, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin Nr. 435, datë 21.09.2016 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme)”, është janar-shtator 2016.

Ndërmarrje nën hetim janë shoqëritë e sigurimit Sigal Uniq Group Austria Sh.a, Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group Sh.a, Atlantik Sh.a, Intersig Vienna Insurance Group Sh.a, Alb-siguracion, INSIG Sh.a, Eurosig Sh.a dhe Ansig SHA

TREGU PËRKATËS

Tregu përkatës i produktit

Tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta për produktin (MTPL e brendshme).

Tregu përkatës gjeografik

Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofrimi, tregu gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, pra Territori i Republikës së Shqipërisë.

ANALIZA E KONKURRENCËS

Pjesët e tregut

Procedura hetimore është mbështetur mbi dy çështjet kryesore sipas parashikimeve të nenit 4 të Ligjit, ndarja e pjesëve të tregut dhe caktimi i çmimeve të shitjes/blerjes apo çdo kusht tjetër tregtimi.

Pjesët e tregut sipas ndërmarrjeve gjatë kësaj periudhe në disa prej tyre paraqesin ndryshime, pra nuk janë simetrike pasi p.sh, kompania Insig Sh.a ka rritur ndjeshëm pjesën e tregut me rreth 41.61% për periudhën Janar – Gusht 2016 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Edhe ndërmarrja Eurosig Sh.a ka rritur pjesën e tregut me 12.4%. Edhe ndërmarrjet e tjera siç shihet në Tabelën 1, kanë pasur ndryshime në pjesën e tregut për produktin MTPL e brendshme gjatë kësaj periudhe.

Gjithashtu, nga të dhënat e administruara gjatë fazës së hetimit, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme pjesët e tregut të ndërmarrjeve nën hetim, për periudhën 1 – 20 shtator 2016, sipas vlerës së primit të shitjes së produktit MTPL e brendshme. Kjo periudhë i përket hyrjes në fuqi të primeve të reja të shitjes nga ana e ndërmarrjeve.

te dhëna konfidenciale

Pra, rezulton se struktura e tregut objekt hetimi ka qenë dinamike, pasi pjesët e tregut për secilën ndërmarrje nën hetim ka ndryshuar gjatë periudhës hetimore dhe nuk evidentohen sjellje të qëllimshme të ndërmarrjeve që të shkaktojnë ngurtësimin e tregut.

Sjellja ndaj çmimit

Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar inspektime për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një marrëveshje të ndaluar midis konkurrentëve ose të një praktike të bashkërenduar mes kompanive, lidhur me caktimin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të primeve të shitjes, ndarjes së tregut apo kufizimit ose kontrollit të tregut. Gjatë inspektimeve janë administruar materiale të nevojshme për hetimin për të bërë të mundur vlerësimin e kufizimeve të konkurrencës në treg.

Nga inspektimi i realizuar në shoqërinë e brokerimit “Star Broker” Sh.a, u gjenden shkresat e të gjitha shoqërive të sigurimit, të datës 23.8.2016 (me përjashtim të ANSIG që e ka dërguar shkresën një ditë më vonë) të cilat njoftojnë shoqërinë Star Broker, e cila bën administrimin e sistemit të shitjes së policave të MTPL së brendshme, se shoqëritë do të aplikojnë çmime më të larta duke filluar prej datës 24 gusht 2016.

Nga evidencat e administruara, të gjitha shoqëritë e sigurimit kanë caktuar datën 24 gusht 2016, për aplikimin e çmimeve të ndryshuara për produktin MTPL e brendshme. Në zbatim të kërkesave të mësipërme shoqëria “Star Broker” Sh.a ka realizuar ndryshimin e tarifave për kategoritë MTPL në sistemin e shitjes në të njëjtën

kohe në datë 24.08.2016 ora 00:00. Çmimet e njoftuara për Star Broker, me tabelat bashkëlidhur shkresave janë si më poshtë:

te dhëna konfidenciale

Referuar evidencave të shitjes së produktit MTPL e brendshme të marra nga “Star Broker” sh.a si dhe nga të gjitha shoqëritë e sigurimit gjatë periudhës së inspektimeve, rezulton se më datë 24 gusht 2016 ora 00:00, të gjitha shoqëritë e sigurimit kanë rritur çmimin e shitjes së produktit MTPL e brendshme në masën prej 16.7%, dhe me një çmim i cili ndryshon në mënyrë simetrike me diferencë prej 12 lekë nga njëra ndërmarrje tek tjetra, sipas renditjes së ndërmarrjeve referuar pjesëve të tregut, ku ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu ka çmimin më të ulët deri tek ndërmarrja më e vogël me çmimin më të lartë. Diferenca nga çmimi më i ulët tek çmimi më i lartë është 84 lekë, për të gjitha kategoritë e MTPL.

Nga ana e Grupit të Punës kjo sjellje e shoqërive të sigurimit përbën një evidencë indirekte të një praktike të bashkërenduar e cila në kuptim të nenit 3, pika 4 të Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar) konsiderohet marrëveshje, e cila në bazë të nenit 4, pika 1 germa a është e ndaluar.

Pretendimet e palëve

Në zbatim të nenit 39 të Ligjit Komisioni i Konkurrencës përpara marrjes së vendimin përfundimtar dëgjoi palët në seancat dëgjimore të datave 21, 22 dhe 24 nëntor 2016 ku shoqëritë e sigurimit paraqitën prapësimet e tyre referuar raportit dhe marrjen e angazhimeve për rivendosjen e tregut në kushtet e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Në pretendimet e tyre ndërmarrjet pretendojnë se tregu është i rregulluar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare i cili ka përgjegjësinë ligjore për mbarëvajtjen dhe rregullimin e tregut si dhe të zbatimit në kohë të sistemit Bonus- Malus dhe se sipas raportit hetimor konstatohet se "nuk janë evidentuar evidenca direkte të një marrëveshje të ndaluar në formën të shkruar për fiksimin e çmimit apo ndarjen e tregut ...", pra përjashtohet mundësia e evidentimit të një marrëveshje të ndaluar mes shoqërive të sigurimeve”.

Ndërmarrjet nën hetim pretendojnë se çmimet midis tyre janë të ndryshueshme dhe nuk janë të njëjta dhe se nuk jemi para shkeljeve të pretenduara në nenin 4 të Ligjit sa i përket ndarjeve të tregut se nuk jemi në kushtet e ndarjes së tregut pasi ka ndryshme mes pjesëve të tregut të produktit përkatës nga një muaj në tjetrin dhe nga një shoqëri sigurimi në tjetrën.

Ndërmarrjet nën hetim pretendojnë se rritja e primeve të sigurimit MTPL e brendshme për të gjitha klasat ka ardhur për shkak të kostove të rritura që vijnë kryesisht nga taksa rritur nga 3 në 10 % dhe rritja e dëmeve të paguara mesatarisht me 30 %.

Shoqëritë e mësipërme, bazuar dhe në interpretim të nenin 45 të Ligjit nr. 9121, date 28.03.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar) dhe Rregullores "Mbi procedurat e Angazhimeve", kanë paraqitur angazhimet e tyre sipas të cilëve, janë detyruese, krijojnë siguri ligjore, rivendosin konkurrencën në treg dhe sigurojnë ruajtjen efektive të saj në mënyrë të vazhdueshme, si më poshtë:

Lidhjen e me shume se një kontratave të shërbimit me shoqëritë e brokerimit dhe shoqëritë e agjenteve/agjente si persona fizike;

Rritjen e shërbimit ndaj të siguruarve sa i përket dëmeve dhe ofrimit të primeve të ndryshme të shitjes sipas kategorive të klientëve;

Bashkëveprimin me AMF-ne si rregullator tregu për diferencimin e primeve mbi bazën e riskut të të siguruarit. Shoqëritë pretendojnë se nga ana e tyre janë ndërmarrë të gjitha veprimet dhe angazhimet e kërkuara për të zbatuar sistemin e diferencuar BONUS/MALUS por kjo nuk është bërë e mundur për shkak të vakumit ligjor dhe nënligjor pasi siç jeni në dijeni është në procedurë rishikimi legjislativ "Mbi sigurimin e detyrueshëm motorik të mjeteve të transportit".

RREGULLIMI I TREGUT

Tregu i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga Ligji Nr.52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, i cili rregullon krijimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit, me qëllim që tregu i sigurimeve të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të konsumatorit.

Kushtet dhe tarifat e sigurimit të detyrueshëm, përcaktohen në nenin 10, të Ligjit Nr. 10067, datë 12.02.2009, “Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 10455, datë 21.7.2011 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit”. Sipas këtij neni, AMF-ja miraton rregullat për përcaktimin e kushteve të përgjithshme të sigurimit të detyrueshëm dhe nivelin e rezervave teknike dhe provigjoneve.

Gjithashtu, shoqëria e sigurimit përcakton vetë tarifat e primit të sigurimit, sipas kushteve të tregut, dhe fillon t’i zbatojë ato, pasi njofton zyrtarisht AMF-në. Pavarësisht tarifave të liberalizuara të primit të sigurimit të detyrueshëm, shoqëritë e sigurimit krijojnë rezervat teknike dhe provigjonet, jo më pak se niveli i rezervave teknike dhe provigjoneve, të përcaktuara nga AMF-ja.

Kur AMF-ja vëren se kushtet e përgjithshme të sigurimit nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore, miraton vendime, të cilat trajtojnë mënyrën, sipas së cilës shoqëria e sigurimit duhet t’i përputhë ato.

Në të gjitha ndërhyrjet e Autoritetit të Konkurrencës në tregun objekt hetimi ka adresuar rekomandimet përkatëse për rregullatorin e tregut duke synuar garantimin e një tregu sa më konkurrues.

NDËRHYRJET E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS NË TREGUN PÛRKATËS

Gjatë 10 viteve të fundit Komisioni i Konkurrencës ka përdorur të gjitha instrumentet në zbatim të legjislacionit të konkurrencës për rivendosjen e konkurrencës efektive në treg: vendosjen e gjobave të rënda sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 74 të Ligjit, si dhe rekomandimet për entin rregullator të tregut përkatës për krijimin dhe nxitjen e konkurrencës në treg. Më konkretisht:

Masat me gjobë ndaj shoqërive të sigurimit

Me vendimin nr.50 Datë 21.03.2007 "Për Vendosje gjobe ndaj shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm, për produktin Policë Kufitare" Komisioni i Konkurrencës vendosi: ndalimin e akt-marrëveshjes së datës 05.04.2005 "Mbi themelimin e Pool-it të Sigurimit Kufitar të Përgjegjësive ndaj palëve të treta të mbajtësit të mjetit motorrik", dhe vendosjen e gjobës në masën 2% të xhiros të vitit 2005, ndaj shoqërive pjesëmarrëse në marrëveshjen e datës 05.04.2005 dhe konkretisht: Shoqërisë Sigma Sh.a, Shoqërisë Sigal Sh.a, Shoqërisë Atlantik Sh.a, Shoqërisë Intersig Sh.a, Shoqërisë Inter Albania Sh.a, Shoqërisë Albsig Sh.a, Shoqërisë Insig Sh.a, Shoqërisë Euros sig Sh.a,

Me vendimin Nr. 246 , datë 09.10.2012 "Mbyllja e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL) dhe vendosje gjobe për kufizim të konkurrencës ndaj ndërmarrjeve "Sigal Uniq Group Austria Sha (Sigal)" në shumën prej 22.496.193 Lekë, "Sigma Vienna Insurance Group Sha (Sigma)" në shumën prej 14.050.348 Lekë, "Atlantik Sha" në shumën prej 11.141.914 Lekë, "Intersig Vienna Insurance Group Sha (Intersig)" në shumën prej 12.213.514 Lekë, "Inter Albanian Sha" në shumën prej 7.271.207 Lekë, "Alb - Siguracion Sha (Albsig)" në shumën prej 9,362,548 Lekë, "Instituti i Sigurimeve Sha (Insig)" në shumën prej 3,257,583 Lekë dhe "Euros sig Sha" në shumën prej 9,151,357 Lekë.

Në të gjitha rastet, Gjykata në vendimet përfundimtare ka vendosur shfuqizimin e vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës duke e zhvlerësuar këtë instrument.

Rekomandimet për autoritetin të mbikëqyrjes financiare

Vendimi nr. 49 datë 21.03.2007 "Për disa Rekomandime të ndryshimeve në disa akte normative në fushën e sigurimeve", Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Ministrit të Financave shfuqizimin e plotë të Urdhrit

Nr. 14, datë 6.5.2005 të Ministrit të Financave "Mbi shitjen dhe administrimin e policës kufitare nga BSHS" dhe urdhrave të tjerë në zbatim të tij, që lidhen me shpërndarjen e të ardhurave nga shitja e policës kufitare.

Vendimin nr.247, datë 09.10.2012 "Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL)", Komisioni i Konkurrencës ka kërkuar "implementimin në një kohë sa më të afërt të sistemit Bonus-Malus, i cili do të krijonte mundësi për një diversitet dhe aplikim të primeve të ndryshme për çdo policë sigurimi të detyrueshëm motorik, duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën midis kompanive që operojnë në këtë treg".

Vendimin nr. 254, datë 06.12.2012 "Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta" Komisioni i Konkurrencës ka rekomanduar "revokimin e Vendimit Nr. 151, datë 29.10.2012 të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, "Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësive të pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti".

Vendimin nr.269, datë 18.02.2013 "Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e policës së sigurimit kufitar" Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe të gjitha ndërmarrjeve të sigurimit: rishikimin, brenda afatit 1 muor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të kushteve të veçanta të Policës së Sigurimit Kufitar në mënyrë që shoqëritë e sigurimeve ta tregtojnë produktin "Policë kufitare" me emrin e secilës prej tyre, në mënyrë individuale.

Vendimin nr.325, datë, 30/07/2014 "Për disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për nxitjen e konkurrencës në tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta" Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar AMF-së marrjen e masave rregullatore për vendosjen e tregut të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta në kushtet e funksionimit eficient duke siguruar konkurrencën mes shoqërive të sigurimit nëpërmjet marrjes së masave si vijon:

Të bëjë të zbatueshëm parashikimin ligjor për trajtimin e dëmit nga siguruari i drejtëpërdrejtë sipas parashikimeve të ligjit nr.10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit";

Të miratojë tabela të individualizuara të primit të riskut mbështetur në analizën e riskut sipas portofolit të shoqërive të sigurimit, karakteristikave të produkteve dhe strukturës së sigurimeve për çdo shoqëri sigurimi;

Të informojë Autoritetin e Konkurrencës në mënyrë periodike mbi vënien në funksionim të projektit Bonus-Malus deri në realizimin e plotë të projektit për individualizimin e primit të riskut sipas historikut të dëmeve të të siguruarit, 9 moshës së drejtuesit të automjeteve, vendbanimi dhe fuqia motorike e automjetit etj.

Të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës në kuadër të projektit të asistencës me Bankën Botërore për rishikimin e kuadrit rregullator për produktet e sigurimit MTPL me theks të veçantë mbi teknikat e përllogaritjes së provigjoneve të dëmeve nga produktet e sigurimit MTPL.

Të publikojë raportin dhe të dhënat financiare të shoqërive të sigurimit për të mundësuar konkurrencën e ndershme në tregun e sigurimeve mbështetur në Udhëzimin "Mbi rregullat e publikimit të të dhënave të shoqërive të sigurimit, shoqërive të brokerimit në kuadrin e transparencës ndaj publikut dhe mbrojtjen konsumatorë", me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 11, datë 08.02.2007, dhe të sigurojë që "Shoqëria e sigurimit publikon raportin vjetor i cili përfshin raportin vjetor financiar dhe të dhëna të tjera të përfshira në këtë Udhëzim. Ky raport publikohet, jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i vitit kalendarik".

Historiku i vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës në tregun përkatës si ndaj sjelljes së firmave ashtu edhe me rekomandimet e shumta për AMF-në tregon mungesën e vullnetit të rregullatorit dhe ndërmarrjeve

nën hetim për moszbatimin e Politikës dhe Ligjit të Konkurrencës duke bërë inefiçente ndërhyrjet e Komisionit të Konkurrencës në tregun e MTPL-së së brendshme.

Si konkluzion Komisioni i Konkurrencës vlerëson se në tregjet e rregulluara, entet rregullatorë dhe në rastin konkret AMF që gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike të subjekteve në mbikëqyrje janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e ligjit 9121 date 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) dhe te sigurojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në tregjet nën rregullim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 45 pika 2 dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar),

VENDOSI:

- I. Angazhimet e ndërmarrjeve objekt hetimi bëhen të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrime, si vijon:
 - Lidhjen e më shumë se një kontratave të shërbimit me shoqëritë e broke rimit dhe shoqëritë e agjenteve/agjente si persona fizike;
 - Rritjen e shërbimit ndaj të siguruarve sa i përket dëmeve dhe ofrimit të primeve të ndryshme të shitjes sipas kategorive të klientëve;
 - Marrjen e masave që në sistemet e tyre shoqëritë të mundësojnë sistemin e diferencuar BONUS/MALUS;
 - II. T’i rekomandojë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të detyrojë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për marrjen e masave për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme) nëpërmjet nxjerrjeve të akteve nënligjore lidhur me:
 - III. Zbatimin e plotë të sistemit Bonus/Malus për Sigurimin e Detyrueshëm Motorik ndaj Palëve të Treta duke diferencuar primet e sigurimit të të siguruarve sipas historikut të dëmeve;
 - IV. Dëshmipërblimin e drejtpërdrejtë për palët e siguruar që do të rriste ndjeshëm konkurrencën mes shoqërive të sigurimeve;
 - V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe palëve në hetim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIME ME OBJEKT - MARRËVESHJE TË NDALUARA

VENDIM

Nr. 400, datë 10/02/2016

Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.02.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Monitorimin e tregut të përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi monitorimin e tregut të përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij”.

VËREN SE:

Nga monitorimi i realizuar nga inspektorët e Drejtorisë së Mbikqyrjes dhe Hetimit të Tregut në disa pika të tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, rezultoi se:

Produkti qumësht i ambalazhuar me shishe plastike, tregtohet nga ndërmarrjet me markën:

- Qumësht “Lufra” me sasi 1.4 litra me çmim 130 lekë;
- Qumësht “Erzeni” me sasi 1.4 litra me çmim 130 lekë.

Nga informacionet e mbledhura në treg, bëhet me dije se ambalazhimi i këtij produkti ka qenë me shishe plastike 1.5 litra, por tashmë nga të gjitha ndërmarrjet që operojnë në këtë treg, ky produkt ka ndryshuar paketimin duke u tregtuar me sasinë prej 1.4 litra. Gjithashtu dy ndërmarrjet e mësipërme aplikojnë edhe të njëjtin çmim shitje.

Produkti kos i ambalazhuar në gota, tregtohet nga këto dy ndërmarrje nën markën:

- Kos me gotë “Lufra” me sasi 380 gr me çmim 50 lekë
- Kos me gotë “Erzeni” me sasi 380 gr me çmim 50 lekë;

Nga informacionet e mbledhura në treg, bëhet me dije se ambalazhimi i këtij produkti ka qenë me gota me sasi 400 gr, por tashmë këto ndërmarrje kanë ulur këtë sasi, duke e tregtuar me gota 380 gr, duke e mbajtur të njëjtë çmimin pas uljes së sasisë.

Kos natyral i ambalazhuar në shishe plastike, tregtohet nga këto dy ndërmarrje nën markën :

- Kos “Lufra” me sasi 0.95 litra me çmim 110 lekë;
- Kos “Erzeni” me sasi 0.95 litra me çmim 110 lekë.

Nga informacionet e mbledhura në treg, bëhet me dije se ambalazhimi i këtij produkti ka qenë me shishe plastike 1 litër, por tashmë nga këto dy ndërmarrje ky produkt ka ndryshuar paketimin duke u tregtuar me sasinë prej 0.95 litra dhe me çmim të njëjtë për dy ndërmarrjet e mësipërme.

Në përfundim të këtij monitorimi në tregun e përpunimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, nga indiciet e mbledhura egzistojnë dyshime të arsyeshme se në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, mund të ketë marrëveshje të ndaluar ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg, bazuar në nenin 4, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, pika 1, nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës;
- II. Periudha e hetimit do të jetë 01 Janar 2014 deri më 31 Janar 2016.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe në aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 11.03.2016. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 407, datë 8.03.2016

Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 8.03.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d); neni 26; nenin 43, pika 5. Ligji nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

PROCEDURA

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, datë 26.10.2015, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. 417 prot, bën me dije se: Në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga DPT me objekt “Ruajtje objektsh ku është akomoduar administrata tatimore” e ndarë në 13 lote, është konstatuar se gjatë hapjes së ofertave të operatorëve ekonomikë dhe veçanërisht në lotin e Tiranës 6 (gjashtë) prej operatorëve ekonomikë ofertues, kanë paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë të barabartë.

Nga shqyrtimi i mëtejshëm i ofertave të paraqitura nga operatorët ofertues në procedurën e prokurimit të realizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me objekt: “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, vërehet se ofertat e paraqitura nga operatorët ofertues për të 13 lotet janë shumë afër njëra-tjetrës dhe një pjesë e tyre paraqesin të njëjtën vlerë.

Ndodhur përpara faktit se në procedurën e prokurimit publik me objekt “Ruajtja e objekteve ku është akomoduar administrata tatimore për vitin 2015” mund të ketë kufizime të mundshme të konkurrencës, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me anë të Vendimit r. 380, datë 02.11.2015, vendosi të miratojë hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacione nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit, si dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 179, datë 02.11.2015 u realizuan inspektimet e nevojshme në të gjitha ndërmarrjet objekt hetimi. Gjatë inspektimeve janë mbajtur

procesverbalet përkatëse “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit”, si dhe “Mbi inspektimin në ndërmarrje”.

NDËRMARRJET NËN HETIM

Referuar Vendimit nr. 380, datë 02.11.2015 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi janë:

Ndërmarrjet: “SSX”, me NIPT: J61817070O; “Nazeri - 2000”, me NIPT K31422029Q; “Dea Security”, me NIPT K51521007J; “A 2000”, me NIPT K02022005D; “Eurogjici - Security”, me NIPT K31929010K; “Oktapus”, me NIPT K31515076S; “Mandi-2K”, me NIPT K31707026S; “Toni Security”, me NIPT K94010201F; “Ales”, me NIPT K72117028D; “Aulona – Pol - 1”, me NIPT K26307202E; “Çullhaj”, me NIPT K31514015J; “Breçani- R.O.S”, me NIPT K52116005E; “Jori”, me NIPT K31616001G; “Arbana Sh.A” me Nipt: K21310002U; “Trezhnjeva SHPK” me Nipt: K19303605O; “N.S.S (Ndreu security services) SHPK” me Nipt: J68319509H; “Lura Security SHPK” me Nipt: K82111002E; “Global security” SHPK, me Nipt K72217015V; “Myrto Security” SHPK, me Nipt K23323401N; “Security Korca” SHPK, me Nipt L43907002H; “Vaso Security” SHPK me Nipt K23711001K; “Gora SHPK”, me Nipt K54116604N; “SB Security” SHPK, me Nipt NIPT K64105813Q; “Balili-Ko” SHPK, me Nipt K36603503U; “Gjoka+A” SHPK, me Nipt K31825504T; “Anakonda SHPK” me Nipt K2900958I; “Grup – 4” SHPK me Nipt K63521603S; “Taulanti SHPK”, me Nipt K83308601C; “Ejxhes Security SHPK”, me Nipt K63008403S; “Polsaiz SHPK”, me Nipt K43313402T; “Shtiqni SHPK”, me Nipt K37508217T; “Safe SHPK”, me Nipt K41424040P; “Kevenjo SHPK”, me Nipt K363087461; “Grand Security SHPK”, me Nipt K51705027S; “Snajper Security SHPK”, me Nipt K77217701L; “RES-03 SHPK”, me Nipt K26513468E; “2LX” SHPK, me Nipt K775235024; “Alba SHPK”, me Nipt K37507793; “Bahiti – G SHPK”, me Nipt K834102010.

ANALIZA E KONKURRENCËS

Tregu përkatës i produktit

Tregu përkatës i produktit përcaktohet si: “Një treg përkatës i produktit përfshin të gjitha ato mallra dhe/ose shërbime të cilat vlerësohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga konsumatori, për arsye të karakteristikave të prodhimit, çmimeve dhe qëllimit të përdorimit të tyre”.

Operatorët ekonomikë që të jenë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duhet të përmbushin të gjitha ato kriterë që vlerësohen të nevojshme nga autoriteti kontraktor dhe që kanë të bëjnë me: kualifikimin profesional, aftësitë teknike, gjëndjen ekonomike e financiare, kapacitetet ligjore, si dhe standardet e kërkuara të cilësisë. Këto kriterë duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Këto kërkesa për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik .

Ofertuesit pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, me objekt: “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit/kualifikimit për t’u kualifikuar si oferta të vlefshme.

Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, treg përkatës produkti është tregu i prokurimit të shërbimit privat të sigurisë fizike.

Tregu gjeografik

Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Për vlerësimin e impaktit që

shkakton ofertimi, bazuar dhe në vendimin për hapjen e hetimit paraprak, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i prokurimit të shërbimit privat të sigurisë fizike në Republikën e Shqipërisë.

Sjellja e ndërmarrjeve në treg

Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, në tregun e prokurimit publik të shërbimit privat të sigurisë fizike, është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”.

Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve u realizuan inspektimet të menjëhershme (down rides) në të gjitha ndërmarrjet objekt hetimi si dhe u shqyrtuan të dhënat e administruara gjatë fazës së inspektimeve në ndërmarrje, dokumentacioni i paraqitur nga ndërmarrjet në procedurën e prokurimit, si dhe dokumentacioni i administruar nga Autoriteti Kontraktor, meqenëse gjatë inspektimeve të befasishme të realizuara në ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi nuk u gjet asnjë evidencë direkte që të vërtetonte bashkëpunimin në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me procedurën e prokurimit të zhvilluar nga “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, më datë 26.02.2015, me objekt: “Ruajtje objektsh të godinave ku është akomoduar administrata tatimore për vitin 2015”, me fond limit 73 839 987 (shtatëdhjetë e tre milion e tetëqind tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, të ndarë në 13 lote, rezulton si vijon: Për Lotin e Tiranës, 6 prej operatorëve ofertues kanë paraqitur oferta me vlera të njëjta. Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në plotësimin e ofertave është vlerësuar nëse ka shenja dhe modele çmimi që tregojnë për marrëveshje në oferta, apo nëse ky çmim i ofertës i paraqitur vjen si pasojë e ndonjë marrëveshje të fshehtë ndërmjet operatorëve pjesëmarrës.

Për këtë arsye, është bërë analizimi i ofertave të paraqitura nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në procedurën e Lotit të Tiranës. Nga analiza e ofertave të paraqitura në këtë procedurë nga ndërmarrjet, rezulton se nuk ka shenja të ngjashme në plotësimin e dokumenteve.

Sa më sipër konstatojmë se kemi 6 ndërmarrje të cilat kanë të njëjtën ofertë identike. Zgjedhja e ndërmarrjes fituese në këto kushte kur kemi oferta identike është realizuar në bazë të shortit me gogla. Referuar tab.1 sa më sipër konstatojmë se oferta fituese është sa 86.91% e fondit limit, duke dhënë një indicio tjetër të analizës që të çon drejt mungesës së një marrëveshje në këtë tender, pasi largësia nga vlera e fondit limit tregon se nuk jemi para evidencave të një sjelljeje të ndaluar.

Ofertat identike në këto kushte duket se kanë ardhur për shkak të rekomandimit të dhënë nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) më datë 01.04.2015, mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për marrjen e shërbimit privat të ruajtjes fizike, i cili ka çuar ndërmarrjet drejt çmimit minimal të vlefshëm, i cili është identik me vlerën e përcaktuar nga APP dhe KPP. Gjithashtu për sa më sipër nuk vërtetohet se ndërmarrjet të kenë aplikuar skemat e marrëveshjeve në oferta të përcaktuara sipas metodologjisë së përdorur (OECD “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”).

Ky rekomandim është krijuar në lidhje me procedurat e prokurimit për marrjen e shërbimit privat të ruajtjes fizike me qëllim shmangien sa më shumë të jetë e mundur të vonesave në realizimin e kësaj procedure, reduktimin e numrit të ankesave për këto procedura, shmangien e gabimeve në përllogaritje të fondit limit dhe / ose të kërkesave të tjera, të cilat çojnë në anulimin e procedurës si dhe shmangien e situatave “emergjente” në të cilat autoritetet kontraktore janë të pambuluara me këtë lloj shërbimi dhe si të tilla çojnë në përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje të njoftimit paraprak. Në këtë rekomandim janë të përcaktuar të gjitha pikat e përllogaritjes së një çmimi oferte, për procedurat e prokurimit publik në shërbimin privat të sigurisë fizike.

Nga të dhënat e paraqitura gjatë kësaj procedure konstatohet se:

- Për lotin Berat, oferta fituese është rreth 90% e fondit limit;
- Për lotin Durrës, oferta fituese është rreth 97% e fondit limit;
- Për lotin Dibër, oferta fituese është rreth 93% e fondit limit;
- Për lotin Elbasan, oferta fituese është rreth 90% e fondit limit;
- Për lotin Fier, oferta fituese është rreth 90% e fondit limit;
- Për lotin Gjirokastrë, oferta fituese është rreth 90% e fondit limit;
- Për lotin Korçë, nuk është shpallur fituesi i procedurës së prokurimit pasi: të gjithë operatorët ekonomikë janë skualifikuar për arsye se: kanë paraqitur listpagesat e kërkuara në DST në kundërshtim me Ligjin 75/2014, neni 18, pika g. Në përfundim të afatit ligjor të ankimit nuk rezulton asnjë operator i kualifikuar dhe për pasojë Autoriteti Kontraktor ka vendosur anulimin e kësaj procedure prokurimi;
- Për lotin Kukës, oferta fituese është rreth 90% e fondit limit;
- Për lotin Lezhë, oferta fituese është rreth 90% e fondit limit;
- Për lotin Sarandë, oferta fituese është rreth 90% e fondit limit;
- Për lotin Shkodër, nuk është shpallur fituesi i procedurës së prokurimit pasi: të gjithë operatorët ekonomikë janë skualifikuar për arsye se: kanë paraqitur listpagesat e kërkuara në DST në kundërshtim me Ligjin 75/2014, neni 18, pika g. Në përfundim të afatit ligjor të ankimit nuk rezulton asnjë operator i kualifikuar dhe për pasojë Autoriteti Kontraktor ka vendosur anulimin e kësaj procedure prokurimi;
- Për Lotin Vlorë, oferta fituese është rreth 86% e fondit limit

Nga procedura hetimore konstatohet se në lotet e paraqitura sa më sipër, autoriteti kontraktor ka skualifikuar të gjithë operatorët ekonomikë për arsye se: nuk kanë respektuar kërkesat e Ligjit 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike". Vetëm operatorët të cilët janë ankimuar sipas shkallëve të ankimit dhe kanë mundur të kualifikohen, janë shpallur fitues.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, nuk u konstatuan shenja të bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave si dhe nuk u vërtetua ekzistenca e skemave të marrëveshjeve në oferta. Gjithashtu edhe gjatë inspektimeve nuk është gjetur asnjë evidencë bashkëpunimi midis ndërmarrjeve të mësipërme lidhur me këtë procedurë prokurimi.

Autoriteti i Konkurrencës realizoi një takim me Agjensinë e Prokurimit Publik, lidhur me problematikat e dala gjatë "Hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt "Ruajtje objektesh për vitin 2015", ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve". Nga ana e përfaqësueses së APP u sqarua se: Rekomandimi i përbashkët i APP dhe KPP ka si qëllim ndër të tjera edhe shmangien e marrëveshjeve midis SHPSF-ve, si dhe ankesave të shumta në këtë treg prokurimi. Ky shërbim (SHPSF) ka veçanti respektimin e dispozitave ligjore mbi pagën. Duke parë problematikat e këtij prokurimi si: llogaritja gabim nga ana e SHPSF-ve të shtesave për turnet, anomalia e madhe midis FL (fondit limit) dhe ofertës për shkak të mosrespektimit të pagesave për sigurimet shoqërore etj., u pa e nevojshme nxjerrja e këtij udhëzimi të përbashkët, i cili kanalizoi llogaritjen e çmimit për vend roje, duke konkurruar mbi marzhe fitimi, si dhe oferta të mos kaloj dy shifra pas presjes dhjetore.

Si përfundim, gjatë vlerësimit të gjithë dokumentacionit të dërguar nga Autoritetet Kontraktore, bazuar edhe në metodologjinë që aplikon OECD për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike (OECD - Guidelines for fighting bid rigging in public procurement), nuk ka shenja të bashkëpunimit të ndërmarrjeve

në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik të realizuara nga DPT si dhe nuk u vërtetua ekzistenca e skemave të marrëveshjeve të ndaluara në oferta. Gjithashtu nga hetimi rezulton se në këto procedura prokurimi të realizuara vërehet një pjesëmarrje e gjerë e të gjitha ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg.

Zgjedhja e ndërmarrjes fituese në kushtet kur kemi oferta identike është realizuar në bazë të shortit, pasi ndërmarrjet kanë paraqitur oferta me vlerë të njëjtë duke dhënë një indicio tjetër të analizës që të çon drejt mungesës së një marrëveshje në këtë tender, pasi largësia nga vlera e fondit limit tregon se nuk jemi para evidencave të një sjelljeje të ndaluar. Ofertat identike në këto kushte janë si pasojë e sjelljes së ndërmarrjeve të orientuara drejt çmimit minimal të përllogaritur sipas akteve ligjore dhe nënligjore dhe së fundmi nga rekomandimi i përbashkët i APP dhe KPP. Për sa më sipër nuk vërtetohet se ndërmarrjet të kenë aplikuar skemat e marrëveshjeve në oferta të përcaktuara sipas metodologjisë së përdorur (OECD “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”).

Si konkluzion, pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të inspektimit të realizuara në ndërmarrjet nën hetim dhe vlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” rezulton se nuk u konstatuan shenja të bashkëpunimit të ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik në këtë treg të parashikuara në nenin 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar)

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 43, pika 5, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”, pasi në përfundim të kësaj procedure hetimore nuk u konstatuan shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg për periudhën nën hetim.
- T’i rekomandojë Agjensisë së Prokurimit Publik që në bashkëpunim me Autoritetet Kontraktore, në rastin e shërbimit të ruatjes dhe sigurisë fizike :
- Gjatë llogaritjes së fondit limit të marrin parasysh mbulimin e të gjithë kostove operative dhe një normë fitimi të shoqërive të sigurisë fizike në një normale sipas llogaritjes së ekspertëve në mënyrë që të mos caktohet çmimi i ofertuesve nga autoriteti prokurues;
- Të ndiqet zbatimi i kontratave pasi vendosja e çmimeve anomalisht të ulta nënkupton mosmarrjen e shërbimit të prokuruar (numri i posteve të rojeve ose turnet/orët e punës më të ulta se ato të kontraktuara).
- Përfjashtimin nga prokurimi publik të shoqërive që kanë marrë pjesë në marrëveshje të ndaluara në prokurimet publike sipas vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës.
- Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi të gjithë palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.409, datë 21.03.2016

Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore” dhe dhënie rekomandimesh për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

Komisioni i Konkurrencës, i përbërë nga:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.03.2016, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Raportin e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore”.

Baza ligjore: Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 5) dhe neni 70, (pika 2) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e më poshtë Ligji), neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe neni 5 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore”, si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËRËN SE:

PROCEDURA E NDJEKUR

Autoriteti i Konkurrencës, nisur nga një artikull në media ku trajtohet një shqetësim mbi mungesën potenciale të konkurrencës në tregun e shërbimit të sinjalistikës rrugore, kërkoi informacion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (këtu e vijim-ARRSH), lidhur me procedurat e prokurimit të realizuara me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës loti I dhe loti II. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se firmat fituese në të dy lotet kanë qenë shumë pranë fondit limit si dhe ka një mungesë të pjesëmarrjes së operatorëve aktivë në tregun përkatës në procedurat e prokurimit në të dy lotët, ku ndërmarrjet mund të kenë përdorur skemën e rrotacionit të ofertave duke ndarë tregun.

Ndodhur para një situatë e cila mund të përmbajë shenja për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun e prokurimit të objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi” Loti I dhe Loti II, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1 të Ligjit, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 376, datë 15.10.2015, vendosi të miratojë hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi” Loti I dhe Loti II”, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

Në bazë të raportit të hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konkludoi se vihen re shenja të kufizimit të konkurrencës për rrjedhojë u shpreh me Vendimin nr. 386, datë 14.12.2015, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës

vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore” vendosi hapjen e kësaj procedure për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit, Sekretariati ka grumbulluar të dhëna dhe informacione nga autoriteti kontraktor për procedurën e prokurimit nën hetim.

Në bazë të neneve 35 dhe 36 të Ligjit si dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës, u kryen inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg.

Në ndërmarrjen "RS&M" Sh.p.k gjatë inspektimit u gjet shkresa nr. 378 prot, datë 14.09.2015 e Autoritetit të Konkurrencës, drejtuar Autoritetit Rrugor Shqiptar me objekt: Kërkesë për Informacion, lidhur me procedurat e prokurimit të realizuara në datat 07.09.2015 dhe 09.09.2015 me objekt: "Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore - vazhdimi, Loti 1 dhe Loti 2".

Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 787/18 prot. datë 24.02.2016, i rekomandon Autoritetit të Konkurrencës hetimin për rrezikun e ekzistencës së një marrëveshje të ndaluar në oferta në prokurimet publike zhvilluar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për vitet 2014-2015, bazuar në konstatimet e saja nga auditimi i ushtruar në ARRSH për objektet e sinjalistikës rrugore.

Për sa më sipër, Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 100/1 prot, datë 03.03.2016 “Kthim përgjigje” ka kërkuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), që në vijim të procedurës së hetimit të thelluar të këtij tregu (bazuar në rekomandimet e KLSH) të vënë në dispozicion faktet dhe provat që disponojnë, në lidhje me skemat e rotacionit në të qenit fitues, si dhe elementë të tjerë të kontrollit të tregut, ekzistencës së marrëveshjeve të fshehta midis operatorëve dhe monopolizimit të tregut në procedurat e prokurimit të realizuara nga autoriteti kontraktor “Autoriteti Rrugor Shqiptar”.

Në përgjigje të kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës, Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 100/2 prot, datë 21.03.2016, ka vënë në dispozicion pjesë nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në ARRSH, në lidhje me konstatimet e saj. Bazuar në këtë raport nuk rezultuan prova dhe fakte shtesë lidhur me mundësinë e një marrëveshje të ndaluar në oferta në prokurimet publike për objektet e sinjalistikës rrugore.

Në vazhdim të procedurës së hetimit thelluar në përgjigje të kërkesës për takim nr.51 prot., datë 02.02.2016, u zhvillua takimi me përfaqësues të ARRSH-së mbi disa sqarime lidhur me problematikat e dala gjatë procedurave të hetimit në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi, i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore”. Gjatë takimit u mbajt procesverbal i datës 09.02.2016 “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit”.

Bazuar në përgjigjet e dhëna nga përfaqësuesit e ARRSH-së, sipas pyetjeve të procesverbalit, rezultoi se për shkak të natyrës së këtij tregu i cili kërkon investime, kapacitete të konsiderueshme, makineri të kushtueshme etj., numri i operatorëve që operojnë në këtë treg është i vogël, si rrjedhojë janë të pakët operatorët që kanë kapacitetet e duhura për të marrë pjesë në këto procedura. Gjithashtu nuk ka pjesëmarrje të operatorëve ndërkombëtarë, preventivi i çmimeve bëhet sipas manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, i cili përfshin shumicën e zërave mbi 90%, dhe është miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analiza teknike të tyre”. Në këtë manual janë të përcaktuara çmimi, shpenzimet e përgjithshme max. 8% dhe fitimi max. 10%, për rrjedhojë sipas argumentimit të përfaqësuesve të ARRSH ofertat dalin afër fondit limit. Çmimet e zërave të punimeve të përcaktuara në manualin teknik janë orientuese dhe referuese për planifikimin e buxhetit vjetor (fondit limit).

NDËRMARRJET NËN HETIM

Ndërmarrjet nën hetim, të cilave u është njoftuar Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 386, datë 14.12.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt "Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore", si dhe janë të përcaktuara në këtë Vendim janë:

- Ndërmarrja “R. S. & M” sh.p.k,
- Ndërmarrja “I.D.K – KONSTRUKSION” sh.p.k,
- Ndërmarrja “JUBICA” sh.p.k,
- Ndërmarrja “RSM Company” është regjistruar si person juridik pranë QKR-së me datë 03.12.2010, si degë e shoqërisë së huaj.

ANALIZA E KONKURRENCËS

Tregu përkatës i produktit

Operatorët ekonomikë që të jenë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duhet të përmbushin të gjitha ato kriteret që vlerësohen të nevojshme nga autoriteti kontraktor dhe që kanë të bëjnë me kualifikimin profesional, aftësitë teknike, gjëndjen ekonomike e financiare, kapacitetet ligjore, si dhe standardet e kërkuara të cilësisë. Këto kriteret e bëjnë specifike një procedurë prokurimi.

Vlerësimi i konkurrencës dhe analiza e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve të saj realizohet në një treg përkatës produkti. Tregu përkatës i produktit objekt hetimi është tregu i prokurimit publik “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore”

Tregu përkatës gjeografik

Për vlerësimin e ndikimit që shkakton kufizimi apo shtrembërimi potencial i konkurrencës nga ofertimi, bazuar dhe në vendimin për hapjen e hetimit thelluar, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i prokurimit publik në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Barrierat e hyrjes

Operatorët ekonomikë, që të jenë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duhet të përmbushin të gjitha ato kriteret që vlerësohen nga autoriteti kontraktor lidhur me kualifikimin profesional, aftësitë teknike, gjëndjen ekonomike e financiare, kapacitetet ligjore, specifikimet teknike si dhe standardet e kërkuara të cilësisë.

Bazuar në parimet e prokurimit publik afatet e përcaktuara në një procedure prokurimi duhet të vlerësohen dhe vendosen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet, me qëllim mundësimin e një pjesëmarrjeje sa më të gjerë dhe njëkohësisht rritjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Afatet e përcaktuara në pikën 5, Neni 43, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i referohen të gjitha prokurimeve me procedure të hapur me një vlerë ndërmjet kufirit më të ulët dhe më të lartë monetar, përkatësisht 12,000,000 Lekë deri në 1,200,000,000 Lekë, duke treguar qartë se sa me e lartë të jete vlera e fondit limit aq më i gjatë duhet të jetë afati i zhvillimit të procedurës konkurruese.

Për sa më sipër, konstatojmë se Autoriteti Kontraktor në hartimin e kriterëve për kualifikim në zbatim të Ligjit për prokurimin publik përdor “standard të dyfishtë”. Kështu në përcaktimin e afatit kohor për dorëzimin e ofertës përdor afatin minimal të përcaktuar në nenin 43 (pika 5 dhe 8) të LPP, duke mos ju lënë mjaftueshëm kohë operatorëve ekonomikë në përgatitjen e ofertave.

Nga ana tjetër fondi limit shumë i lartë sjell vendosjen e kriterëve ekonomike-financiare dhe teknike të larta duke i vendosur operatorët ekonomik në vështirësi për ti plotësuar, si rezultat vendosjen e tyre në kushte të pa favorshme konkurrence. Kjo mënyrë e vendosjes së kriterëve ka çuar në mungesë të konkurrencës duke sjellë vazhdimin e procedurës vetëm me një ofertë të vlefshme (neni 73 i LPP), si dhe duke drejtuar ndërmarrjet të paraqesin oferta si “bashkim operatorësh”.

VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE

Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e prokurimit publik përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore, është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”.

Gjatë procedurës së hetimit paraprak u kryen inspektime të njëkohshme pranë ndërmarrjeve të mësipërme ku u mbajtën proces-verbalet përkatëse të inspektimit dhe të marrjes së shpjegimeve. Gjatë procedurave të inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte që të provonin ekzistencën e bashkëpunimit, ose marrëveshjeve të ndaluara midis ndërmarrjeve nën hetim.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin u kërkuar informacion nga ndërmarrjet nën hetim si edhe nga ARRSH, i cili u depozitua pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Për vlerësimin e sjelljes është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga ndërmarrjet, dokumentacioni i administruar nga autoriteti kontraktor ARRSH, dokumentacioni i administruar nga inspektimet, meqenëse gjatë inspektimeve të befasishme të realizuara në ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, nuk u gjet asnjë evidencë direkte që të vërtetonte bashkëpunimin në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik.

Gjatë vitit 2015 janë zhvilluar dy procedura prokurimi në tregun e përmirësimit, rifreskimit të sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimit të sigurisë rrugore. Në këto procedura kanë qenë pjesëmarrës ndërmarrjet nën hetim: “R.S & M” sh.p.k; “I.D.K -Konstruksion” sh.p.k; “Jubica” sh.p.k dhe “RSM Company” SHPK Për vlerësimin e sjelljes së tyre nëse jemi para skemave të marrëveshjeve në oferta, është bërë analiza më e thelluar e pjesëmarrjes së tyre në prokurimet.

Procedurat e prokurimit zhvilluar gjatë vitit 2015

Procedurat e prokurimit Loti I, viti 2015

Procedura me objekt: “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale /horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi, loti 1”, me fond limit: 868,942,476.15 lekë (pa tvsh) zhvilluar më datë 09.09.2015 ku kanë marrë pjesë: bashkimi i operatorëve “RS&M & IDK – Konstruksion” me një ofertë me vlerë 839,799,584.4 lekë pa TVSH; dhe RSM Company me një ofertë me vlerë 685,315,434.56 lekë pa TVSH.

Në këtë procedurë prokurimi, oferta fituese është bashkimi i operatorëve “RS&M & IDK – Konstruksion”, me vlerë oferte me 96.65% të fondit limit, ndërsa RSM Company është paraqitur me 78.87% të fondit limit. Ofertuesi RSM Company SHPK, nuk ka paraqitur dokumentet ne perputhje me kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit dhe për këtë arsye është skualifikuar.

Nga analiza e dokumenteve te disponueshme nuk u gjeten evidenca direkte bashkëpunimi midis ndërmarrjeve ofertuese, nuk rezultuan shenja të ngjashme në përgatitjen e dokumenteve, si dhe nuk u konstatua ekzistenca e skemave të marrëveshjeve në oferta (oferta e mbuluar dhe oferta e përmbajtur). Nga vlerësimi i preventivëve nuk rezulton që ofertat nga të dy ofertuesit të kenë shifra të njëjta të caktuara për artikuj të caktuar, ose ndonjë % e njëjtë në formimin e çmimit të ofertës.

Procedurat e prokurimit Loti II, viti 2015

Procedura e dytë me objekt: “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi, Loti II”, me fond limit 499,836,637 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë: 07.09.2015 kanë marre pjesë: “Jubica” me një ofertë me vlerë 484,339,653 lekë pa TVSH dhe RSM Company me një ofertë me vlerë 393,932,698.15 lekë pa TVSH. Oferta fituese është ndërmarrja “Jubica” SHPK me 96.9% të fondit limit, ndërsa RSM Company është paraqitur me 78.81% të fondit limit. Ofertuesi RSM Company SHPK, nuk ka paraqitur dokumentet ne përputhje me kriteret e dhëna ne dokumentet e tenderit dhe për këtë arsye është skualifikuar.

Për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në plotësimin e ofertave kemi vlerësuar nëse kemi shënja dhe modele çmimi (ne oferten ekonomike te paraqitur) që tregojnë për marrëveshje në oferta. Operatorët ekonomikë ndërmarrja JUBICA Sh.p.k dhe ndërmarrja RSM Company Sh.p.k kanë diferenca të ndjeshme në çmimin e ofertave. Nga analiza e kësaj oferte nuk rezulton të ketë modele të njëjta çmimi.

Bazuar në provat dhe evidencat e analizuara rezulton se: në procedurën me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi, Loti II”, nuk u gjeten evidenca direkte bashkëpunimi midis ndërmarrjeve ofertuese, nuk rezultuan shenja të ngjashme në përgatitjen e dokumenteve, modele të njëjta çmimi, si dhe nuk u konstatua ekzistenca e skemave të marrëveshjeve në oferta (oferta e mbuluar dhe oferta e përmbajtur).

Procedurat e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2014

Për të bërë një vlerësim më të plotë të ndërmarrjeve nën hetim është kërkuar informacion pranë ARRSH për tenderat e zhvilluar me të njëjtin objekt për vitin 2014. Nga ARRSH janë depozituar dokumentet standarde të tenderave përkatës, proces -verbalet e mbajtura lidhur me këto procedura, si dhe formularët e njoftimit të fituesit. Bazuar në dokumentacionin e zotëruar, rezulton se gjatë vitit 2014 janë zhvilluar tre procedura prokurimi si më poshtë:

Procedura me objekt “Përmirësim i sigurisë dhe sinjalistikës rrugore në superstradën Tiranë-Durrës dhe segmentin rrugor Kashar-Rinas”, Loti 1, me Fond Limit 333,248,645 lekë pa tvsh zhvilluar më datë 03 Tetor 2014. Operatorët ekonomik ofertues të kësaj procedure janë: IDK nuk ka paraqitur ofertë ekonomike; “JUBICA & ITE GROUP” me vlerë oferte 329,650,535 lekë pa tvsh. Fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik “JUBICA & ITE GROUP” me vlerë oferte 329,650,535 lekë pa tvsh.

Oferta fituese është bashkimi i operatorëve "JUBICA & ITE GROUP" me 98.92% të fondit limit. Përfaqësues i bashkimit të operatorëve është ndërmarrja Jubica SHPK e cila do të realizojë 66% të vlerës totale të punimeve. Ndërmarrja ITE Group do të realizojë 34% të vlerës totale të punimeve. ARRSH ka vënë në dispozicion dokumentacionin e paraqitur nga ky bashkim operatorësh "JUBICA & ITE GROUP", ndërsa për operatorin I.D.K Konstruksion deklaroi që nuk ka paraqitur dokumenta në sistemin e APP. Duke qenë se nuk ka një ofertë ekonomike të ndërmarrjes “I.D.K Konstruksion” nuk bëhet e mundur analiza e plotë e sjelljes së mundshme antikonkurrese të operatorëve pjesëmarrës.

Procedura e prokurimit me objekt “Përmirësim i sigurisë dhe sinjalistikës rrugore në superstradën Tiranë-Durrës dhe segmentin rrugor Kashar-Rinas, Loti 2 (Rrethrotullimi i Doganës-Mbikalimi i Kasharit)”, me fond limit: 247,972,471 lekë pa tvsh, zhvillur me datë 19 Nëntor 2014. Në këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur ofertat e tyre ekonomike operatorët: “ALB BUILDING dhe RS&M” me vlerë oferte 220,672,851 lekë pa tvsh dhe “I.D.K KONSTRUKSION” me vlerë oferte 245,918,033 lekë pa tvsh.

Fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik “I.D.K KONSTRUKSION” me vlerë oferte 245,918,033 lekë pa tvsh, pasi bashkimi i operatorëve ekonomik “ALB BUILDING dhe RS&M” është s’kualifikuar pasi RS&M është tërhequr nga bashkimi operatorëve.

Me shkresën nr. 6/1 prot., datë 04.02.2016, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka vënë në dispozicion dokumentacionin për procedurat e prokurimit objekt hetimi. Në dokumentacionin për objektet e vitit 2014 nuk janë dokumentat e operatoreve ofertues. Në vijim të takimeve të zhvilluara me APP dhe ARRSH ju kërkua kësaj të fundit të na mundësojë aksesin në dokumentet e procedurave të prokurimit. ARRSH hapi një llogari audituesi në emër të Autoritetit të Konkurrencës për të bërë të mundur shkarkimin e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit në këto procedura prokurimi. Pas hyrjes në sistemin e APP me anë të “emër përdoruesi” dhe “password-in” përkatës, të vënë në dispozicion nga ARRSH nuk u bë i mundur aksesimi i procedurave të vitit 2014 të cilat rezultojnë të arkivuara dhe si të tilla nuk mund të aksesohen me një llogari audituesi.

Tërheqja e “RS & M” nga bashkimi i operatorëve duke çuar në skualifikim të ofertës së paraqitur nga ky bashkim të krijon përshtypjen që “RS & M” nuk e ka marrë në konsideratë ofertën e tij deri në fund, duke u përmbajtur nga oferta. Në mungese të dokumentacionit është e pa mundur analiza e plotë e sjelljes së mundshme për skemat e marrëveshjes nga ana e “RS & M” me qëllim shpalljen fitues të I.D.K Konstruksion.

Procedura e prokurimit me objekt “Plotësim-Rifreskim i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim i sigurisë rrugore”, me fond limit 373,332,561 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 25 Qershor 2014. Lidhur me këtë procedurë ka bërë ankesë operatori ekonomik “I.D.K Konstruksion” sh.p.k (ankesa është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara nga ligji). Për këtë procedurë prokurimi kanë paraqitur ofertat e tyre ekonomike operatorët: “ADRIATIKA SRL” me vlerë oferte 316,733,583 lekë, pa TVSH; “R.S & M sh.p.k” me vlerë oferte 355,242,138.6 lekë pa TVSH. Operatorët ekonomik “I.D.K Konstruksion” dhe “SHYQYRI LATOLLARI” nuk kanë paraqitur dokumentacion në sistem. Operatori ekonomik “ADRIATIKA SRL” është s’kualifikuar pasi nuk plotëson kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit. Fitues i procedurës është shpallur operatori ekonomik “R.S & M sh.p.k” me vlerë oferte 355,242,138,6 lekë pa TVSH. Oferta fituese është operatori RS&M SHPK” me 95.15% të fondit limit dhe operatori tjetër i s’kualifikuar është “ADRIATIKA SRL” me 84,84% të fondit limit.

Si konkluzion:

Në përfundim të inspektimeve të njëkohshme nuk u gjetën evidenca direkte ose të tërthorta, të cilat mund të provojnë bashkëpunimin e këtyre ndërmarrjeve në këto procedura prokurimi.

Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, në tregun e prokurimit publik “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore” është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”. Nga analiza e dokumenteve të disponueshme për të dy lotët nuk u gjetën evidenca direkte bashkëpunimi midis ndërmarrjeve ofertuese, nuk rezultuan shenja të ngjashme në përgatitjen e dokumenteve, si dhe nuk u konstatua ekzistenca e skemave të marrëveshjeve në oferta (oferta e mbuluar dhe oferta e përmbajtur).

Kriteret ekonomike, financiare dhe teknike që parashikon ligji dhe rregullat e prokurimit publik për pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik, synojnë të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe të mundësojë një konkurrencë të paanshëm dhe të hapur ndërmjet të gjithë ofertuesve. Por fondi limit për procedurat e prokurimit nën hetim, megjithëse mund të vendoseshin ndërmjet një intervali vlerash të ulët e të lartë monetar, paraqitet me vlerat më të larta. Kjo përbën edhe një nga arsyet që pjesëmarrja në këto procedura prokurimi është e ulët pasi kriteret ekonomike, financiare dhe teknike janë të vështira për tu përmbushur nga operatorët e vegjël dhe të mesëm.

Autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve për kualifikim në zbatim të Ligjit për Prokurimin Publik (i ndryshuar) përdor “standard të dyfishtë”. Kështu në përcaktimin e afatit kohor për dorëzimin e ofertës përdor afatin minimal të përcaktuar në nenin 43 (pika 5 dhe 8) të LPP, duke mos ju lënë mjaftueshëm kohë operatorëve ekonomik ndërkombëtarë në përgatitjen e ofertave. Fondi limit shumë i lartë sjell vendosjen e kriterëve ekonomike-financiare dhe teknike të larta duke i vendosur operatorët ekonomik në vështirësi për t’i plotësuar si rezultat vendosjen e tyre në kushte të pa favorshme konkurrence. Kjo mënyrë e vendosjes së

kritereve ka çuar në mungesë të konkurrencës (neni 73 i LPP), duke sjellë vazhdimin e procedurës vetëm me një ofertë të vlefshme, si dhe duke drejtuar ndërmarrjet të paraqesin oferta si "bashkim operatorësh".

Në këndvështrimin e konkurrencës paraqitja e ofertave nga grupe operatorësh ekonomikë, rrit bashkëpunimin midis ofertuesve konkurrent në një treg të caktuar, duke rritur mundësitë e komunikimit mes tyre në vazhdimësi, për vetë natyrën e vazhdueshme të prokurimeve, si dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit midis tyre para dhe pas shpalljes së ofertës fituese, karakteristikë kjo e cila ndihmon marrëveshjet në oferta.

Me qëllim zbutjen e kritereve kualifikuese dhe shmangien sa më shumë të jetë e mundur të pjesëmarrjes me bashkim operatorësh në prokurimin objekt-hetimi, marrjen e përgjegjësiwe direkte nga një operator ekonomik, si dhe konkurrimin në mënyrë të pavarur të operatorëve, mënyra më e drejtë për të rritur mundësitë e pjesëmarrjes në prokurime të operatorëve të vegjël e të mesëm, si dhe njëkohësisht rritjen e konkurrencës midis tyre është zhvillimi i procedurave në disa lote (segmente më të vogla) në kuptim të ligjit për prokurimin publik.

Ne procedurën me objekt "Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale /horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore - vazhdimi, loti 1 dhe loti 2" zhvilluar në vitin 2015, rezultoi se: për lotin 1, oferta fituese është bashkimi i operatorëve "RS&M & IDK - Konstruksion", me vlerë oferte me 96.65% të fondit limit, ndërsa RSM Company është paraqitur me 78.87% të fondit limit; për Lotin 2 oferta fituese është ndërmarrja "Jubica" SHPK me 96.9% të fondit limit, ndërsa RSM Company është paraqitur me 78.81% të fondit limit.

Nga vlerësimi i preventivëve nuk rezultoi që ofertat nga të dy ofertuesit të kenë shifra të njëjta të caktuara për artikuj të caktuar, ose ndonjë % të njëjtë në formimin e çmimit të ofertës, si dhe nuk vihet re ndonjë lidhje në formimin e çmimit të ofertave të përgatitura nga të dy operatorët fitues të dy loteve. Vihet re që, ndërmarrjet "RS&M" "Jubica", dhe "IDK - Konstruksion", fitojnë kryesisht dhe kanë një ruajtje të pjesëve të tregut me ndryshime të vogla për periudhën 2014-2015;

Bazuar në procedurat e zhvilluara në tregun objekt hetimi për vitet 2014-2015 vihet re një numër i vogël operatorësh aktivë në këtë treg. Konkretisht në dy procedura të vitit 2015 janë 4 pjesëmarrës, ndërsa në vitin 2014 në tre procedura prokurimi janë 7 pjesëmarrës. Ky konkluzion është i mbështetur edhe nga përfaqësuesit e ARRSH, të cilët gjatë takimit të zhvilluar deklaruan se: numri i operatorëve që operojnë në këtë treg është i vogël pasi janë të pakët operatorët që kanë kapacitetet e duhura për të marrë pjesë në këto procedura.

Ndërmarrjet në tre raste nga 5 procedura në total marrin përsipër një ofertë të përbashkët me bashkim operatorësh si Jubica&ITE Group, "Alb Building" & "RS&M" RS&M & IDK - Konstruksion" edhe pse njëri prej tyre mund ta realizonte ofertën e vetëm. Ky bashkim midis ofertuesve konkurrent në këtë treg rrit mundësitë e komunikimit mes tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit lidhur me dy lotet e procedurave të vitit 2015 dhe 3 procedurave të vitit 2014 rezultoi se ndërmarrjet fituese në të 5 lotet kanë qenë shumë pranë fondit limit (95.15% deri 99.17%).

Afërsia kaq e madhe me fondin limit e ofertave fituese shpjegohet me faktin se zërat e preventivit të çmimeve janë bërë sipas manualit të çmimeve, miratuar me VKM nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analiza teknike e tyre" dhe çmimet e zërave të punimeve, të përcaktuara në manualin teknik, sipas VKM 629, janë orientuese dhe referuese, ato janë përdorur në përcaktimin e fondit limit nga ARRSH.

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurës hetimore si: dokumentacioni i dorëzuar nga ndërmarrjet ofertuese në procedurën e prokurimit objekt-hetimi dhe dokumentacionit të administruar gjatë inspektimeve të realizuara në selitë e ndërmarrjeve nën hetim, rezultoi se nuk u konstatuan elementë të bashkëpunimit të ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave, në procedurat e prokuruese në tregun e prokurimit publik, me objekt "Përmirësimin, rifreskimin i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore", të parashikuara në nenin 4 të ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 43, pika 5 dhe neni 70, pika 2 të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

VENDOSI:

- T’i rekomandojë Autoritetit Rrugor Shqiptar:
- Hartimin e procesit të prokurimit në mënyrë të tillë që të nxitet pjesëmarrja e operatorëve të vegjël e të mesëm ekonomik dhe operatorëve të huaj, si:
- Të zvogëlohet madhësia e loteve për të rritur mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve në proceset e prokurimeve.
- Të shmanget sa më shume të jetë e mundur bashkimi i operatoreve si një faktor që rrit mundësinë e bashkëpunimit afatgjatë në dëm të konkurrencës.
- Përcaktimi i afateve kohore të përshtatshëm për përgatitjen e ofertave, në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet, në veçanti kur në pjesëmarrje mund të përfshihen edhe operatorë të huaj.
- Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore”, pasi nuk u vërtetua ekzistenca e një marrëveshje të ndaluar në shkelje të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).
- Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 413, datë 21.04.2016

Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj shoqërive “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK.

Komisioni i Konkurrencës i përbërë nga:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.04.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij.

Baza ligjore: Nenet 4, 8, 9, 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës si dhe te relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

PROCEDURA E NDJEKUR

Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit nr. 400, datë 10.02.2016, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës”.

Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), neni 22 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, neni 4 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe Vendimit nr. 400, datë 10.02.2016 të Komisionit të Konkurrencës, me anë të Urdhrit nr. 14, datë 10.02.2016 “Për ngritjen e grupit të punës “Për ndjekjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij”, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 74, datë 10.02.2016 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve nën hetim.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, ka kërkuar informacion nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) me anë të shkresës nr. 84, datë 17.02.2016, e cila ka kthyer përgjigje me anë të shkresës nr.84/1, datë 07.03.2016.

TREGU PËRKATËS

Në analizë është tregu i produktit qumësht i freskët i lopëve, deleve dhe dhive, i cili grumbullohet nga fermerët, shkon për përpunim dhe ambalazhim në disa fabrika prodhimi dhe përpunimi në vendin tone, me vendndodhje kryesisht në Lushnje, Berat, Gjirokastrë, Shkodër e Tiranë, dhe pas përpunimit tregtohet në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë.

Duke qenë se qumështi i përpunuar dhe ambalazhuar kalon në disa procese teknologjike, pra trajtohet dhe i nënshtrohet përpunimit termik përpara konsumimit, për analizën e mëposhtme është përjashtuar qumështi i freskët, i cili tregtohet në tregun “informal” në shishe plastike, i mbushur direkt dhe i papërpunuar në fabrika të mëdha.

Gjithashtu, produktet e marra në analizë janë produkte të freskëta dhe kanë një kohë të shkurtër konsumi deri në 7 ditë, duke përjashtuar nga ky treg të gjitha produktet UHT, të cilat kanë një jetëgjatësi më të madhe.

Për sa më sipër, treg përkatës të produktit do të konsiderojmë “tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij: qumësht i freskët ambalazhuar me shishe plastike 1.5 litër, kos i freskët i ambalazhuar me shishe plastike 1 litër dhe kos i freskët i ambalazhuar me gota plastike 480 gr.

Referuar dimensionit gjeografik, themi që ky treg ka dimension kombëtar për faktin se të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet distribucionit (shpërndarjes) së produkteve të tyre në tregun e brendshëm. Eksportet e ndërmarrjeve nuk janë të zhvilluara si dhe politikat e vendosjes së çmimit të këtyre ndërmarrjeve janë bazuar në politikat kombëtare. Pra, për vlerësimin e impaktit që shkakton ofrimi, Tregu Gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

STRUKTURA E TREGUT

Gjatë fazës së hetimit paraprak janë analizuar të dhënat për rreth 9 ndërmarrje të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun përkatës për periudhën hetimore, dhe ndërmarrjet Lufra dhe Erzeni zotrojnë rreth 75 – 80% të pjesës së tregut të shitjes sipas sasisë dhe vlerës së shitur për produktet në tregun përkatës.

Nga analiza e treguesve të përqendrimit HHI, vërehet një përqendrim shumë i lartë i tregut, për të tre produktet e marra në analizë, si pasojë e pjesës së madhe të tregut që zënë dy ndërmarrjet Lufra dhe Erzeni.

Ky indeks paraqitet përafërsisht në të njëjtat nivele në të dyja vitet 2014 dhe 2015, i cili tregon që nuk ka pasur ndonjë ndryshim të strukturës së tregut të ndërmarrjeve për këto produkte dhe tregu mbetet i përqendruar.

Si përfundim, nga analizimi i treguesve të përqendrimit, pjesët e tregut të ndërmarrjeve gjatë periudhës nën hetim, si dhe krahasimi i cmimeve të aplikuara nga ndërmarrjet për periudhën hetimore për produktet në tregun përkatës, vërehet se ndërmarrjet Lufra dhe Erzeni paraqesin dyshime për ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar.

VLERËSIMI I KUFIZIMEVE TË MUNDSHME NË TREG

Nga analiza e trendit të çmimit mesatar mujor të shitjes së qumështit të ambalazhuar me shishe plastike 1.4 litra, kosit të ambalazhuar 350/380 gr, kos i ambalazhuar me shishe 0.95 / 1 litër, për periudhën 2014 – Janar 2016, vërehet se ndërmarrjet LUFRA dhe ERZENI aplikojnë çmime të shitjes me shumicë të këtij produkti me ndryshime shumë të vogla nga njëri-tjetri, çmimet e tyre janë më të larta se të konkurrentëve të tjerë më të vegjël të tregut, si dhe çmimet e shitjes me pakicë janë të caktuara dhe pa luhatshmëri sezonale gjatë gjithë periudhës objekt hetimi;

Si konkluzion, referuar analizës së mësipërme, rezulton se për ndërmarrjet LUFRA SHPK dhe ERZENI SHPK, të cilat zotërojnë 75 – 80 % të tregut sipas sasisë dhe vlerës së shitur të produkteve në tregun përkatës, për periudhën Janar 2014 – 31 Janar 2016, ekzistojnë shenjat e një kufizimi të mundshëm të konkurrencës sipas parashikimeve të nenit 4, pika 1, germa (a) (marrëveshje e ndaluar) dhe/ose nenit 9 (abuzim me pozitën dominuese) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, pika 1, nenit 9, nenit 24, (shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), nenin 4 dhe nenin 5 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, ndaj ndërmarrjeve “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK me objekt ekzistencën ose jo të një marrëveshje të ndaluar ose abuzimin ose jo me pozitën e përbashkët dominuese në tregun përkatës.
 - II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 01 Janar 2014 deri në 31 Mars 2016;
 - III. Procedurat e hetimit të thelluar duhet të përfundojnë jo më vonë se 6 muaj nga data e marrjes së këtij vendimi.
 - IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 430, datë 7.09.2016

Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme).

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.09.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi çmimet e sigurimit të detyrueshëm ndaj palëve të treta (MTPL)”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të: Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi çmimet e sigurimit të detyrueshëm ndaj palëve të treta (MTPL)” dhe monitorimit në kete treg,

VËREN SE:

Nisur nga artikujt në median e shkruar, në lidhje me një rritje të çmimit të sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL) nga të gjitha kompanitë e sigurimeve me rreth 25%, më datë 24.08.2016, Inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës realizuan një monitorim pranë agjentëve të shitjes së policave të sigurimit.

Nga monitorimi i realizuar pranë agjentëve të shitjes së policave të sigurimit, si dhe nga deklaratimet e këtyre të fundit, konstatohet se më datë 24.08.2016, është realizuar rritja e çmimit të sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL) për të gjitha kategoritë dhe nga të gjitha kompanitë e sigurimit në masën prej 20%.

Kjo rritje është reflektuar në sistemin online të prerjes së policave të sigurimit (MTPL) të agjenteve të sigurimeve të të gjitha kompanive të sigurimit më datë 24.08.2016, dhe vërehet se këto prime shitje ndryshojnë në mënyrë simetrike nga njëra kompani sigurimi tek tjetra, me të njëjtën masë prej 12 lekë, sjellje kjo e cila mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar sipas përcaktimeve të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme);
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga 01 Janar 2016 deri më 07 Shtator 2016;

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj, si dhe paraqitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 23.09.2015.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.435, datë 21.09.2016

Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme).

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.09.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme)".

Baza ligjore: Nenet 4, 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar), si dhe neni 12 i Rregullores "Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës".

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme), të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, si dhe të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

PROCEDURA E NDJEKUR

Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit nr. 430, datë 07.09.2016 "Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme)", vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorrik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për produktin MTPL e brendshme.

Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 151/1, datë 07.09.2016 "Autorizim Inspektorësh", Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve nën hetim.

TREGU PËRKATËS

Tregu përkatës i produktit

Produkti i sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit (MTPL e brendshme) është një kontratë e lidhur midis siguresit (Shoqëritë e Sigurimit) dhe pronarit të mjetit motorrik, i cili pranon kushtet e siguresit. Kushtet e sigurimit janë pjesë e pandashme e kontratës së sigurimit, të cilat miratohen nga AMF-ja. Ky produkt hyn në klasën e sigurimeve të detyrueshme dhe është unik në llojin e vet, pra nuk ka zëvendësues.

Tregu përkatës gjeografik

Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofrimi, tregu gjeografik do të konsiderohet Territori i Republikës së Shqipërisë.

STRUKTURA E TREGUT

Tregu i sigurimit të detyrueshëm të mjeteve të transportit ka qenë objekt i vazhdueshëm monitorimi dhe hetimi për kufizime të konkurrencës në treg, ku ka pasur sanksione ndaj ndërmarrjeve që kanë shkelur Ligjin për mbrojtjen e Konkurrencës, si dhe janë dhënë rekomandime AMF-së për rritjen e konkurrencës në treg.

Mbikëqyrja e tregut të sigurimeve kryhet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), si autoriteti rregullator përkatës, që ka përgjegjësinë e rregullimit teknik dhe ekonomik, nëpërmjet nxjerrjes së akteve rregulluese për këtë treg. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miraton rregullat për përcaktimin e kushteve të përgjithshme të sigurimit të detyrueshëm dhe nivelin e rezervave teknike dhe provigjoneve.

AMF-ja me Vendimin nr. 34, datë 24.03.2016 “Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti”, miratoi tabelat e reja të primit të rrezikut.

Pjesët e tregut

Nga të dhënat e faqes zyrtare të AMF-së, për periudhën Janar – Korrik 2016, në tregun e MTPL ndërmarrja kryesore është Sigal me 21,5%, në vend të dytë ndërmarrja “Sigma Interalkanian VIG” me 17.5% të tregut, në vend të tretë ndërmarrja “Intersig VIG” me 13% të tregut, në vend të katërt ndërmarrja “Eurosig” me 12.7% të tregut, në vend të pestë ndërmarrja “Albsig” me 9.5% të tregut, në vend të gjashtë ndërmarrja “Insig” me 9.1% të tregut, në vend të shtatë ndërmarrja “Atlantik” me 8.7% të tregut dhe në vend të tetë ndërmarrja “Ansigt” me 8% të tregut.

Nga krahasimi i vlerës totale të primeve të shkruara bruto për periudhën Janar – Korrik 2016 me periudhën Janar – Korrik 2015, vërehet një rritje të primit të shkruar bruto në vlerë për produktin MTPL e brendshme, por pjesët e tregut të ndërmarrjeve mbeten pothuajse të njëjta.

SJELLJA E NDËRMARRJEVE NË TREG

Vlerësimi i kufizimeve të konkurrencës në treg

Sekretariati ka realizuar inspektime për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një marrëveshje të ndaluar midis konkurrentëve ose të një praktike të bashkërenduar mes kompanive, lidhur me caktimin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të primeve të shitjes, ndarjes së tregut apo kufizimit ose kontrollit të tregut. Gjatë inspektimeve janë administruar materiale të nevojshme për hetimin për të bërë të mundur vlerësimin e kufizimeve të konkurrencës në treg.

Nga inspektimi i realizuar në shoqërinë e brokerimit “Star Broker” SHA, u gjendën shkresat e të gjitha shoqërive të sigurimit, të cilat njoftonin shoqërinë Star Broker, e cila bën administrimin e sistemit të shitjes së policave të MTPL së brendshme, që prej datës 24 gusht 2016, shoqëritë do të aplikojnë çmime më të larta. Për këtë arsye, brokeri Star Broker ka bërë ndryshimin në sistem të çmimeve të shitjes së policave sipas njoftimeve të shoqërive të sigurimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në inspektim, vërehet se të gjitha shoqëritë e sigurimit kanë caktuar datën 24 gusht 2016, për aplikimin e çmimeve të ndryshuara për produktin MTPL e brendshme, duke e rritur çmimin për të gjitha kategoritë (16 kategori) në të njëjtën masë me 16.7%, duke e njoftuar shoqërinë “Star Broker” në rrugë shkresore më datë 23 Gusht 2016, me përjashtim të ndërmarrjes “Ansigt”, shkresa e të cilës mban datën 24 Gusht 2016. Në zbatim të kërkesave të mësipërme shoqëria “Star Broker” SHA ka realizuar ndryshimin e tarifave për kategoritë MTPL në sistemin e shitjes në të njëjtën kohë, për të gjitha shoqëritë e sigurimit, në datë 24.08.2016, ora 00:00.

Nga krahasimi i primit të shitjes së MTPL të aplikuar përpara datës 24.08.2016 me primin e shitjes së MTPL të aplikuar nga data 24.08.2016 vërehet se masa e rritjes së primit të shitjes është 16.7% për të gjitha ndërmarrjet dhe për të gjitha kategoritë e produktit.

Ndërmarrjet aplikojnë prime shitje të cilat ndryshojnë në mënyrë simetrike me diferencë prej 12 lekë nga njëra ndërmarrje tek tjetra, sipas renditjes së ndërmarrjeve referuar pjesëve të tregut, ku ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu ka çmimin më të ulët deri tek ndërmarrja më e vogël me çmimin më të lartë. Diferenca nga çmimi më i ulët tek çmimi më i lartë është 84 lekë, për të gjitha kategoritë e MTPL.

Si konkluzion, rritja në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën masë e primit të shitjes së produktit MTPL e brendshme nga të gjitha shoqëritë e sigurimit të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e MTPL së brendshme, mund të përbejë një sjellje të bashkërenduar bazuar në nenin 4, pika 1, germa a) dhe c) të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, pika 1, nenit 24, shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), nenit 4 dhe nenit 5 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik ndaj palëve të treta (MTPL e brendshme) ndaj shoqërive: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA SHA, SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA, ATLANTIK SHA, INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP, ALB - SIGURACION SHA (Albsig), INSTITUTI I SIGURIMEVE SHA (Insig), EUROSIG SHA dhe “ANSIG” SHA, për të parë nëse ka ose jo shkelje të nenit 4 të Ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) dhe vlerësimin e akteve ligjore dhe nënligjore të cilat mund të sjellin kufizime në tregun përkatës.
- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2016 deri në 20.09.2016;
- III. Procedurat e hetimit të thelluar duhet të përfundojnë jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e marrjes së këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 444, datë 30.11.2016

Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj shoqërive “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK dhe dhënien e rekomandimeve për rritjen e konkurrencës në tregun përkatës.

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e :

Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
Znj. Servete Gruda	Zv. Kryetar
Z. Koço Broka	Anëtar
Znj. Iva Zajmi	Anëtar
Z. Eduard Ypi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.11.2016, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e Raportit të hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj shoqërive “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK.

Baza ligjore: Nenet 4, 9, 8, 24, (shkronja d); 26 dhe 43 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj shoqërive “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, si dhe të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës për procedurë hetimore,

VËREN SE :

PROCEDURA E NDJEKUR

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, si dhe të nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 413, datë 21.04.2016 “Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj shoqërive “Lufra” SHPK dhe “Erzeni” SHPK”, vendosi hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve ERZENI SHPK dhe LUFRA SHPK, duke përcaktuar si periudhë hetimi 01 Janar 2014 – 31 Mars 2016.

Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), nenit 22 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës, nenit 4 të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe Vendimit nr. 413, datë 21.04.2016 të Komisionit të Konkurrencës, me anë të Urdhrit nr. 36, datë 04.05.2016 “Për ngritjen e grupit të punës “Për ndjekjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj ndërmarrjeve Lufra SHPK dhe Erzeni SHPK”, ngriti grupin e punës.

Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, grupi i punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga ndërmarrja nën hetim, nga ndërmarrjet e tjera pjesëmarrëse në treg dhe nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

TREGU PËRKATËS

Tregu përkatës i produktit

Referuar dimensioneve të tregut përkatës si dhe bazuar në Vendimin nr. 413, datë 21.04.2016 të Komisionit të Konkurrencës, tregu përkatës të produktit do të konsiderojmë “tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij”: qumësht i freskët i ambalazhuar me shishe plastike 1.4 litër, kos i freskët i ambalazhuar me shishe plastike 0.95 litër dhe kos i freskët i ambalazhuar me gota plastike 380 gr.

Tregu përkatës gjeografik

Referuar dimensionit gjeografik, ky treg ka dimension kombëtar për faktin se të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet distribucionit (shpërndarjes) së produkteve të tyre në tregun e brendshëm. Eksportet e ndërmarrjeve nuk janë të zhvilluara si dhe politikat e vendosjes së çmimit të këtyre ndërmarrjeve janë bazuar në politikat kombëtare. Pra, për vlerësimin e impaktit që shkakton ofrimi, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

VLERËSIMI I POZITËS DOMINUESE

Vlerësimi i pozitës dominuese është hapi i parë për të vazhduar me analizën e nenit 9 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, për sjellje të mundshme antikonkurrese në treg. Përkufizimi i pozitës dominuese është përcaktuar në nenin 3, pika 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), përkatësisht: “Pozitë dominuese” është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.

Duke patur parasysh pjesët e tregut për vitet 2014-2015, barrierat ligjore, fuqinë ekonomiko-financiare, rrjetin e shpërndarjes, ekonominë e shkallës, homogjenitetin e produktit, fuqinë kundërvepruese të blerësve dhe bazuar në pikën 5 të nenit 3 dhe nenin 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, konkludojmë se: ndërmarrja “LUFRA” SHPK dhe ndërmarrja “ERZENI” SHPK zotërojnë pozitë dominuese kolektive në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij: qumësht i freskët i ambalazhuar me shishe plastike 1.4 litër, kos i freskët i ambalazhuar me shishe plastike 0.95 litër dhe kos i freskët i ambalazhuar me gota plastike 380 gr, pasi zotërojnë fuqi ekonomike, e cila ju jep mundësinë të jenë të pavarura kundrejt veprimeve të pjesëmarrësve të tjerë në treg, si konkurrentët, klientët dhe konsumatorët.

SJELLJA E NDËRMARRJEVE NË TREG

Duke qenë se dy ndërmarrjet nën hetim, “LUFRA” SHPK dhe “ERZENI” SHPK, zotërojnë pozitë dominuese kolektive në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij: qumësht i freskët i ambalazhuar me shishe plastike 1.4 litër, kos i freskët i ambalazhuar me shishe plastike 0.95 litër dhe kos i freskët i ambalazhuar me gota plastike 380 gr, analiza e sjelljes së tyre është realizuar në lidhje me ndonjë abuzim të mundshëm në tregun përkatës, sipas nenit 9, pika 2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ose mbi ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje të ndaluar sipas nenit 4 të këtij Ligji.

Sjellja e ndërmarrjeve me pozitë dominuese në treg

Analiza e konkurrencës është mbështetur në parashikimet e nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), lidhur me aplikimin e çmimeve të padrejta, nga një funksion i kostove të ofruara nga dy ndërmarrjet me pozitë dominuese. Një nga format e abuzimit me pozicionin dominues janë çmimet e padrejta. Në çështjen United Brands, Komisioni Europian është shprehur se një çmim është abuziv nëse: diferenca midis çmimit dhe kostos marxhinale është ekseseive.

Për sa më sipër, Komisioni European i quan si çmime ekseseive ku vlerësohet nëse diferenca midis kostos marxhinale dhe çmimit është e lartë, në rastin e çmimit të produkteve nën hetim janë administruar nga ndërmarrjet kostot e produkteve të tregut përkatës, qumësht me shishe plastike 1.4 Litër, kos me gota 380 gram dhe kos me shishe 0.95 litër, dhe rezulton se nuk jemi në rastin e çmimeve ekseseive.

Si përfundim, arrijmë në përfundimin se ndërmarrjet me pozitë dominuese kolektive në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij: qumësht i freskët i ambalazhuar me shishe plastike 1.4 litër, kos i freskët i ambalazhuar me shishe plastike 0.95 litër dhe kos i freskët i ambalazhuar me gota plastike 380 gr, “LUFRA” SHPK dhe “ERZENI” SHPK nuk aplikojnë çmime ekseseive apo të padrejta, në kuptim të nenit 9, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, për klientët dhe konsumatorët përfundimtarë.

Strategjia e marketingut të ndërmarrjeve

Nga hetimi rezulton se ndërmarrjet nën hetim kanë shpërndarë frigoriferë me logot e secilit prej tyre në pikat e shitjes me pakicë.

Ndërmarrja ERZENI ka shpërndarë në pikat e shitjes me pakicë frigoriferë me anë të kontratave të huapërdorjes dhe në këta frigoriferë vendosen vetëm produktet ERZENI, por nuk ka kufizim që pika e shitjes të vendosë frigoriferë të tjerë. Aktualisht kjo ndërmarrje ka shpërndarë rreth 200 frigoriferë.

Referuar kontratave të huapërdorjes që ndërmarrja ERZENI aplikon për dhënien në përdorim të përkohshëm të frigoriferëve, rezulton se frigoriferi jepet në përdorim të përkohshëm për afat 1 (një) vjeçar dhe një nga detyrimet e huamarrësit është që të vendosë në frigorifer vetëm artikujt e ndërmarrjes ERZENI, por pa kufizuar tregtimin e produkteve të konkurrentëve të tjerë në njësinë e tregtimit.

Ndërmarrja LUFRA ka shpërndarë në pikat e shitjes me pakicë frigoriferë me anë të kontratave të bashkëpunimit dhe në këta frigoriferë është e ndaluar të futen produkte të konkurrencës, por mund të futen produkte të tjera për mbajtjen në punë të frigoriferit. Aktualisht kjo ndërmarrje ka shpërndarë rreth 500 frigoriferë.

Referuar kontratave të bashkëpunimit që ndërmarrja LUFRA aplikon për dhënien në përdorim të përkohshëm të frigoriferëve tek pikat e shitjes me pakicë, rezulton se frigoriferi mbetet në pronësi të ndërmarrjes LUFRA dhe jepet në përdorim të përkohshëm për afat 1 (një) vjeçar dhe një nga detyrimet e pikës së shitjes me pakicë është që të mos mbajë në këtë frigorifer asnjë produkt tjetër përveç produkteve të ndërmarrjes LUFRA, por pa kufizuar tregtimin e produkteve të konkurrentëve në njësinë e tregtimit.

Ekzistenca ose jo e marrëveshjeve të ndaluara

Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar inspektime (Daën Raids) në të njëjtën ditë dhe orë në dy ndërmarrjet nën hetim që ushtrojnë veprimtari në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij, me qëllim gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një marrëveshje të mundshme ose të një praktike të bashkërenduar mes ndërmarrjeve, por gjatë këtyre inspektimeve nuk u gjet asnjë prove apo evidencë direkte apo indirekte që të provojë një marrëveshje apo sjellje të bashkërenduar në kundërshtim me Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Duke qenë se gjatë inspektimeve nuk u gjetën evidenca direkte mes konkurrenteve, Autoriteti i Konkurrencës kreu analizat ekonomike me qëllim evidentimin e ndonjë sjellje të bashkërenduar mes konkurrenteve për fiksimin direkt apo indirekt të çmimit të shitjes së produktit. Analizimi i sjelljes së ndërmarrjeve “LUFRA” SHPK dhe “ERZENI” SHPK, është bërë bazuar në metodologjinë e OECD-së “Prosecuting cartels without direct evidence”.

Për të provuar ekzistencën e ndonjë marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve “LUFRA” SHPK dhe “ERZENI” SHPK, me anë të evidencave indirekte ekonomike të sjelljes, është realizuar krahasimi i trendit të

çmimeve mesatare mujore të aplikuara nga këto ndërmarrje për produktet qumësht 1.4 litra, kos i ambalazhuar me gota 380 gram dhe kos i ambalazhuar në shishe 0.95 litër, për periudhën nën hetim.

Krahasimi i trendit të çmimit mesatar të shitjes

Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në lidhje me çmimin e shitjes me shumicë ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrjet vendosin direkt apo indirekt çmimet e shitjes me shumicë gjatë periudhës objekt hetimi. Në vlerësimin e trendit të ndryshimit të çmimit mesatar të shitjes me shumicë është marrë në konsideratë krahasimi i çmimeve mesatare mujore të shitjes me shumicë të të gjitha produkteve të tregut përkatës, që ka rezultuar nga përpunimi i të dhënave të sjella nga ndërmarrjet.

Nga analiza ekonomike e të dhënave rezulton se çmimet e aplikuara nga ndërmarrjet për këtë kategori produkti janë të ndryshme nga njëra tjetra dhe ritmi i ndryshimit të tyre është i ndryshëm, duke mos vërejtur shenja të caktimit të çmimeve apo koordinimit të tyre në ritmin e rritjes apo të zbritjes. Gjithashtu, si e përmendën edhe më sipër, gjatë procedurës hetimore nuk janë gjetur evidenca komunikimi midis ndërmarrjeve nën hetim, gjë e cila do të ngrinte dyshime për ndonjë marrëveshje të ndaluar sipas nenit 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Të dhënat mbi ecurinë e çmimeve dhe shitjes në tregun përkatës për produktin qumësht me bidon për dy ndërmarrjet nën hetim tregojnë se çmimi (me TVSH) mesatar i blerjes së qumështit të freskët për Lufra SHPK ka qenë respektivisht 39.7, 38.3 dhe 38.7 për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ndërkohë që çmimi (me TVSH) i shitjes së qumështit të përpunuar ka qenë 85.44, 85.54, dhe 85.46 lekë për litër. Për ndërmarrjen Erzeni SHPK çmimet (me TVSH) e blerjes për vitet 2014, 2015 dhe 2016 ishin 39, 39.79 dhe 44.12 lekë/litër ndërkohë që çmimet e shitjes (me TVSH) ishin 85.08, 85.4 dhe 85.46 lekë/litër.

PROBLEMATIKAT E TREGUT

Gjatë inspektimeve të realizuara në të gjitha ndërmarrjet kryesore që ushtrojnë veprimtari në tregun përkatës, gjatë marrjes së shpjegimeve nga ana e përfaqësuesve të ndërmarrjeve janë paraqitur edhe disa problematika në funksionimin e këtij tregu.

Është konstatuar se duke filluar nga muaji Gusht 2015 është rritur ndjeshëm volumi i shitjes së produkteve të tregut përkatës nga ana e të gjitha ndërmarrjeve aktive në treg. Kjo periudhë përkon me aksionin e Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për formalizimin e ekonomisë.

Gjithashtu, në fund të vitit 2014, Ministri i Financave ka miratuar Udhëzimin nr. 19, datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, i cili ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat mbi zbatimin e tatimit mbi vlerën e shtuar për skemën e kompensimit të prodhuesve bujqësorë. Sipas kësaj skeme, nëpërmjet autofaturës së lëshuar nga blerësi, këtij të fundit i njihet rimbursimi i TVSH për produktin e blerë në masën 20%. Ky rimbursim deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi nuk i njihet plotësisht blerësit, por vetëm në masën 6%.

Efekti i rimbursimit të TVSH-së (me rritjen e shkallës tatimore nga 6 në 20 %) edhe në kushtet e rritjes të paktën dy herë të shitjeve për ndërmarrjen Erzeni SHPK nuk është reflektuar në rritjen e fitimeve për vitin 2014 dhe ka një rritje shumë të vogël të normës së fitimit për vitin 2015.

Megjithëse ndërmarrjet nën hetim Lufra SHPK dhe Erzeni SHPK janë dy konkurrentët kryesorë në treg, kanë pozitë dominuese në tregun përkatës dhe kanë më shumë mundësi të zbatojnë përfitimet e ekonomisë së shkallës (kosto më të ulta për njësi) kostot e tyre janë më të larta se konkurrentët e vegjël sipas deklarimeve të tyre në procesverbalet e inspektimeve.

Për ndërmarrjen Lufra SHPK rritja e TVSH-së nga 6 në 20 % nuk është shoqëruar me rritjen e çmimit të blerjes së qumështit nga fermerët të cilët duhet të ishin përfituesit kryesorë të skemës së rimbursimit të TVSH-së dhe gjithashtu nuk është reflektuar në uljen e çmimit për konsumatorët fundorë.

Nga ana e përfaqësuesve të ndërmarrjeve nën hetim është paraqitur një problematikë, sipas të cilës disa nga njësitë e vogla të tregtimit me pakicë, të cilat janë të regjistruara si biznes i vogël me xhiro vjetore më pak se 5 milion lekë, shpesh here refuzojnë marrjen e mallit me faturë TVSH-je, për arsye të mos rritjes së xhiros dhe kalimit më pas në biznes të madh apo të vogël me TVSH. Kjo situatë shpesh herë ka çuar në refuzimin e mallit nga njësitë e tregtimit me pakicë, duke i vendosur në vështirësi ndërmarrjet e prodhimit.

Si konkluzion, evidencat e grumbulluara gjatë procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj ndërmarrjeve LUFRA SHPK dhe ERZENI SHPK, nuk vërtetuan shenja të kufizimit të mundshëm të konkurrencës nga një marrëveshje e ndaluar apo abuzim me pozitën dominuese në këtë treg, në kuptim të neneve 4 dhe 9 të Ligjit, por shqetësimet e identifikuar në tregun objekt hetimi duhen të adresohen nga institucionet përgjegjëse në mënyrë nxitjen dhe mbrojtjen e konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, (shkronja d), 26 dhe nenit 70, pika 2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar),

VENDOSI:

- I. T’i rekomandojë institucioneve: Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministrisë së Financave, Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve:
 - Verifikimin e mënyrës së funksionimit të skemës së rimbursimit të TVSH në tregun përkatës të përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij sipas Udhëzimit nr. 19, datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.
 - Analizën e pasqyrave financiare të shoqërive nën hetim Erzeni SHPK dhe Lufra SHPK, për të parë arsyet e mos reflektimit të shitjeve të rritura nga 2-5 herë në rezultatin financiar.
 - II. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e përpunimit dhe tregtimit të qumështit të ambalazhuar dhe nënprodukteve të tij ndaj ndërmarrjeve LUFRA SHPK dhe ERZENI SHPK.
 - III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e Vendimit dhe njoftimin e tij për palët e interesuara.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS